



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
BASHKINË GRAMSH

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
MBI
(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)

“BASHKIA GRAMSH”

Tiranë, JANAR 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5-12
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	5
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	6-8
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9-12
II.	HYRJA	13-18
1.	Objekti i auditimit	13
2.	Qëllimi i auditimit	13
3.	Identifikimi i çështjes	13
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14
5.	Përgjegjësitë e audituesve	14
6.	Kriteret e vlerësimit	15
7.	Standardet e auditimit	15-16
8.	Metodat e auditimit	16-17
9.	Dokumentimi i auditimit	17-18
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19-95
1.	Informacion i përgjithshëm	19
2.	Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	20
3.1.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit	20-22
	- Programimi i PBA dhe i buxhetit vjetor 2019-2020. - Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. - Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. -Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli i realizimit të të ardhurave. -Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR etj, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.	
3.2	Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2019 dhe 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi	23-31
	- Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjes ekonomike. - Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të nënjesisë. - Opinioni mbi pasqyrat financiare.	
3.3	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.....	31-85

	<ul style="list-style-type: none"> - Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve ... - Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara. - Auditimi mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit). - Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punëve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik fitues. 	
3.4	Të ndryshme - Auditimi mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre	86-95
	<ul style="list-style-type: none"> - Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre - Mbi regjistrimin e aseteve dhe të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve në varësi të bashkisë - Mbi krijimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave për subjektet që tregtojnë karburante - Mbi krijimin e të ardhurave të institucionit nga arkëtimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit..... - Mbi krijimin e të ardhurave nga subjektet e shpallur fitues për punë publike në procedurat e prokurimit publik..... 	
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	96-107

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
AK	Autoriteti Kontraktor.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
KShaA	Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 867/1, datë 03.09.2021, ndryshuar me nr. 867/2 prot, datë 21.09.2021, i ndryshuar me nr. 867/3 prot., datë 06.10.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi nga data 07.09.2021 deri në datën 22.10.2021, për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2020 në Subjektin: Bashkia Gramsh, u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Sh. H., *Përgjegjës Grupi*
2. E. S., *Anëtar*
3. K. F., *Anëtar*
4. A. Z., *Anëtar*

Auditimi u krye me zgjedhje, mbi bazën e riskut dhe materialitetit.

Fushat mbi të cilat është shtrirë auditimi, sipas programit të auditimit, janë pasqyrat financiare, për të cilat u auditua regjistrimi i të dhënave dhe mbajtjen e kontabilitetit, saktësia e pasqyrave financiare, aplikimin e parimeve kontabël si dhe nëse transaksionet janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, planifikimi për të ardhurat dhe masat e marra për arkëtimin e tyre, zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave për punë publike, shërbime dhe mallra.

Për këto u analizuan evidencat e marra nga subjekti i audituar, si dhe u përdorën testet e nevojshme si pjesë e procedurës së auditimit.

Për pasqyrat financiare, auditimi u krye për pasqyrat e vitit 2019/2020.

Për gjetjet e konstatuara nga grupi i auditimit janë mbajtur 12 akte konstatimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit Bashkia Gramsh, brenda afatit të periudhës së auditimit.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e bëra nga subjekti i audituar, mbi aktet e konstatimit dhe projektraportin dhe janë marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat janë të mbështetura nga ana ligjore, apo është paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Mbështetur në punën audituesve në terren, në evidencat e marra të cilat sipas mendimit tonë kanë qenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituesve, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituesve përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar të Auditimit si më poshtë.

2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në Raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>KLSH ka konstatuar se në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 43,453,558 lekë si dhe gjendja e debitorëve për “dhënie me qira” e lidhura për objekt për banim dhe objekt biznesi në vlerën 6,488,455 lekë e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi kjo vlerë nuk është kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja në formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive.</p>	23-24	I lartë	<p>Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tarifën në llog.468 debitorë të ndryshëm, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.</p>
2	<p>Në auditimin e 10 procedurave me vlera të larta, kriteret janë të paargumentuara në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime.</p>	31-77	I Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Gramsh, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.</p>
3	<p>Nga auditimin e 22 procedurave me vlerë kontrate 641,698 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 9 procedura me vlerë kontrate 119,431 mijë lekë ose 18 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), 119,431 mijë lekë, respektivisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> Vlera 7,998 mijë lekë në prokurimin me objekt “Ndërtim i tregut të qytetit”, me FL8,333 mijë lekë, me fitues BOE “B.” SHPK & “M.” SHPK. Vlera 39,999 mijë lekë në prokurimin me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes X, Koçaj”, me FL 41,666 mijë lekë, me fitues OE “M.” SHPK. Vlera 11,379 mijë lekë në prokurimin me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve në Njësitë Administrative”, me FL 11,937 mijë lekë, me fitues BOE “R.” SHPK & “M.” SHPK. Vlera 6,249 mijë lekë në prokurimin me objekt “Ndërtim ujësjellësa në NJA Skënderbegas dhe NJA Lenije”, me FL 	31-77	I Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Gramsh, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat kanë rezultuar me mangësi në plotësimin e të gjitha kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), 119,431 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p>

	<p>6,249 mijë lekë, me fitues OE "B." SHPK.</p> <p>5. Vlera 27,202 mijë lekë në prokurimin me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat – Cingar Sipër - Drizë", me FL 28,043 mijë lekë, me fitues BOE "A." SHPK & "B.." SHPK.</p> <p>6. Vlera 9,515 mijë lekë në prokurimin me objekt "Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj", me FL 9,996 mijë lekë, me fitues BOE "G. Z." SHPK & V." SHPK</p> <p>7. Vlera 5,781 mijë lekë në prokurimin me objekt "Blerje dru zjarri për nevojat e çerdheve, kopshteve, shkollave dhe konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2020-2021 si dhe zyrat e njërive administrative", me FL 5,819 me fitues OE "I." SHPK.</p> <p>8. Vlera 5,469 mijë lekë në prokurimin me objekt "Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara", me fond limit 5,479 mijë lekë, me fitues OE "2." SHPK.</p> <p>9. Vlera 6,056 mijë lekë në prokurimin me objekt "Ndërtim i varrezave të qytetit", me FL 8,328 mijë lekë, me fitues OE "I." SHPK.</p>			
4	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin", Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës (me tvsh) 99,552,818 lekë, fituar nga OE "Z." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,329,268 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2768 prot datë 29.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE "Z." Shpk.</p>	78-81	I Lartë	<p>Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,329,268 lekë pa tvsh nga shoqëria "Z." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2768 prot datë 29.07.2020, me objekt "Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin", Bashkia Gramsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
5	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Sistemim Asfaltim i lagjes X", Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës (me tvsh) 47,999,596 lekë, fituar nga OE "M." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 215,538 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1916, datë 18.03.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE "Meteo" SHPK</p>	81-83	I Lartë	<p>Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 215,538 lekë pa tvsh nga shoqëria "M." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1916, datë 18.03.2019, me objekt "Sistemim Asfaltim i lagjes X", Bashkia Gramsh", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>
6	<p>Nga puna e pa mjaftueshme e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Gramsh, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2020 kanë vlerën progresive 43,453,558 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat;</p> <p>-57 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 4,422,021 lekë,</p> <p>-3937 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 18,203,801 lekë,</p> <p>-5700 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 14,433,781 lekë,</p> <p>-Debitor qira objekti në vlerën 6,393,955 lekë..</p> <p>Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njëzia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit.</p>	86-88	I Lartë	<p>Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 43,453,558 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimore dhe në vazhdim të marrën masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p>a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat</p>

	<p>Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2019-2020.</p> <p>Nga Bashkia Gramsh nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.</p>		<p><i>tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</i></p> <p>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.</p> <p>d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.</p> <p>e- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifave familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.</p>
--	--	--	--

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.

Për periudhën e auditimit 2019-2020, janë konstatuar problematikat si vijon:

- Në **10** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Në **9** raste nga auditimi i **22** procedurave të prokuruar, vlerësimi i kryer nga KVO, nuk është në përputhje me rregullat e prokurimit publik, pasi ka kualifikuar operatorët ekonomikë të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura në DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), **119,431 mijë lekë** pa TVSH
- Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 57 subjekte biznesi madh dhe i vogël në vlerën **4,422,021 lekë**, 3937 subjekte për vlerën **18,203,801 lekë** për taksë toke bujqësore, 5700 familje për vlerën gjithsej **14,433,781 lekë** për tarifën vendore dhe debitor qira objekti në vlerën **6,393,955 lekë**.
- Në **2** raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatuan punime të pakryera në volumet e situacionuara dhe të paguara nga Bashkia Gramsh në shumën **1,544,806 lekë**.

OPINIONI I AUDITIMIT

a. Nga auditimi mbi pasqyrat financiare.

Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet se bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Përgjegjësia e Auditit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojme bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

*“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet (ISSAI 1700), ISSAI 1705 dhe (ISSAI 1200) shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Gramsh duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore”.*

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Gramsh, të vitit ushtrimor 2019 dhe 2020, në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Gramsh për vitet ushtrimore 2019 dhe 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat: pozicionit financiar, e performancës financiare, e cash-flow (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para), e amortizimit, fondeve neto, e investimeve dhe burimet e financimit, e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata, dhe e shënimeve shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që

bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave, që nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdoruesve të pasqyrave financiare.

-Në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 43,453,558 lekë si dhe gjendja e debitorëve për “dhënie me qera” e lidhura për objekt për banim dhe objekt biznesi në vlerën 6,488,455 lekë e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi këto vlera nuk janë kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave sipas llojit në llogaritë analitike të klasës 7. Përfshirja në formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në bazë të emërtesave.

-Për dy vitet ushtrimore 2019-2020 llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14,043,607. lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,584,931 lekë, Diferenca e vitit ushtrimor 2020 me atë paraardhës prej 1,541,324. lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15 % e zbritur nga vlera e mbetur gjendje në fund të vitit 2019 në vlerën 2,478,284 lekë si edhe shtesat e krijuara gjatë vitit 2020 në vlerën 936,960 lekë.

Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 14,043,607 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

- Për vitin 2019 dhe 2020 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësia nuk dispononte një regjistër analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia.

- Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi.

-Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit “Për kryerjen e procesit të inventarizimit”. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit ***nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve.***

Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve. Komisioni i inventarizimit ***nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur***, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj, sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në varësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës.

- Amortizimi i AQT”. AQT të pasqyruara në postin A të aktivitetit të bilancit janë të kuadruara me AQT e pasqyruara në pasqyrën 6 (me vlerë bruto), duke zbritur amortizimin (AQT të trupëzuara) dhe mos pasqyrimin e drejtë Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”.

-Nga auditimi i transaksioneve nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër shpenzime mbi afatin 30 ditor të faturave për mallra dhe shërbime, në mosrespektim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

b-Nga auditimi mbi përputhshmërinë.

Opinion i kualifikuar për përputhshmërinë

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin në terren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Gramsh të kuadrit rregullator për fushën e prokurimeve publike, referuar kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionin të kualifikuar për fushën e zhvillimit të procedurave.

Baza për opinionin e përputhshmërisë

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi, referuar të dhënave të regjistrimit të realizimit të prokurimeve, konstatohet se janë kryer gjithsej **50** procedura me vlerë të fondit limit **665,845 mijë lekë** dhe vlerë kontrate **641,698 mijë lekë**.

Mbi bazën e riskut, grupi i auditimit nga 50 procedura me vlerë kontrate **641,698 mijë lekë**, ka audituar **22** procedura me vlerë kontrate **579,964 mijë lekë**, ose **90.3%** të vlerës së kontratave të lidhura.

- Nga auditimi i **22** procedurave tenderimi me vlerë kontrate **579,964 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, **9** procedura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të}), **119,431 mijë lekë** pa TVSH.

- Në **10** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.

- Në **2** raste, u konstatuan punime të pakryera dhe të paguara në shumën **1,544,806 lekë**.

Të ardhurat

- Në auditimin e dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, konstatohet se në fund të periudhës vlera e borxhit është në vlerën **43,453 mijë lekë** nga të cilët 57 subjekte biznesi i madh dhe i vogël në vlerën 4,422 mijë lekë, 3937 familje për taksën e tokës bujqësore në vlerën 18,203 mijë lekë, 5700 familje për tarifën vendore në vlerën 14,433 lekë, dhe debitor qira objekti në vlerën 6,393 mijë lekë.

- Në **1** rast, kemi debitor për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante në vlerën **1,000 mijë lekë**.

- Në **2** raste, kemi mos vijim procedurash ligjore për gjobat IMTV në vlerën **641 mijë lekë**.

- Në **9** raste, kemi debitorë për subjekte që kanë përfituar tendera në Bashkinë Gramsh, të cilat nuk kanë hapur nipt-e sekondare si dhe nuk kanë likuiduar tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit në vlerën **275 mijë lekë**.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë

përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare*” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Gramsh.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financiare nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

- Objekti i auditimit synon:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

-Marrja e garancive nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, mbi përputhshmërinë e zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi në mbledhjen e të ardhurave dhe ekzekutimin e buxhetit.

2. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Për fushën e prokurimeve qëllimi i auditimit është të kuptohet se deri në çfarë shkalle subjekti zbaton kuadrin rregullator në fuqi, zbulimi i shkallës së devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së ligjshmërisë, me qëllim që për rastet individuale të identifikuar personat përgjegjës të ngarkohen me përgjegjësi, si dhe të merren masa për parandalimin e shkeljeve në të ardhmen.

3. Identifikimi i çështjes.

Projektraporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Gramsh, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndajë komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Identifikimi i çështjes:

A.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

B.2. Burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre, borxhi tatimor

C. Vlerësimi i Raportimit Financiar (Pasqyrat financiare për vitin 2019-2020).

D.1. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

D.2. Hartimi dhe zbatimi i kontratave të punimeve.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Titullarët e njësive publike, përgjigjen për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektiveve të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të

Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative, të zbatimit të rregullave për Kontrollin e Brendshëm.

Kryetari i Bashkisë Gramsh (*Nëpunësi autorizues*) z. K. T. dhe Drejtori i Financës (*Nëpunësi zbatues*) z. A. B. për vitin 2019 dhe z. A. Sh. për vitin 2020, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi. Sipas përcaktimeve të pikës 6 e neni 34, neni 65- *Administrata e njësisë administrative* dhe pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori” e neni 91, të ligjit nr. 139/15, dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”.

5. Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, etj.)

e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë kryerjes së auditimit, në mënyrë që të jepet një gjykim sa më profesional, objektiv dhe i pavarur, audituesit e grupit kanë zbatuar parimet e mëposhtme me karakter etik: Parimin e integritetit; Parimin e pavarësisë ; Parimin e objektivitetit dhe Parimin e shmangies së konfliktit të interesit.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë në lidhje me pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit publik.

6. Kriteret e vlerësimit.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “*Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.
- Kushtetuta e Republikë së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshime;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ”
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”.
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”; i ndryshuar.
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10450, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me ndryshime;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “*Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël*”.
- VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar.
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, etj.
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.
- Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”.
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*”
- Udhëzimi MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj.
- UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”.
- rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015, e ndryshuar;
- Rregullore “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar.
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Gramsh”, etj.

7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 1000-2999 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 1300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”;
- ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*” që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë".
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.

8. Metodatat e auditimit.

Teknikat audituese:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", me ndryshime.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e për zgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

Metodat audituese:

-Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me **ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit

dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve.

Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

-Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.

Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon¹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të **Riskut të Auditimit prej 5 %**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

-Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike si dhe në *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra si dhe çështje të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura për përgatitjen e Raporti Përfundimtar të Auditimit.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe përgatitjen më pas, të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Evidencat mbështetëse si dhe dokumentacioni i përgatitur nga Grupi i Auditimit, janë pjesë e Raporti Përfundimtar të Auditimit dhe më pas për Raportin Përfundimtar të Auditimit.

¹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm.

1. Informacion i përgjithshëm.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Gramsh, është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregullorja mbi Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë GRAMSH etj. Aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Gramsh.

2. Të dhëna mbi Bashkinë Gramsh

Bashkia Gramsh është një institucion i rëndësishëm, i cili funksionon në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjes vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Pas reformës territoriale, kësaj njësie vendore i janë bashkuar dhe 9 njësi të tjerë, konkretisht: *Njësia Administrative Sult, Tunjë, Lenie, Kukur, Kodovjat, Poroçan, Kushovë, Pishaj dhe Skenderbegas.*

Në Bashkinë Gramsh numri i popullsisë është 34683 banorë, me 12205 familje me sipërfaqe 739,75 km².



3. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Përmbajtja e punës së kryer. Gjetjet dhe rekomandimet mbi Auditimin.

3.1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit , bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

► **Titulli i gjetjes:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019-2020, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

Situata:

Për vitin 2019 buxheti fillestar është për vlerën **583,143 mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për vlerën **586,511 mijë lekë** me rritje për vlerën **3,368 mijë lekë** kjo shtesë vjen si rezultat i çeljes së fondeve për likuidimin e prapambetur nga FZHR për objektin “Ura Pasarel Poroçan:

Paga sigurime QKB në vlerën 1,652 mijë lekë, shpenzime operative 85 mijë lekë.

Paga sigurime Gjendja Civile në vlerën 4,883 mijë lekë, shpenzime operative 110 mijë lekë.

Ndihma ekonomike dhe Paaftësi në vlerën 385,688 mijë lekë.

Nga KQZ në vlerën 1,758 mijë lekë.

Fond për shpërblim lindje në vlerën 0 mijë lekë.

Fonde të Bashkimit Evropian për zbatimin e projekteve me financim të huaja në vlerën 0 mijë lekë (231).

Fonde të akorduara nga Fondacioni 0 në vlerën 0 mijë lekë (600,601 dhe 602).

Fonde të akorduar nga Ministria e Financave për trajtimin ushqimor të arsimit profesional, në vlerën 0 mijë lekë.

Të ardhura të trashëguara sipas aktrakordimin me thesarin në vlerën 81,190 mijë lekë.

Për vitin 2020 buxheti fillestar është për vlerën 551,307 mijë lekë ndërsa në fund të periudhës është për vlerën 590,745 mijë lekë me rritje për vlerën 39,438 mijë lekë kjo shtesë vjen si rezultat i çeljes së fondeve për vlerën 39,438 është 4500 të ardhura nga Këshilli i Qarkut dhe 34,938 nga të ardhurat e trashëguara:

Paga sigurime QKB në vlerën 1,416 mijë lekë, shpenzime operative 86 mijë lekë.

Paga sigurime Gjendja Civile në vlerën 4,192 mijë lekë, shpenzime operative 110 mijë lekë.

Ndihma ekonomike dhe Persona me Aftësi të Kufizuar (PAK) në vlerën 470,192 mijë lekë.

Të ardhura të trashëguara sipas aktrakordimin me thesarin në vlerën 34,938 mijë lekë.

Fonde të akorduara nga Fondacioni 0 në vlerën 0 mijë lekë (600,601 dhe 602).

Fond nga IADSA-YOUTH ne shumën 32,770 mijë lekë.

Shtesë nga taksat e ndara tatim mbi të ardhurat personale, në vlerën 3 330 mijë lekë të akorduara për marrjen e masave anti COVID 19, nëpër shkolla (602).

Fond për shpërblim lindje në vlerën 1,375 mijë lekë.

Për vitin 2019, shpenzimet e buxhetit janë realizuar në masën 90 % ose nga 1,041,130 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 940,311 mijë lekë. Me mosrealizim për vlerën 100,819 mijë lekë, sipas zërave si më poshtë:

Në zërin paga dhe sigurime shoqërore, janë realizuar në masën 97 % ose nga 222,451 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 217,845 mijë lekë.

Në zërin shpenzime operative, janë realizuar në masën 80 % ose nga 134,693 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 108,543 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 58,891 mijë lekë ose 54 %.

Në zërin investime, buxheti për vitin 2019 është realizuar në masën 75% ose nga 298,970 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 223,508 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 13,395 mijë lekë ose 0.2%.

Për vitin 2020, shpenzimet e buxhetit janë realizuar në masën 93 % ose nga 1,154,093 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 1,076,656 mijë lekë. Me mosrealizim për vlerën 77,437 mijë lekë, ky mos realizime vjen si rezultat i tepricave të cilat kanë mbetur gjatë tenderimeve dhe objektet të cilat janë parashikuar me të ardhurat e bashkisë.

Në zërin paga dhe sigurime shoqërore, janë realizuar në masën 97 % ose nga 231,506 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 225,628 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 1,086 mijë lekë.

Në zërin shpenzime operative, janë realizuar në masën 80 % ose nga 140,690 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 112,141 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 53,545 mijë lekë ose 38%.

Në zërin investime, buxheti për vitin 2020 është realizuar në masën 84% ose nga 313,956 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 263,073 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 6,413 mijë lekë ose 0.2%.

Në zërin investime, buxheti i miratuar në fillim viti 2020 është për vlerën 211,500 mijë lekë dhe në rritje për vlerën 102,456 mijë lekë, kjo vjen për investimet të cilat fondet kanë ardhur nga Ministrit e linjës dhe me të ardhurat e trashëguara si më poshtë:

- Rikonstruksioni i qendrës sportive për të rinj (Pallati i Sportit) 32,770 mije leke.
- Rikonstruksioni i banesave të komunitetit egjiptianë 5,917 mije leke.
- Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm Ujësjellësi Gramsh 61,000 mije leke.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 Bashkia Gramsh ka planifikuar për përballimin e situatës së krijuar nga **COVID 19, në vlerën 8,815 mijë lekë.**

Në fakt janë përdorur fonde gjithsej në vlerën 8,272 lekë, si më poshtë:

-Shtesë nga taksat e ndara TAP, **në vlerën 3,330 lekë** të akorduara për marrjen e masave anti COVID 19, në shkollë (602) për blerjen produkteve të higjienës personale.

Me VKB nr. 68, datë 30.09.2020 është miratuar për tu përdorur fondi me objekt

“Blerje materiale për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së COVID 19 në institucione” është lidhur kontratë me subjektin “M. V.” për furnizim të materialeve të cilat kanë ardhur me faturën e subjektit nr.23, datë 23.12.2020 për vlerën 2,836,212 lekë dhe janë bërë hyrje në magazinë me flet hyrje nr. 107,108,109, datë 23.12.2020 për vlerën 2,836,212 lekë.

-Fonde të akorduara nga bashkia nga fondi rezervë në **vlerën 5,515,000 lekë.**

Përdorimi i tyre është me objekt: “Paketa ushqimore”, miratuar me VKB nr. 28, datë 30.04.2020, është lidhur kontratë me dy subjekte subjektin “K. B.” për furnizimin me pako ushqimore të cilat kanë ardhur me faturën e subjektit nr. 694, datë 30.05.2020 për vlerën 567,745 lekë dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje nr. 19, datë 06.06.2020 për vlerën 567,745 lekë, “T. K.” për furnizimin me pako ushqimore të cilat kanë ardhur me faturën e subjektit nr.166, datë 08.06.2020 për vlerën 4,867,889 lekë dhe janë bërë hyrje në magazinë me flet hyrje nr. 20, datë 08.06.2020 për vlerën 4,867,889 lekë.

Mbi dokumentacionin mbi nivelin e faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore.

Nga të dhënat, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2020, të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 20,412,472 lekë, ose 3.4% e vlerës së buxhetit të vitit 2020.

Me datë 30.12.2020, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara, të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me

to”, detyrime të tjera në llog (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 20,412,472 lekë, në totalin e tyre Vendime Gjykatë janë për vlerën 8,000,000 lekë. Trajtuar më hollësisht në aneksin nr. 1.3.6 i gjendjes së llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Sa sipër nga Drejtoria e Financës nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48.

Për veprimet dhe mosveprimet në përputhe me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjor mbahet ky akt konstatimi me z. A. B. me detyrë Drejtor Ekonomik për vitin 2019 dhe z. A. Sh. me detyrë Drejtor Ekonomik për vitin 2020.

Kriteri:

Moszbatim i kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2018”, ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, ligji nr.88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020” , UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 101, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore” neni 40 dhe 46, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe UMF nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit”.

Impakti: Në treguesit ekonomikë dhe financiare të Bashkisë Gramsh.

Shkaku: Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor, mos zbatimi i kërkesave ligjore për kontabilitetin dhe rritja e detyrimeve kreditore nga viti në vit, dhe mos programimi si zë më vete në buxhet për shlyerjen e tyre.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Gramsh të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime në vlerën 20,412,472 lekë, duke ndjekur radhën e pagesave dhe Drejtoria Financës të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006“Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

3.2 Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2019 dhe 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjit nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin financiar” si dhe udhëzimi MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme.

1.Aktive afatshkurtra.

Nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë si më poshtë:

Në mbyllje të vitit 2019 gjendja e llog.520 “Disponibilitete në Thesar”(kredi) është në shumën 67,580,818 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit realizimi në fakt i fondeve është në shumën 67,580,818 lekë. Për vitin 2020 gjendja e llog.520 “Disponibilitete në Thesar” (kredi) rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit në shumën prej 95,862,232 lekë.

Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në datë 31.12.2020, llog. Klasa (3) paraqiten në vlerë 42,318,483 lekë e cila përbehet nga llog. (31) “*Materiale*” në vlerë 12,191,599 lekë, llog. (32) “*Inventari imët*” në vlerë 30,109,714 lekë dhe llog (35) “*Mallra*” në vlerë 17,170 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit të imët e material në shumën (-5.878.945) lekë, e cila kuadron me llog. (63) “*Ndryshim i gjendjes së inventarit*” në shumën (-5.878.945) lekë, ku vlera 59,066,016 lekë, janë shtesë të bërë gjatë vitit dhe 53,187,071 lekë janë pakësime. Pakësimi I vlerës prej 53,187,071 lekë, përbëhet nga vlera prej 0 lekë të cilat i janë transferuar në njësitë vartëse dhe vlera prej 0 lekë materiale të nxjerrë jashtë përdorimit.

Llogaria (327) “Inventari i imët” me vlerë 30.109.714 lekë, përputhet me rezultatin e inventarit vjetor, ndërsa lëvizjet e llogarisë (32)

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2020 në vlerën 189,476,446 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2019 në vlerën 216,008,743 lekë, ku tendenca në ulje në vitin ushtrimor krahasuar me vitin paraardhës ka ardhur si rezultat i arkëtimeve të një pjesë të debitorëve.

Llogaria (468) “Debitorë të ndryshëm” në fund të periudhës ushtrimore 2020 paraqitet në vlerë 45.752.751 lekë e cila përfaqëson detyrimet të lindura nga auditimet e kryera në bashki përfshirë edhe auditimet nga KLSH. **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 152,850,368 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 185,550,602 lekë me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej 32,700,234 lekë, vlerë kjo e arkëtuar nga të tretët debitorë ndaj institucionit. Gjendja e kësaj llogarie përfaqëson detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite dhe që kanë një trend të ulët arkëtimi për mungesë adresimi. Në gjendjen e kësaj llogarie **nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 43,453,558 lekë si dhe gjendja e debitorëve për “dhënien me qira” e lidhura për objekt për banim dhe objekt biznesi në vlerën 6,488,455 lekë** e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi këto vlera nuk janë kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja në formatin e performancës financiare të PF e të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22.

► **Titulli i gjetjes:** KLSH ka konstatuar mos kontabilizim të debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, si dhe për objektet e dhëna me qira në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Situata: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 152,850,368 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 paraqitet në vlerën 185,550,602 lekë me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej 32,700,234 lekë, vlerë kjo e arkëtuar nga të tretët debitorë ndaj institucionit. Gjendja e kësaj llogarie përfaqëson detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite dhe që kanë një trend të ulët arkëtimi për mungesë adresimi. Në gjendjen e kësaj llogarie **nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 43,453,558 lekë si dhe gjendja e debitorëve për “dhënie me qira” e lidhura për objekt për banim dhe objekt biznesi në vlerën 6,488,455 lekë e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi këto vlera nuk janë kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja ne formatin e performancës financiare të PF e të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive.**

Kriteri: Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes sëpërgjithshme” kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22.

Ndikimi: Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuar, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja ne formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive.

Rëndësia: I lartë

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat në llog.468 “debitorë të ndryshëm”, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. A. B., Drejtore Ekonomik për vitin 2019 dhe z. A. Sh., Drejtor Ekonomik për vitin 2020.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

- **Llogaria (486) “Shpenzime të periudhave të ardhshme”,** në fund të periudhës ushtrimore 2020, paraqitet në vlerën 20.412.472 lekë.

2. Aktivet afatgjata

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në vlerën neto paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,642,049,930 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 2,483,449,149 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike;

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14,043,607. lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,584,931lekë, Diferenca e vitit ushtrimor 2020 me atë paraardhës prej 1,541,324. lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15 % e zbritur nga vlera e mbetur gjendje në fund të vitit 2019 në vlerën 2,478,284 lekë si edhe shtesat e krijuara gjatë vitit 2020 në vlerën 936,960 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 14,043,607 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”*, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme

1. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon:

Llogaritë Klasa (20) “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog. (202) “Studime dhe kërkime” në vlerë 14.043.607 lekë. Sipas llogarisë analitike vlera e kësaj llogarie është me 19,754,057 lekë. Diferenca prej 5,710,450 lekë (*pesë milion e shtatëqind e dhjete mijë e katërqind e pesëdhjetë*), është vlera e amortizimit të AAJM.

► **Titulli i gjetjes:** KLSH konstatoi se, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14,043,607 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,584,931 lekë.

Situata: Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 14,043,607 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”*, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kriteri: Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me **Udhëzimin e MFE nr. 8**, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Aneksi 1** “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me **VKM nr. 783**, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” **Pika 1/b** “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “*Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria202*”.

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre

nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

Rëndësia: I ulët.

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

3. Aktive afatgjata Materiale

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” në mbyllje të vitit 2020 paraqiten në shumën totale prej 2,628,006,323 lekë. Për këto aktive janë kryer inventare fizike nga komisioni inventarizimit, i ngritur nga Bashkia Gramsh të paraqitura nëpërmjet fletëve të inventarizimit të hartuara dhe të konfirmuara nga ky komision. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 50,742,734 lekë e pandryshuar si në mbyllje të vitit 2020 dhe të vitit 2019, për të cilën ka inventar kontabël, por jo inventar fizik.

- **Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet në vlerën kontabël 11,217,186 lekë dhe nuk ka ndryshime si për vitin 2019 dhe për vitin 2020. Kjo vlerë përfshin kostot e mbjelljes së pemëve dekorative dhe frutore në territorin e Bashkisë Gramsh për të cilat ekzistonte inventari fizik në numër drurësh.

- **Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 614,926,698 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 606,261,368 lekë për të cilat ka inventar fizik. Diferenca në rritje prej 8,665,330 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2020 nga viti 2019 përfaqëson investime të kryera në vlerën bruto 51,244,863 lekë—amortizimi në vlerën 42,579,533 lekë.

- **Llogaria (212) “Ndërtesa e Konstruksione”**, me vlerë historike 838,279,361 lekë dhe vlerë reale 614,926,698 lekë që përfaqëson vlerën neto të ndërtesave të objekteve në administrim e pronësi të Bashkisë Gramsh gjendje në datë 31.12.2020. Krahasuar me vlerën e periudhës paraardhëse është pasqyruar norma e amortizimit vjetor me vlerë 42,579,533 lekë dhe blerjet e krijuara me pagesë në vlerën 9,859,284 lekë dhe shtesa pa pagesë në vlerën 41,385,579 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 1,846,203,474 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1,689,714,746 lekë për të cilat ka inventar fizik lekë. Diferenca në rritje prej 156,488,728 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2020 nga viti 2019 përfaqëson rritjen në vlerën bruto 248,449,711 lekë—amortizimi në vlerën 91,960,983 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 2,824,482 lekë dhe në mbyllje të vitit 2019 paraqitet në vlerën 3,594,002 lekë për të cilat ka inventar fizik lekë. Diferenca në ulje prej 769,520 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2020 nga viti 2019 përfaqëson nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën bruto 63,400 lekë dhe amortizimi në vlerën 706,120 lekë

- **Llogaria 215 “Mjet transporti”**, paraqitet në vlera me koston historike 118 578 558 dhe vlerë reale në shumën 45.578.271 lekë. Shtuar gjatë vitit me blerje në vlerën 19,968,000 lekë dhe shtesa nga dhurimet në vlerë 4,874,948 lekë. Është pakësuar për vlerën 15,657,773 lekë, nga e cila: amortizimi në vlerën 15,657,773 lekë dhe transferuar më njësit e vartëse si asetet të tyre në vlerën 0 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 218** “Inventar Ekonomik” në datën 31.12.2020 është në vlerën kontabël 56,513,478 lekë, ndërsa në datën 31.12.2019 në vlerën 69,941,086 lekë. Në këto gjendje përfshihen: shtesa prej 12,583,357 lekë, që i takon shtesa nga blerjet në vitin 2020 dhe pakësimit në vlerën 26,010,965 lekë që i takon vlerës së materialeve të nxjerra jashtë përdorimi në vlerë 14,370,711 lekë si dhe zbritja e amortizimit të përlllogaritur në vlerën 11,640,254 lekë.

► **Titulli i gjetjes:** Për vitin 2019 dhe 2020 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësisia nuk dispononte një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit**.

Situata: Nuk disponohet një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit**, ku duhet të përmbajë datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike. **Gjendja e llog. 210** “*Toka, Troje, Terrene*” është në vlerën 50,742,734 lekë e pandryshuar si në mbyllje të vitit 2020 dhe të vitit 2019, për të cilën ka inventar kontabël, por jo inventar fizik. - **Gjendja e llogarisë 218** “Inventar Ekonomik” në datën 31.12.2020 është në vlerën kontabël 56,513,478 lekë, ndërsa në datën 31.12.2019 në vlerën 69,941,086 lekë. Në këto gjendje përfshihen: shtesa prej 12,583,357 lekë, që i takon shtesa nga blerjet në vitin 2020 dhe pakësimit në vlerën 26,010,965 lekë që i takon vlerës së materialeve të nxjerra jashtë përdorimi në vlerë 14,370,711 lekë si dhe zbritja e amortizimit të përlllogaritur në vlerën 11,640,254 lekë. Nga Dega e Thesarit Gramsh nuk është kërkuar regjistri i aktiveve për regjistrimin në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një database me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Gramsh, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre.

Kriteri: Në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

Ndikimi: Kjo mënyrë e evidentimit dhe procesi i inventarizimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme që për këto aktive të mbahen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. A. B., Drejtor Ekonomik për vitin 2019 dhe z. A. Sh., Drejtor Ekonomik për vitin 2020.

4. Inventarizimi i aktiveve për vitin 2019 dhe 2020 Bashkia Gramsh

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2019 dhe 2020 për Bashkinë Gramsh dhe Njësitë Administrative; Pishaj; Kocovjat; Kukur; Porocan; Lenie; Skenderbegas; Kushov; Tunjë; Sult.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit kanë dalë urdhrat nr. 312 datë 03.12.2019 nr. 348 datë 15.12.2020 të cilat kanë përcaktuar komisionin e inventarizimit dhe vlerësimit për pajisjet e inventarit ekonomik (llog.218) dhe pajisjeve teknike (llog.214), mjeteve të transportit (llog.2015), në pronësi të aparatit të Bashkisë Gramshit i përbërë nga 3 anëtarë me qëllim vërtetimin e saktësisë së gjendjes fizike të objekteve të inventarëve në raport me të dhënat e sistemit kontabël.

► **Titulli i gjetjes:** Parregullsi në mbajtjen e dokumentacionit për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Gramsh.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2019 dhe 2020.

Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit “Për kryerjen e procesit të inventarizimit”. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit ***nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve***, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivitetit, apo mallrave e materialeve. Komisioni i inventarizimit ***nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur***, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj, sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në varësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës Brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimi i gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca.

Kriteri: Veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Veprimet e mësipërme ***nuk janë*** në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Ndikimi: Kjo mënyrë e evidentimit dhe procesi i inventarizimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike dhe titullari i Bashkisë nuk janë marrë masat e nevojshme që të kryhet siç duhet procesi i inventarizimit të aktiveve.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh, komisionet e ngarkuara sipas urdhrave të Titullarit, të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. A. B., Drejtor Ekonomik për vitin 2019 dhe z. A. Sh., Drejtor Ekonomik për vitin 2020.

5- Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale” paraqitet në bilanc në vlerën 984,374,289 lekë e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit. U bënë sondazhe në llogari të ndryshme për aktive të veçanta në tabelat e detajuara të aktiveve dhe llogaritjes së amortizimit sipas normave ligjore të amortizimit të përcaktuara, nga ku rezultoi se përlllogaritjet ishin bërë të sakta. Në vitin ushtrimor 2020 janë kontabilizuar përlllogaritjet e amortizimit të aktiveve jo material dhe material për vlerën 151,975,083 lekë dhe është debituar llog. 2012 “konsumi i aktiveve jomateriale” dhe llog. 1013 “Konsumi i aktiveve materiale” në debi të llogarive: llog.2190 “Amortizim Studime projekte” në vlerën 2,478,284 lekë, llog.2192 “Amortizim Ndërtesa” për vlerën 29,531,669, llog.2193 “Amortizim Rruge, kanalizime” për vlerën 91,960,983 lekë, llog. 2194 “Amortizim Makineri e pajisje, instrumenta e vegla” në vlerën 706,120, llog. 2195 “Amortizim Mjete transporti” në vlerën 15,657,773 dhe llog. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” në vlerën 11,640,254 lekë.

► **Titulli i gjetjes:** Amortizimi i AQT”. AQT të pasqyruara në postin A të aktivitetit të bilancit janë të kuadruara me AQT e pasqyruara në pasqyrën 6 (me vlerë bruto), duke zbritur amortizimin (AQT të trupëzuara).

Situata: U bënë sondazhe në llogari të ndryshme për aktive të veçanta në tabelat e detajuara të aktiveve dhe llogaritjes së amortizimit sipas normave ligjore të amortizimit të përcaktuara, nga ku rezultoi se përlllogaritjet ishin bërë të sakta. Në vitin ushtrimor 2020 janë kontabilizuar përlllogaritjet e amortizimit të aktiveve jo material dhe material për vlerën 151,975,083 lekë dhe është debituar llog. 2012 “konsumi i aktiveve jomateriale” dhe llog. 1013 “Konsumi i aktiveve materiale” në debi të llogarive: llog.2190 “Amortizim Studime projekte” në vlerën 2,478,284 lekë, llog.2192 “Amortizim Ndërtesa” për vlerën 29,531,669, llog.2193 “Amortizim Rruge, kanalizime” për vlerën 91,960,983 lekë, llog. 2194 “Amortizim Makineri e pajisje, instrumente e vegla” në vlerën 706,120, llog. 2195 “Amortizim Mjete transporti” në vlerën 15,657,773 dhe llog. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” në vlerën 11,640,254 lekë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 14, datë 28.12.2006.

Ndikimi: Mos pasqyrim i saktë i lëvizjes së fondeve në pasqyrën nr. 8.

Shkaku: Kontabilizim i gabuar.

Rëndësia: E ulët

Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Gramsh, të marrë masa për kryerjen e sistemit kontabël, me qëllim pasqyrimin e drejtë Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”.

► **Titulli i gjeties:** Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave.

Situata: Në kuptimin e VKM 50, date 05.02.2014, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/marrëveshje/vendim gjyqate të formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo ligj.

Nga auditimi konstatohet se, detyrimet e prapambetura vijnë të jenë problem për financat publike. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të viteve të kaluara për kontratë / marrëveshje / vendim gjyqate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke mos prodhuar pasqyrim real të realizimit të buxhetit vjetor, pasi përfshihen pagesa për shërbime dhe të mira që janë realizuar në vitet e mëparshme buxhetore.

Në këtë kuptim, grupi i auditimit me zgjedhje kreu testime për të identifikuar pagesat e kryera për vitin 2019 dhe 2020 me datën e urdhër shpenzimit mbi 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së furnitorit. Ligjin Nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) *parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit.*

Nga kryerja e testimeve mbi urdhër shpenzimet, rezultuan shkelje të disiplinës buxhetore sa i takon likuidimit të faturave duke tejkeluar afatin ligjor. Konkretisht, **janë likuiduar fatura mbi afatin e parashikuar 30 ditor duke shkelur disiplinën buxhetore që dikton ligji për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor”** si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, si më poshtë:

Urdhër shpenzime				Përfitues
Nr.	Datë	Fatura	vlera totale	
2185	09.09.2020	05.08.2020	780,000	S. T.
2187	09.09.2020	31.07.2020	418,877	K shpk
2199	09.09.2020	20.04.2020	117,514	G.
1337	04.06.2020	15.04.2020	10,000,000	M. shpk
1868	27.07.2020	13.11.2019	24,209	N. shpk
1111	10.05.2019	01.11.2018	8,056	H. shpk
1112	10.05.2019	17.12.2018	8,056	H. shpk
1092	08.05.2019	29.01.2019	84,840	M. K.
2460	10.10.2019	17.07.2019	152,400	A. shpk
2461	10.10.2019	24.07.2019	600,000	A. SHPK
1468	18.06.2019	11.03.2019	74,252	G. shpk
1368	10.06.2019	03.05.2019	4,258,800	L. shpk

duke sjellë:

a. Tejkalim të afateve që parashikon Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 52 (ku specifikohet se Nëpunësi zbatues i njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së), dhe si pasojë

b. Duke implikuar risqe për krijimin e detyrimeve të reja (prapambetura)

Kriteri: Ligji 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, neni 52;

Ndikimi: Mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura

Shkaku: Mungesë e fondeve buxhetore në dispozicion,

Rëndësia: I mesëm

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Gramsh, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave, duke respektuar afatin 30 ditor pas paraqitjes së faturës dhe dokumentacionit justifikues nga operatorët ekonomikë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi z. A. B., Drejtor Ekonomik për vitin 2019 dhe z. A. Sh., Drejtor Ekonomik për vitin 2020.

3.3. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlera të larta, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj. (Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve; Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara; Auditimi mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit); Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punëve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik fitues).

3.3.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB, pasqyra aneks 3.10.1, 3.11.1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

3.3.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Gramsh (*regjistrat e parashikimit dhe realizimit*), për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Procedura 01/01/2019 - 31/12/2020	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
GJITHESEJ	50	665,845,084	641,698,697
-Të hapura	8	502,563,540	485,833,186
- Hapura me lote	2	18,092,250	18,092,250
- Kërkesë me propozim	38	140,593,460	133,243,566
- Negocim pa shpallje me lote	2	4,595,834	4,529,695
Sipas objekteve	50	665,845,084	641,698,697
-Objekte në fushën e investimeve	18	441,654,213	427,548,132
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	32	224,190,871	214,150,703

Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Gramsh

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, janë realizuar gjithsej **50** procedura me fond limit 665,845 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 641,698 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 24,147 mijë lekë ose 3.7%, nga e cila: në **vitin 2019** janë realizuar gjithsej **24** procedura me fond limit 348,932 mijë lekë dhe vlerë kontrate 340,065 mijë lekë, dhe për **vitin 2020** janë realizuar **26** procedura me fond limit 316,912 mijë lekë dhe vlerë kontrate 301,632 mijë lekë.

Kanë marrë pjesë në procedura **158** OE/BOE dhe janë s’kualifikuar **51** OE/BOE ose 32%.

Sipas llojit të aktivitetit, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **18** procedura me vlerë kontrate 427,548 mijë lekë ose 66.6% e kontratave të lidhura dhe në të tjera janë **32** procedura me vlerë kontrate 214,150 mijë lekë.

Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **12** procedura ose 24% e procedurave të zhvilluara, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Gramsh janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura.

Mbi bazën e materialitetit dhe riskut të bërë nga Grupi i KLSH, nga **50** procedura me vlerë kontrate 641,698 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **23** procedura me vlerë kontrate 617,699 mijë lekë ose 96.2% e vlerës së kontratave të lidhura, ku shkeljet sipas procedurave dhe problematikave paraqitet si më poshtë vijon:

► **Titulli i gjetjes: KLSH-ja**, konstatoi kriteret jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DST, të miratuar nga AK-ja.

Situata: Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, janë realizuar gjithsej **50** procedura me fond limit 665,845 mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate 641,698 mijë lekë, me një diferencë për vlerën 24,147 mijë lekë ose 3.7%, nga e cila: në **vitin 2019** janë realizuar gjithsej **24** procedura me fond limit 348,932 mijë lekë dhe vlerë kontrate 340,065 mijë lekë, dhe për **vitin 2020** janë realizuar **26** procedura me fond limit 316,912 mijë lekë dhe vlerë kontrate 301,632 mijë lekë.

Grupi i KLSH-^{së}, referuar vlerësimit të dhënave të materialitetit dhe riskut nga **50** procedura me vlerë kontrate 641,698 mijë lekë janë vlerësuar për auditim **23** procedura me vlerë kontrate 596,604 mijë lekë ose 92.9% e vlerës së kontratave të lidhura, nga e cila: për **vitin 2019** nga **24** procedura me vlerë kontrate 340,065 mijë lekë janë audituar **11** procedura me vlerë kontrate 315,368 mijë lekë pa TVSH ose 92.7% e vlerës së kontratave, dhe për **vitin 2020** nga **26** procedura me vlerë kontrate 301,632 mijë lekë janë audituar **11** procedura me vlerë kontrate 264,596 mijë lekë ose 88% e vlerës së kontratave.

Nga auditimi i **22** procedurave me vlerë kontrate **579,964** mijë lekë, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **16** procedura, nga të cilat: në **10** procedura kriteret nuk janë në përputhje me llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në procedura, në **9** procedura OE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST dhe prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **119,431 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenet 2, 20, 23, 24, 46, 47, 53, 55, 58, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 26, 27, 28, 61 konkretisht sipas periudhave:

a- **Për aktivitetin e vitit 2019**, nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 315,368 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **6** procedura me vlerë kontratë **276,956 mijë lekë**, ku në **3** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **5** raste OE i shpallur fitues ka mangësi në plotësimin e DST dhe prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}), në vlerën **92,608 mijë lekë pa TVSH**.

b- **Për aktivitetin e vitit 2020**, nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 264,596 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **10** procedura me vlerë kontratë **259,677 mijë lekë**, ku në **7** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **4** raste OE i shpallur fitues ka mangësi në plotësimin e DST dhe prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{te}), në vlerën **26,823 mijë lekë pa TVSH**.

Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: Neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”; Neni 20, “Mosdiskriminim”, Neni 23, “Specifikimet teknike”, Neni 24, “Anulimi i një procedure”, Neni 46, “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, Neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 26, pika 5, “Kontratat për punë publike”, Neni 27, pika 3, “Kontratat e mallrave”, Neni 28, pika 2, “Kontratat e shërbimeve, Neni 61, pika 2, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” Neni 74, pika 3, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”

Shkaku: Mos vlerësimi i drejtë i kriterëve dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe aplikimi i kriterëve të rënduara të cilat çojnë direkt ose indirekt në mospjesëmarrjen e OE.

Ndikimi/Efekti: Aplikimi i kriterëve jo në mënyrë të argumentuar dhe në përputhje me procedurën, si dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, janë veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve për vlerën **119,431 mijë lekë**, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi: anëtarët e NJHDT dhe KVO, sipas procedurave ku ato janë pjesëmarrës, ku rast pas rasti do trajtohen më poshtë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Kryetari i Bashkisë Gramsh, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar, të cilët në hartimin e kriterëve të aplikohen kriteret të cilat i përshtaten procedurës së zhvilluar, ndërsa në shpalljen fitues të OE të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, dhe të udhëhiqen nga kriteri kryesor “Çmimi më i leverdishëm”, midis OE pjesëmarrës, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të fondeve të prokuruar për vlerën **119,431 mijë lekë**.

Procedurat e periudhës 01.01.2019 – 31.12.2019

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01/01/2019 – 31/12/2019, nga Bashkia Gramsh referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve ka kryer gjithsej **24** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 348,932 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 340,065 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 8,866 mijë lekë ose 4.9 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01/01/2019 - 31/12/2019	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	24	348,932,891	340,065,896
-Të hapura	3	256,870,218	251,550,189
- Hapura me lote	2	18,092,250	18,092,250
- Kërkesë me propozim	19	73,970,423	70,423,457
Sipas objekteve	24	348,932,891	340,065,896
-Objekte në fushën e investimeve	11	295,934,004	289,307,870
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	13	52,998,887	50,758,026

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **63** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **27** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **5** procedura ose 20 % e procedurave të zhvilluara, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuar nga AK Bashkia Gramsh janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **24** procedura prokurimi me vlerë kontrate të lidhur prej 340,065 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e të **11** procedurave me vlerë kontrate 322,026 mijë lekë ose 94.7 % e vlerës së kontratave të lidhura.

Nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 322,026 mijë lekë, u konstatuan në shkelje të akteve ligjore/nënligjorë të LPP, gjithsej **6** procedura me vlerë kontratë **276,956 mijë lekë**

ose 86% e vlerës së kontratave të audituara, ku në **3** raste kriteret e aplikuar nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **5** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, në vlerën **92,608 mijë lekë pa TVSH, si më poshtë vijon:**

1. Tenderi me objekt: “Ndërtimi i tregut të qytetit”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i tregut të qytetit”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 62 Prot., datë 18.03.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 62 Prot., datë 18.03.2019 E. G./Specialist IT- anëtar E. I. /ing.ndërtimi- anëtar A. Rr. / ing.ndërtimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 63 Prot., datë 18.03.2019 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkese per propozim ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 8,333,333 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE -“B.”sh.p.k & “M.” sh.p.k 7,998,955 lekë, me lidhje kontrate datë 13.06.2019 me afat 90 dite.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 334,378 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 15.04.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë + Keshilli Qarkut	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-PO; APP-s’ka; KPP-s’ka Modifikim dok. 1.”A.” shpk nr. 2222 prot dt.01.04.2019 Vleresim 1. V. K.” shpk nr. 2808 prot datë 30.04.2019 2. “A.” shpk nr.2877 prot datë 03.05.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK “A.” sh.p.k Nr.2222/1 prot date 03.04.2019, mospranim ankese Vleresim 1.”V. K.” shpk nr. 2808 prot datë 06.05.2019 , pranim pjesërisht 2.”A.” shpk nr.2877/2 date 06.05.2029, mospranim ankese	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 4 e cila kërkon që njëri prej inxhinierëve duhet të jetë i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, është e ekzagjeruar.

2..Kërkesa e pikës 6 e cila kërkon certifikatat ISO 14001-2015 për menaxhimin e mjedisit nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Vlerësimi i kriterëve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

1.OE “B.” Shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/f** për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 2108 prot., datë 22.02.2019, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë, duke përfshirë faturën koherente të muajit Janar 2019. Në kushtet kur hapja e vlerësimit të kësaj procedure është data 15.04.2019, OE duhej të likuidonte faturat e maturuar të muajit Shkurt dhe Mars 2019 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3/4 të DST** e cila kërkon që për njërin nga inxhinierët e kërkuar (ndërtim, topograf, elektrik), të jetë i pajisur me certifikatë për vlerësimin në mjedis. Asnjëri nga inxhinierët e deklaruar nga të dy subjektet, nuk e disponon këtë certifikatë.

3. BOE nuk përmbush kriterin për 1 Autopompë dhe 1 Fadromë me goma, pasi mjetet e marra me kontratë qirajë nga subjekti "B." me targa AA374AU (autopompa) s'ka certifikatë transporti për të tretë dhe me qira, ndërsa mjete me targa AA551VG (fadroma) nuk disponon certifikatën e transportit të lëshuar nga Autoriteti Vendor.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. G, z. A. Rr. dhe znj. E. I., si dhe anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. Q. P.

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **7,998,955 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me pikën 4, e cila kërkon që njëri prej inxhinierëve të jetë i certifikuar për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, sqarohet se është gjykuar i arsyeshëm ky kriter, pasi ky inxhinier ofron ekspertizë të mirëfilltë gjatë zhvillimit të punimeve për çdo problematikë që mund të haset në ndotjen e mjedisit. Është i nevojshëm pasi sipas vlerësimit të tij do të përfshijë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme, të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit ose moszbatimit të projektit gjatë fazës së zhvillimit të tij.

2. Në lidhje me pikën 3, e cila kërkon certifikatë ISO 14001 – 2015 për menaxhimin e mjedisit dhe ISO 39001:2012 për sigurinë e trafikut rrugor, është bazuar te fakti së vend ndodhja ku do të zhvillohet objekti i prokurimit është në një lagje të qytetit mjaft problematike për nga ana e qarkullimit të mjeteve si dhe në çdo kohë bëhet problematikë për trafikun rrugor. Duke marrë shkasë nga gjendja e saj e rënduar në përditshmëri, kryerja e punimeve në atë zonë do ta mbingarkonte trafikun rrugor dhe për të menaxhuar rreziqet është mëse e domosdoshme, për të shmangur aksidentet rrugore në zonën ku zhvillohet objekti i prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Nga dokumentacioni i dorëzuar në SPE konstatohet se OE "B." shpk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike nr.2108 prot, datë 22.02.2019. Hapja e procedurës është bërë në datë 15.04.2019. Gjithashtu OE "B." shpk ka dorëzuar edhe një dokument të OSHEE i cili përcakton detajet e pagesës së konsumatorit për të njëjtën kontratë si tek vërtetimi nr.2108 prot dhe nga verifikimi i kryer në periudhën e vlerësimit të tenderit ishin detaje të marra në muajin prill, nga ku rezulton se OE "B." shpk, nuk ka detyrime të prapambetura të energjisë elektrike.

2. Në lidhje me pikën 3, sqarohet se në SPE ky BOE ka dorëzuar Certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis nr.5020 datë 04.07.2013, për znj. E. K. (L.) e punësuar pranë shoqërisë "B." shpk, dhe KVO e ka konsideruar të përmbushur këtë kriter, (Bashkëngjitur certifikata e vlerësimit të ndikimit në mjedis).

3.Në lidhje me pikën 4, sqarohet se për plotësimin e këtij kriteri ky BOE ka dorëzuar dokumentacion për kamionçinën me targa AA653TB në pronësi të "B." shpk dhe me targa AA449NU në pronësi të "M." shpk. Kamionçina me targa AA653TB ka kapacitet mbajtës 1.15 ton (pesha maksimale e autorizuar 3000 kg, pesha e mjetit bosh 1 849 kg). Kamionçina me targa AA449NU ka kapacitet mbajtës 1.12 ton(pesha maksimale e autorizuar 3500 kg, pesha e mjetit bosh 2380 kg).Pra të dy automjetet e kanë kapacitetin mbajtës 1-3 ton duke përmbushur kështu kriterin për dy kamionçina 1-3 ton. Sa i përket s'kualifikimit të OE "A." shpk pasi ka detyrime të pa përmbushura ndaj bashkisë Gramsh lidhur me garancinë e punimeve për kontratën nr.4245 date 19.06.2017 me objekt "Rikonstruksion i pjesshëm i shkollës fillore në fshatin Bicaj, Njësia Administrative Lenie", për të cilat është vene në dijeni me ane të shkresave nr.151 prot. datë 29.01.2018, nr.6035 prot., date 14.09.2018, nr.6444 date 02.10.2018, dhe nr.2536 date 11.04.2019, detyrime të cilat janë ende të papaguara. (Bashkëngjitur dy lejet e qarkullimit).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Pranohet pika 3 e observacionit lidhur me mjetet kamionçina me kapacitet 1-3 Ton, duke qenë se mjetet e deklaruara i përmbushin kriteret për kualifikim, ndërkohë që pjesa tjetër e observacionet është e njëjtë me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

2. Tenderi me objekt: "Sistemim asfaltim i lagjes "X", Kocaj", me këto të dhëna:

b. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim asfaltim i lagjes "X", Kocaj"		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 46 Prot., datë 28.02.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 46 Prot., datë 28.02.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 45 Prot., datë 28.02.2019
2. Lloji i Procedurës "E hapur"	E. G./Specialist IT- anëtar E. I. /ing.ndërtimi- anëtar A. Rr. / ing.ndërtimi - anëtar	A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 41,666,667 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) "M." sh.p.k 39,999,663 lekë, me lidhje kontrate datë 10.07.2019 me afat 180 dite.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,667,004 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 30.05.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s'ka;KPP-PO 1. "Z."shpk nr.1987 prot date 20.03.2019 Vlerësim 1."V." shpk nr. 3986 prot datë 18.06.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK 1. "Z." shpk nr.1987 /2 prot date 25 .03.2019 mospranim ankese Vlerësim "V." shpk nr. 3986/2 prot datë 20.06.2019 Pranim pjesërisht	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: Po Modifikim dok. "Z." shpk Vendim KPP nr.281/2019 regjistruar nr.3146 prot date 16.05.2019 , pranim pjesërisht

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: 1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.3 të DST, për Drejtuesin Teknik të punimeve. Sipas deklaratës së administratorit, Drejtues Teknik i

punimeve është inxhinierë e ndërtimit B. K. (K.), e cila do jetë e pranishme gjatë gjithë kohës në objekt dhe e paangazhuar në kontrata të tjera.

-Inxhinierja e mësipërme, rezulton e deklaruar gjithashtu në të njëjtën kohë Drejtuese Teknik e punimeve në tenderin me objekt “Ndërtim i Tregut të Qytetit”, vlerësimi i së cilës është bërë nga e njëjta KVO, në të cilën ky OE është shpallur fitues, raporti përmbledhës i së cilës është i datës 20.05.2019, dhe shpallur fitues me vendimin e titullarit me nr. 58, datë 20.05.2019.

2.OE nuk përmbush kriterin për 2 kamion me kapacitet mbi 15 Ton. 2 mjetet e deklaruar kanë kapacitetin e kërkuar, por mjeti me targa AA829LV, rezulton njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “Ndërtim i Tregut të Qytetit”, shpallja fitues e së cilës është bërë nga e njëjta KVO 10 ditë përpara hapjes së ofertave për këtë procedurë. Sipas deklaratës së bërë nga administratori i shoqërisë, **mjetet nuk janë të angazhuara apo të deklaruar në kontrata të tjera.**

2.1 Nuk përmbushet kriteri për 2 kamion me vinxh me kapacitet mbajtës 7-13 Ton. 2 mjetet e deklaruar të marra me kontratë qiraje, konkretisht mjeti me targa AA389OP i marrë nga subjekti G. Z., dhe mjeti me targa EL4112C i marrë nga subjekti “E.” shpk, kanë certifikatën e transportit vetëm për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira, sipas përcaktimit të nenit 41 “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë” të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar.

2.2 Nuk përmbushet kriteri për 1 autopompë betoni dhe 2 autobetoniere. Të tre mjetet janë marrë me qira nga subjekti “B.” shpk, dhe konkretisht autopompa me targa AA374AA, dhe autobetoniere me targa AA725EK dhe AA726EK. Të tre këto mjete nuk kanë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira, por vetëm për vetë, veprim në kundërshtim me nenin 41, të ligjit nr. 8308 të sipërcituar. Gjithashtu, autopompa e betonit, rezulton e deklaruar edhe në tenderin me objekt “Ndërtim i tregut të qytetit”, vlerësuar nga e njëjta KVO 10 ditë përpara hapjes së ofertave për këtë procedurë.

2.3 Nuk përmbushet kriteri për 1 Autobot Uji, pasi mjeti me targa AA831LV, rezulton njëkohësisht i deklaruar në tenderin me objekt “Ndërtim i Tregut të Qytetit”, shpallja fitues e së cilës është bërë nga e njëjta KVO 10 ditë përpara hapjes së ofertave për këtë procedurë.

2.4 Nuk përmbushet kriteri për 1 miniekskavator, 1 minifadron, 1 autobitumatriçe dhe 1 betoniere 0.5m³. Miniekskavatori rezulton i deklaruar në tenderin “Ndërtim i tregut të qytetit”, vlerësuar nga e njëjta KVO. Minifadroma ka vetëm një kontratë shitjeje nga subjekti B. A., por nuk janë paraqitur dokumente të pronësisë së fadromës. Mjeti autobitumatriçe me targa LU3021C, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti “I.” Sha, ka certifikatën e transportit vetëm për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira, sipas përcaktimit të nenit 41 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar. Në lidhje me betonieren 0.5 m³, është paraqitur vetëm një faturë tatimore për blerje betoniere, pa përcaktuar kapacitetin e saj, sipas kërkesës në DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. Q. P.**

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **39,999,663 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me pikën 1, sqarohet se nga verifikimi i dokumentacionit konstatojmë se për tenderin me objekt “Ndërtimi i tregut të qytetit BOE “B.” shpk & “M.” shpk ka paraqitur deklaratë për drejtuesit teknikë të cilët do të ndjekin zbatimin e punimeve: konkretisht inxhinierët A. D., B. M. dhe B. K. (K.), pra 3 inxhinierë nga një i kërkuar.

Në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes”X”, Koçaj”, OE fitues “M.” shpk ka dorëzuar deklaratë për drejtuesin teknik i cili do të ndjekë zbatimin e punimeve ing. B. K. (K.). Sa më sipër drejtuesi i punimeve B. K. (K.), i deklaruar në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Koçaj”, nuk ka qenë më i angazhuar në tenderin e mëparshëm me objekt “Ndërtimi i tregut të qytetit”, pasi punimet në objektin e mëparshëm ndiqeshin nga dy inxhinierët e tjerë të deklaruar, (Bashkëngjitur deklaratat).

2. Lidhur me mjetet e deklaruara nga OE fitues, të cilat ju konstatojmë se janë të angazhuara në tenderin me objekt “Ndërtimi i tregut të qytetit”, sqarojmë se: referuar marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur për këtë tender, OE “M.” shpk ka marrë përsipër të kryejë 31.09 % të punimeve në vlerën 2,486,679 lekë, pa TVSH, punime që kryesisht konsistojnë në gërmime dheu me krahë e transport, gërmime dheu themele me krahë, gërmim e mbushje dheu kanale puseta, gërmim dhe themel me makineri, mbushje dheu dhe punimet e tjera janë punime hidraulike, ulluqe shkarkimi, puseta, rrethim me kangjella f.v porte, etj që nuk kanë nevojë për përdorim mjetesh transporti. Referuar këtyre punimeve dhe në terma teknikë të punimeve janë punime që kryhen në fazën e parë të tyre dhe sipas grafikut të punimeve përkojnë me muajin e parë të punimeve, punimet e tjera të marra përsipër nga ky anëtar i BOE nuk kanë nevojë për përdorimin e mjeteve të kërkuar, që do të thotë që këto mjete janë të lira, fakt ky që provohet lehtësisht pasi punimet kryhen pranë të njëjtit Autoritet Kontraktor që ka zhvilluar procedurën e prokurimit. (Bashkëngjitur akt marrëveshja +preventivi i punimeve të marra përsipër nga “M.” sh.pk si dhe grafiku i punimeve).

3. Lidhur me mjetin minifadromë kontrata e shitjes nr.5836 rep, nr.1902 kol datë 15.11.2016 është dokumenti që vërteton pronësi e subjektit fitues “M.” shpk mbi këtë mjet, (bashkëngjitur kontrata e shitjes).

4. Sa i përket mjetit autopompë betoni (1 copë) sqarojmë se ky mjet të marra me qira nga subjekti “B.” shpk me anë të kontratës nr.2643 rep datë 29.05.2019 është dhënë me destinacion për këtë tender me objekt “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Koçaj”, çka do të thotë se kjo kontratë qiraje e shfuqizon kontratën nr.1815 rep datë 12.04.2019 ku ky mjet ishte deklaruar në tenderin me objekt “Ndërtim i tregut të qytetit”, që do të thotë se ky mjet ka përfunduar punët e tij në atë objekt dhe është vënë në dispozicion të tenderit të ri sipas kontratës së qerasë lidhur mes palëve. (bashkëngjitur kontratat e qerasë nr. nr.2643 rep datë 29.05.2019 dhe nr.1815 rep datë 12.04.2019).

5. Lidhur me certifikatat e transportit për të tretë sqarojmë se në pikën 20/a të DST është parashikuar ndër të tjera se: Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë) b)leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Pra referuar këtij kriteri të DST është kërkuar vetëm certifikata e transportit brenda vendit, dhe KVO i ka qëndruar strikt vlerësimin të këtij kriteri duke përdorur të njëjtin standard për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë tender, pra është mjaftuar vetëm duke patur certifikatën e transportit.

Gjithashtu sqarojmë se dy objektet e prokurimit “Ndërtim i tregut të qytetit”, dhe “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Koçaj janë në distancë të afërt me njëri tjetrin në një largësi prej afro 1 km.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka

paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

3. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative”, me këto të dhëna:

c. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 85. Prot., datë 26.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 85 Prot., datë 26.04.2019 E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /ing.ndërtimi- anëtar A. Rr. / ing.ndërtimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 86 Prot., datë 26.04.2019 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 11,937,694 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE - “R.” sh.p.k &“M.” 11,379,840lekë, me lidhje kontrate datë 25.07.2019 me afat 90 dite.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 557,854 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 10.06.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s’ka;KPP-s’ka Modifikim dok .tenderi “K.” shpk nr.3073 prot date 13.05.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.3073/2 prot date 20.05.2019 Pranim pjesërisht	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 2.3.13 e cila kërkon nga OE që të jetë i pajisur me licencën profesionale nga QKL Kodi III.1.A “Stacion transferimi për mbetjet jo të rrezikshme”, është kërkesë e cila kushtëzon OE, pasi NJP nuk ka përcaktuar mundësinë e plotësimit të këtij shërbimi me kontratë, kjo pasi mundësia për disponimin e kësaj licence është e kufizuar, dhe nuk janë të shumtë OE që disponojnë landfille për depozitim mbetjesh. NJP nuk ka mbajtur të njëjtin standard si në procedurat e tjera, ku kërkesën e mësipërme e ka modifikuar, duke e kërkuar njëkohësisht edhe mundësinë e disponimit të kësaj licence me kontratë.

2.Kërkesa e pikës 2.3.2 e cila ndër të tjera kërkon kategorinë e licencës NS-6A (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese), është kërkesë e paargumentuar. Nuk ka asnjë zë në preventiv për sinjalistikë rrugore.

3.Kërkesat e pikës 2.3.15, dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike në dispozicion, konkretisht për mjetet Kamionë vetëshkarkues minimumi 15 Ton – maksimumi 18 Ton, Kamionë vetëshkarkues minimumi 12 Ton – maksimumi 14 Ton, janë kërkesa të paargumentuara, dhe njëkohësisht diskriminuese, për nga mënyra se si NJP ka vlerësuar kapacitetin e kërkuar për kamionët. Kufijtë e vendosur për kapacitetin, përbëjnë kufizim për OE, pasi disponimi i këtyre mjeteve me kufij 2 deri 3 ton ndërmjet peshës minimale dhe maksimale, nuk është kriter që i shërben AK, por përkundrazi, përbën kufizim për OE.

4.Kërkesa e pikës 2.3.9 e cila kërkon nga OE 1 ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me natyrën e punimeve, e cila është për shtrim rrugës, dhe zërat e punimeve konsistojnë në gërmim

dherash, mure betoni dhe shtresa zhavorri, dhe nuk justifikohet kërkesa për ekspert zjarrfikës me zërat e punimeve.

Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

1.OE “M.” Shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.3** për stafin e inxhinierëve, pasi të gjithë inxhinierët janë të deklaruar paralelisht në 2 tendera të tjerë ku ky OE është shpallur fitues pranë këtij AK, vlerësuar nga e njëjta KVO. Konkretisht janë të deklaruar në procedurën “ndërtim i tregut të qytetit” si dhe në procedurën “sistemim asfaltim i lagjes “X” Kocaj”. Administratori i shoqërisë në deklaratën e hedhur në SPE, shprehet se stafi teknik dhe punonjësit do të jenë të angazhuar me kohë të plotë për realizimin e objektit deri në përfundim të tij. Gjithashtu, ai deklaroi si drejtuese teknike me kohe të plotë në kantier dhe të paangazhuar në kontrata tjera, inxhinierë B. K., e cila rezultoi e deklaruar drejtuese teknike në dy procedurat e mësipërme.

2.OE “M.” shpk, nuk përmbush kriteret për pikën 2.3.6 për stafin teknik dhe manovratorët e pajisur me certifikatë sigurimi teknik. Të gjithë punonjësit e deklaruar, rezultojnë si në rastin e mësipërm, të angazhuar paralelisht në 2 kontrata tjera në të cilat ky OE është shpallur fitues pranë këtij AK, ndërkohë që sipas deklaratës së administratorit, punonjësit do të jenë të angazhuar vetëm në këtë kontratë.

3.OE “R.”, i cili sipas akt marrëveshjes do kryer 70% të gjithë zërave të punimeve, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.14**, pasi nuk disponon asnjërën prej certifikatave ISO të kërkuara në DST.

4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.15** dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, për 2 kamionë vetëshkarkues min 15 Ton – max 18 Ton. Konkretisht, mjeti me targa AA206TH, me kapacitet 16.4 Ton, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti T. shpk, nuk është deklaruar në shtojcën nr. 10 “Dëshmi mbi disponimin e makinerive”. Gjithashtu, ky mjet s’ka certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira. Mjetet me targa AA689MJ me kapacitet 16.4 Ton dhe AA122NE me kapacitet 15.1 Ton, të marra me kontratë qiraje nga subjekti “B.” Shpk, s’kanë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira. Mjetet me targa AA829LV dhe AA486PV me kapacitet 16 Ton në pronësi të OE “M.” shpk, rezultojnë të deklaruar njëkohësisht në dy procedura tjera ku ky OE është shpallur fitues (të cituara më sipër) pranë të njëjtin AK, dhe nga e njëjta KVO.

5.BOE nuk përmbush kriteret e pikës **2.3.15** për mjetet dhe pajisjet teknike, për 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet min 12 Ton – max 14 Ton. Kamioni me targa TR2149S me kapacitet 12.4 Ton, i marrë me kontratë qiraje nga A. shpk, nuk ka certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira. Mjetet me targa GR1496B dhe GR1705B me kapacitet 12 Ton, të marra me kontratë qiraje nga subjekti A. shpk, nuk kanë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira.

6.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.15** për mjetet dhe pajisjet teknike, për 2 kamion vetëshkarkues me kapacitet min 5 Ton. Mjeti me targa AA829LF, i marrë me qira nga subjekti T. shpk, me kapacitet mbajtës 9.5 Ton, nuk është deklaruar në shtojcën nr. 10 në mjetet e marra me qira, ndërkohë që s’ka as certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira. Mjeti me targa AA918DO me kapacitet 7.7 Ton, i marrë me kontratë qiraje nga subjekti B. C., s’ka certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira.

7.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.15** për mjetet dhe pajisjet teknike, për 2 kamionçina me kapacitet 1-3 Ton. Mjeti me targa BR0898B me kapacitet 2.8 Ton i marrë me kontratë qiraje nga subjekti “T.” shpk, nuk është deklaruar në shtojcën 10 për mjetet dhe makineritë, ndërkohë i mungon edhe certifikata e transportit. Mjeti me targa BR1109B është me kapacitet 3.5 Ton, pra është mbi kapacitetin e kërkuar. Mjeti me targa TR1485S marrë me kontratë qiraje nga subjekti “A.” shpk është me kapacitet 4.4 Ton, pra është mbi kapacitetin e

kërkuar. Mjeti me targa AA449NU me kapacitet 1.1 Ton, është i deklaruar në të njëjtën kohë në 2 procedurat e cituara më sipër, ku OE "M." shpk është shpallur fitues pranë të njëjtin AK dhe nga e njëjta KVO. Mjeti me targa AA054DZ, marrë me kontratë qiraje nga subjekti E. H., është poshtë kapacitetit të kërkuar në DST.

8. BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.15 për mjetet dhe pajisjet teknike, për 1 autopompë betoni dhe 1 autobetoniere. Mjetet autopompë betoni me targa AA374AU dhe autobetonierja me targa AA179MB, janë të deklaruara në të njëjtën kohë si mjete në 2 procedurat e cituara më sipër, në kundërshtim me deklaratën për disponimin e mjeteve vetëm për zbatimin e kësaj kontrate. Të dyja këto mjete, njëkohësisht nuk kanë certifikatën e transportit për të tretë dhe me qira.

9. BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.15 për mjetet dhe pajisjet teknike, për 1 autobot uji. Mjeti me targa AA831LV, në pronësi të OE "M." shpk, rezulton i deklaruar në të njëjtën kohë në 2 procedurat e cituara më sipër, ku ky OE është shpallur fitues pranë të njëjtin AK nga e njëjta KVO.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. G., z. A. Rr. dhe znj. E. I., si dhe anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. Q. P.**

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **11,379,840 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me kërkesën e pikës 2.3.13 për kërkesën për stacion transferimi, NJP sqaron se këtë kërkesë e mbështet në Ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" (Ndryshuar me Ligjin Nr. 10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25 dhe vendosja e këtij kriteri ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen në kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut, dhe cilësisë së jetës.

2. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.2 për kategorinë e licencës NS – 6A (sinjalistika rrugore jo ndriçuese), NJP ka gjykuar se duke qenë se objekti i prokurimit është i llojit "rrugë" janë të domosdoshme sinjalistikat rrugore jo ndriçuese për të shmangur avaritë që mund të ndodhin gjatë punimeve. Objekti i prokurimit kalon nëpër disa rrugë që lidh fshatra të ndryshëm të bashkisë Gramsh, nga ku bëhet edhe qarkullimi i mjeteve të transportit të qytetarëve të zonës.

3. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.15, NJP sqaron se:

-Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 15 ton – max 18 ton është kërkuar pasi këto makineri janë të nevojshme për transport, furnizim dhe largimin e mbetjeve që do të krijohen në objekt.

-Kamioni vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 12 ton - max 14 ton – Këto makineri janë të nevojshme për ngritjen e tubave të çelikut të cilët janë parashikuar në preventiv.

-Makinertë më kapacitet me të vogël si 1 – 3 ton janë të nevojshme për të kryer transportin e materialeve në volume të vogla dhe për të bërë të mundur kalimin në terrene të ngushta ku nuk mund të kalojë kamioni i madh. Këto kritere janë vendosur duke marrë parasysh faktin që objekti i prokurimit kalon nëpër një terreni të vështirë të thepisur malor.

4.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.9 për ekspert zjarifikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri, NJP sqaron se e ka vendosur si kriter duke u bazuar te fakti se terreni nëpër të cilin do të kalojë objekti i prokurimit është i mbuluar me gjelbërim, pemë të ndryshme e shkurre. Duke gjykuar se në rast të ndonjë avarie, për shkak të defekteve në mjete, përdorimit të energjisë elektrike apo të ndonjë gabimi njerëzor, mund të ketë rënie zjarri, do të kishte një ndikim shumë të madh negativ gjatë kryerjes së punimeve. Për të shmangur pasojat e rënda të një impakti të tillë është kërkuar një ekspert i kësaj fushe.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Lidhur me drejtuesin teknik BOE të shpallur fitues “R.” sh.p.k & “M.” sh.p.k ka deklaruar që drejtuesit teknikë të cilët do të ndjekin mbikëqyrjen e punimeve në këtë objekt(secili individualisht) janë konkretisht ing. L. Z. dhe ing. B. K. (K.), dy nga një i kërkuar.

Sa më sipër drejtuesi i punimeve B. K. (K.),i deklaruar në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative”, nuk ka qenë i angazhuar në tenderat e mëparshëm me objekt “Ndërtimi i tregut të qytetit”, dhe “Sistemim asfaltim i lagjes “X”, Koçaj”, pasi punimet në objektin “Ndërtimi i tregut të qytetit”, ndiqeshin nga dy inxhinierët e tjerë të deklaruar dhe punimet për objektin “Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative”, do të ndiqeshin nga ing. L. Z. si drejtues teknik i “R. C.” sh.p.k i cili ka marrë përsipër të kryejë 70% të punimeve, për këtë arsye krijohen edhe bashkimet e operatorëve ekonomikë (Bashkëngjitur deklaratat).

2. Sa i përket plotësimit të kriterit për 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 15 ton-max 18 ton ky BOE ka dorëzuar dokumentacionin për 5 mjete nga 2 të kërkuar konkretisht: kamioni me targa AA206TH kapacitet 16.4 ton, me targa AA689MJ me kapacitet mbajtës 16.4 ton, me targa AA12NE me kapacitet 15.1 ton, AA 486 PV me kapacitet 17.2 ton, AA829LV me kapacitet 16 ton.

3. Lidhur me paraqitjen e certifikatave të transportit për të tretë sqarojmë se në pikën 16/c të DST është parashikuar ndër të tjera se: “Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti). Pra referuar këtij kriteri të DST është kërkuar vetëm certifikata e transportit, dhe KVO i ka qëndruar strikt vlerësimit të këtij kriteri duke përdorur të njëjtin standard për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë tender, pra është mjaftuar vetëm duke patur certifikatën e transportit.

4. Sa i përket kamionçinave me kapacitet 1-3 ton BOE i shpallur fitues për përmbushjen e këtij kriteri ka dorëzuar dokumentacionin për kamionçinat me targa AA374AU me kapacitet mbajtës 1 ton, AA 449 NU me kapacitet 1.1 ton, BR0898B me kapacitet 3 ton.

5. Përsa i përket autopompës së betonit dhe autobetonieres sqarojmë se këto dy mjete janë marrë me qira me anë të kontratës noteriale nr.2913 rep datë 08.06.2019 me objekt të përcaktuar “Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative”, çka nënkupton këto mjete kanë përfunduar punët e tyre në objektet në ato dy objekte dhe janë vënë në dispozicion të tenderit të ri sipas kontratës së qerasë lidhur mes palëve.(bashkëngjitur kontrata e qerasë nr. nr.2913 rep datë 08.06.2019).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

4. Tenderi me objekt: “Ndërtim ujësjellësa në NJA Skënderbegas dhe NJA Lenije”, me këto të dhëna:

d. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim ujësjellësa në NJA Skënderbegas dhe NJA Lenije”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 112 Prot., datë 24.05.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 112 Prot., datë 24.05.2019 E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /ing.ndërtimi- anëtar A. Rr. / ing.ndërtimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 113 Prot., datë 24.05.2019 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 6,249,173 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - “B.” sh.p.k 6,027,266 lekë, me lidhje kontrate datë 08.07.2019 me afat 60 dite.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 221,907 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 14.06.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operoretre Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.1.f të DST për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. OE ka paraqitur vërtetimin nr. 1128 prot., datë 11.06.2019, sipas të cilës ky OE ka likuiduar faturat e energjisë elektrike, **pa përfshirë** faturën koherente të muajit Prill 2019. Sa më sipër, ky OE rezulton debitor, dhe në kushtet kur data e hapjes së ofertave është 14.06.2019, ky OE duhej të kishte likuiduar faturat e maturuara të energjisë elektrike.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.C të DST, për autorizim nga prodhuesi për mallrat e ofertuara sipas përbërjes së preventivit. Ndër të tjera kërkohet që fragmentet e katalogut të tregojnë lehtësisht se cilit prodhues i përkasin, dhe se dokumentet nëse nuk janë në gjuhën shqipe të shoqërohen me përkthim dhe noterizim.

-Sa më sipër, rezulton se OE ka paraqitur një autorizim nga subjekti “F.” shpk, i cili deklaron se autorizon OE B. shpk për prezantimin e mostrave, dhe ka paraqitur edhe një katalog i cili rezulton në gjuhë të huaj dhe i papërkthyer dhe i panoterizuar. Gjithashtu, katalogu nuk përcakton lidhjen mes produktit dhe prodhuesit ose distributorit të mallit.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.G të DST, makineri për ngjitjen e tubave PE. Në DST kërkohet që për pajisjet teknike, fatura tatimore e shitjes të jetë sipas formatit të miratuar me tvsh (fatura e biznesit të vogël), dhe duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

-Rezulton se OE ka paraqitur një faturë të thjesht tatimore për blerje aparat saldimi, por të cilës i mungon kuponi tatimor, sipas kërkesës së DST.

4.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.G për mjetin ekskavator me goma, pasi mjeti me targa AHMT94 s'ka paraqitur Certifikatën e Kontrollit Teknik të mjetit, në kundërshtim me DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. Q. P.**

Ndikimi/Efekt: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **6,027,266 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.E ku kërkohen minimum 15 punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik ju sqarojmë se AK, ndryshe nga ajo çfarë ju keni argumentuar, ka gjykuar lëniën e lirë në varësi të OE për të plotësuar nr. 15 punëtorë me kartela personale, për arsye të nxitjes së pjesëmarrjes në këtë procedurë prokurimi të OE, duke mos e kufizuar numrin e pjesëmarrjes. Për këto arsye nuk janë specifikuar profesionet e tyre. E rëndësishme nga ana jonë ka qenë pjesëmarrja e OE me një staf të kualifikuar, ndaj edhe kemi specifikuar vetëm stafin drejtues lidhur me profesionet.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Në lidhje me pikën 1 të observacionit, pranohet pretendimi juaj, por AK duhet të konsiderojë faktin që kërkesat për stafin e kualifikuar të jenë specifike, pasi i shërbejnë cilësisë së punimeve.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/10 prot., datë 01.11.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Në lidhje me konstatimin tuaj se OE fitues ka dorëzuar vërtetimin nr.1128 prot., datë 11.06.2019 për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike pa përfshirë faturën koherente të muajit prill 2019, sqarojmë se:

Në vërtetimin nr. 1128 prot., datë 11.06.2019 pasqyrohet ndër të tjera se “vërtetojmë se kërkuuesi “B.” shpk nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën (me kod)EL0B010051063059 titullar is ë cilës është B. R., përdorues “B.” shpk , rezulton të ketë në total 0 detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 11.06.2019.....”

Referuar përmbajtjes së këtij vërtetimi dhe të dhënave të pasqyruara në të , dhe datës së hapjes së procedurës që është data 14.06.2019 rezulton se deri në datën 11.06.2019 OE “B.” shpk nuk ka detyrime të prapambetura ndaj OSHEE-së për fatura të energjisë elektrike. Këtij fakti i është referuar KVO gjatë vlerësimit të ofertave dhe për këtë arsye ky kriter është konsideruar i përmbushur, (bashkëngjitur vërtetimi).

2.Sa i përket faktit të konstatuar prej jush se OE nuk përmbush kriterin për një makineri për ngjitjen e tubave PE , sqarojmë se në kohën e lëshimit të faturës së thjeshtë tatimore nr.40 datë 27.08.2009, nuk ishte parashikuar lëshimi i kuponit tatimor.

3.Sa i përket konstatimeve të tjera , KVO i ka konsideruar si devijime të vogla , dhe nisur nga fakti i nevojës emergjente të ndërtimit të këtyre objekteve , dhe duke qenë se ka qenë i vetmi

pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, KVO e ka kualifikuar këtë operator ekonomik i cili më pas është shpallur edhe fitues i procedurës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

5. Tenderi me objekt: “Rikonstrukcion i kanalit ujitës Galigat-Cingar Sipër –Drizë”, me këto të dhëna:

e. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i kanalit ujitës Galigat-Cingar Sipër –Drizë”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 83Prot., datë 25.04.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 83 Prot., datë 25.04.2019	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 84 Prot., datë 25.04.2019
2. Lloji i Procedurës “E hapur”	E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /ing.ndërtimi- anëtar A. Rr. / ing.ndërtimi - anëtar	A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 28,043,538 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE - “A.” sh.p.k & “B.” sh.p.k 27,202,221 lekë, me lidhje kontrate datë 21.08.2019 me afat 90 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 841,317 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 19.07.2019	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkisë	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s’ka;KPP-Po Modifikim dok.tenderi 1.“I.” shpk nr.3052 prot date 13.05.2019 2.“N.” shpk nr.3074 prot date 13.05.2019 3. “V.” shpk nr.3035 prot date 10.05.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK 1. nr.3052/2 prot dt.20.05.2019, mospranim ankese 2. nr.3052/2 prot dt.20.05.2019, pranim pjesërisht 3. nr.3035/2 prot 20.05.2019, mospranim ankese	13. Përgjigje Ankesës nga APP s’ka apo KKP:PO Mod. Dokumentash “V.” sh..p.k Vendimi KPP nr.405/2019 regjistruar me nr.4169 prot datë 28.06.2019, pranim pjesërisht

► **Titulli i gjeties:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE “B.” Shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/g** për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 1240 prot., datë 27.06.2019, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë, duke përfshirë muajin Maj 2019. Në kushtet kur hapja e vlerësimit të kësaj procedure është data 19.07.2019, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Qershor 2019 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.OE “A.” shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/g** për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 1176 prot., datë 19.06.2019, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë, duke përfshirë muajin Maj 2019. Në kushtet kur

hapja e vlerësimit të kësaj procedure është data 19.07.2019, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Qershor 2019 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

3. BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.19 të DST për mjetet dhe pajisjet teknike, për mjetin Fadromë me Goma. Në DST kërkohet që për mjetet e regjistruara në regjistra publikë, ndër të tjera të paraqitet edhe certifikata për transport mallrash brenda vendit. OE "B." Shpk ka deklaruar fadromën me targa AA551VG e cila nuk disponon certifikatën e transportit.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. Q. P.

Ndikimi/Efekt: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **27,202,221 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Lidhur me konstatimin tuaj se OE "B." shpk ka dorëzuar vërtetimin nr.1240 prot datë 27.06.2019 dhe OE "A." shpk ka dorëzuar vërtetimin nr.1176 prot., datë 19.06.2019 për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike duke përfshirë faturën e muajit maj 2019, por pa përfshirë faturën e muajit qershor 2019, sqarojmë se: Në lidhje pikën 1 dhe 2 të për mos likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike nga të dy OE, sqarohet se në zbatim të nenin 9 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë", përcaktohet shprehimisht që: "Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Sa më sipër, OE kanë afat deri në fund të muajit për likuidimin e faturës së muajit për likuidimin e faturave të energjisë elektrike. Gjithashtu edhe në vërtetimin e lëshuar nga OSHEE, pasqyrohet se shoqëria "A." shpk nuk ka detyrime të pashlyera të energjisë elektrike deri më datën 19.06.2019 përfshirë faturën koherente të muajit maj 2019 dhe vërtetimin e lëshuar nga OSHEE, për shoqërinë "B." shpk pasqyrohet nuk ka detyrime të pashlyera të energjisë elektrike deri më datën përfshirë faturën koherente të muajit maj 2019 (bashkëngjitur 2 vërtetimet e energjisë elektrike dhe Vendimi i KPP-së nr.803 /2017 si referencë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjta me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

6. Tenderi me objekt: "Rikonstrukcion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", me këto të dhëna:

f. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstrukcion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh"

1. Urdhër Prokurimi: Nr.

3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit

4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave

156Prot., datë 16.07.2019	Nr. 156 Prot., datë 16.07.2019	Nr. 157 Prot., datë 16.07.2019
2. Lloji i Procedurës “E hapur ”	E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /ing.ndërtimi- anëtar A. Rr. / ing.ndërtimi - anëtar	A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 187,160,013 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE -“M.” sh.p.k & “A.” sh.p.k 184,348,305 lekë, me lidhje kontrate datë 01.10.2019 me afat 12 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,811,708 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 09.09.2019	9. Burimi Financimit Buxheti shteti	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s’ka; KPP-s’ka Modifikim dokumentash tenderi 1.“L.” shpk nr.4701 prot date 01.08.2019	12. Përgjigje Ankesës nga AK Nr.4701/1 prot date 07.08.2019 Pranim pjesërisht	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.3 të DST** e cila kërkon licencën profesionale të shoqërisë për kategorinë **NP-1D (punime gjermimi në tokë)**, nuk është në përputhje me zërat e preventivit. Sipas preventivit zërat e gjermimit janë në vlerën 17 milion lekë për të cilën maksimumi i kategorisë do duhej **B**, ndërkohë që kategoria **D** është për punimet mbi 101 milion deri 200 milion lekë. Kërkesa për licencën profesionale të shoqërisë për kategorinë **NP-5D (punime nëntokësore, ura e vepra arti)**, nuk është në përputhje me zërat e preventivit. Punimet për këtë kategori nuk janë në vlerën mbi 101 milion deri 200 milion. Kërkesa për licencën profesionale të shoqërisë për kategorinë **NP-12D (punime të inxhinierisë së mjedisit)**, është e paargumentuar dhe jo në përputhje me volumet e punës. Është kërkesë kufizuese që nuk i shërben AK. Kërkesa për licencën profesionale të shoqërisë për kategorinë **NS-16D (ndërtim i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij)** nuk është në përputhje me vlerën dhe zërat e preventivit.

2.Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila ndër të tjera kërkon edhe 1 inxhinier elektrik (me certifikatë për sistemet e kontrollit dhe komandimit), është kërkesë e paargumentuar. Sipas zërave të punimeve, nuk ka asnjë punim për të kërkuar ekspertizën e inxhinierit elektrik, dhe aq me pak me certifikatë për sistemet e kontrollit dhe komandimit. Është kërkesë kufizuese dhe nuk i shërben AK.

3.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 1 ekspert të auditimit të energjisë, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me zërat e preventivit. AK nuk argumenton nevojën për një ekspert të tillë.

4.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 1 agronom, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me zërat e preventivit. Nuk ka asnjë zë në preventiv, për të cilën të kërkohen ekspertiza e agronomit.

5.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 3 inxhinier topograf, është kërkesë e ekzagjeruar, dhe jo në përputhje me volumet e punimeve, për të cilën të kërkohen një numër kaq i lartë topografësh, pasi njëkohësisht është kërkuar edhe 1 topograf drejtues teknik që në total përbëjnë 4 topograf. Kërkesa të tilla nuk i shërbejnë AK, por përbëjnë kufizim për OE.

6.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 1 inxhinier elektronik i cili të jetë i specializuar për C CNA Routing and Switching, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me volumet. Nuk ka asnjë zë në preventiv për kërkesë për inxhinier elektronik, dhe aq me pak të kërkohet që të jetë i specializuar për C CNA Routing and Switching.

7. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 1 inxhinier ndërtimi, 1 hidroteknik, 1 mekanik dhe 1 gjeolog, janë kërkesa të dubluara, pasi këta inxhinierë janë kërkuar edhe si drejtues teknik. Praktikisht NJP kërkon në total 17 inxhinierë, numër relativisht i lartë dhe i paargumentuar.

8. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon fuqi punëtore prej 195 punonjësish për periudhën Korrik 2018 – Korrik 2019, është kërkesë e ekzagjeruar, dhe paargumentuar. NJP nuk ka argumentuar numrin e lartë të stafit të kërkuar, nuk ka bërë një analizë për mënyrën e caktimit të këtij numri, i cili është shumë i lartë, dhe përbën kufizim për OE për të paraqitur oferta.

9. Kërkesa e pikës **2.3.10 e DST**, e cila kërkon 42 punonjës me dëshmi teknike, është kërkesë e paargumentuar dhe e ekzagjeruar. AK nuk ka mirë argumentuar nevojën për një numër kaq të lartë punonjësish. Nuk ka një analizë se si është përcaktuar ky numër në raport me volumet e punimeve që ka secili prej këtyre specialistëve.

10. Kërkesa e pikës **2.3.11 e DST**, e cila kërkon nga OE të ketë licencë për mbrojtjen nga zjarri me QKL, Kodi 1.2.A, është kërkesë e paargumentuar dhe jo në përputhje me natyrën objekt prokurimi.

11. Kërkesa e pikës **2.3.13 e DST**, e cila kërkon nga OE të kenë licencë për Stacion Transferimi për mbetje jo të rrezikshme Kodi III.1.A dhe të jetë jo më larg se 30 km nga objekti i prokurimit, është kërkesë që përbën kufizim për OE. Së pari një kërkesë e tillë duhej të ishte shoqëruar edhe me mundësinë e disponimit të kësaj licence nëpërmjet një kontrate shërbimi, pasi disponimi i landfillleve është i kufizuar, ndërkohë edhe distanca e përcaktuar jo më larg se 30 km, është gjithashtu kufizuese për OE. Vendosija e një kufiri kaq të afërt, praktikisht heq mundësinë e OE që disponojnë këtë licencë, por në distanca më të largëta.

12. Kërkesa e pikës **2.3.14 e DST**, e cila kërkon licencë për shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me pyje dhe kullota Kodi III.7.A, është kërkesë e paargumentuar, kufizuese e cila nuk i shërben AK. Nuk ka asnjë zë në preventiv lidhur me punime për të cilat kërkohet një ekspertizë e tillë. AK, edhe në kushtet në të cilat mund të kishte nevoja për këtë licencë, duhej ta mundësonte edhe nëpërmjet një marrëveshje shërbimi.

13. Kërkesa e pikës **2.3.19 e DST**, për mjetet dhe pajisjet teknike, e cila kërkon 10 kamionë vetëshkarkues, 4 kamionçina, 4 autovinxh, 6 ekskavator me goma, 4 ekskavatorë me zinxhirë, 2 ekskavator me krahë të gjatë, 2 asfaltoshtruese, 2 autovinxh me krahë jo më pak se 30 metër, 6 rrula, janë kërkesa të ekzagjeruara, të paargumentuara dhe kufizuese. NJP nuk ka analizuar nevojën për këtë numër të lartë mjeteve, i cili nuk është në raport me volumet e punimeve. -Kërkesa për 13 ekskavatorë në total është jashtëzakonisht e lartë, në raport me volumin e gërmimeve, i cili sipas preventivit është rreth 17 milion lekë.

-Gjithashtu, kërkesa për 10 kamionë (për të cilat nuk janë specifikuar kapacitetet mbajtëse) si dhe 4 kamionçina, është shumë e lartë në raport me volumin e mbetjeve të cilat duhen transportuar. Nuk është argumentuar nga AK teknikisht nevoja për këtë numër mjeteve.

-Kërkesa për 2 asfaltoshtruese, është e ekzagjeruar në raport me volumin e punimeve, ku sipas preventivit volumet nuk janë të mëdha dhe 1 asfaltoshtruese do ishte e mjaftueshme për zbatimin e kësaj kontrate.

-Kërkesa për 2 autovinxh me krahë jo më pak se 30 metër, është tjetër kërkesë e ekzagjeruar dhe jo e argumentuar nga AK. Kjo kërkesë është kufizuese, dhe nuk i shërben AK.

-Kërkesa për 6 rrula është kërkesë e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me volumet e punimeve. Nuk argumentohet nga AK teknikisht.

Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. G., z. A. Rr. dhe znj. E. I.

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me kërkesën 2.3.4 e DST për kriterin e vendosur për 1 inxhinier elektrik (me certifikatë për sistemet e kontrollit dhe komandimit) ju sqarojmë se: NJP ka gjykuar të arsyeshëm vendosjen e këtij kriteri pasi objekti i prokurimit ka një shtrirje të gjerë përgjatë gjithë qytetit aty ku kalon përkatësisht edhe rrjeti elektrik i qytetit. Në raste gjermimi mund të ndodhë që të dëmtohen linjat elektrike dhe për të shmangur çdo avari të tillë është i nevojshëm inxhinieri elektrik. Përsa i përket certifikatës që duhet të disponojë, është menduar e arsyeshme nga ana NJP, pasi nëse avaritë do të ndodhin do të duhet një inxhinier elektrik i specializuar për të komanduar sistemin e ndriçimit në mënyrë të kombinuar, të cilat do të furnizohen nga kuadrot respektive, në mënyrë që mos të ketë problematika të tej zgjatura me mungesën elektrike në qytet dhe në çdo familje të bashkisë Gramsh.

Sqarohet se gjatë kryerjes së punimeve, kanë ndodhur realisht avari të tilla, ku ka lindur nevoja për inxhinier elektrik, i cili në bashkëpunim me punonjësit e OSHEE kanë bërë të mundur kthimin e gjendjes në normalitet.

2. Në lidhje me kërkesën 2.3.7 e DST për kriterin e vendosur për 1 ekspert të auditimit të energjisë NJP ka gjykuar të arsyeshme pasi, është eksperti i licencuar për performancën e energjisë. Në rast të avarive të ndryshme që mund të ndodhin gjatë kryerjes së punimeve, ai është eksperti i energjisë që do shoqërojë dhe këshillojë në përzgjedhjen e materialeve dhe të sistemeve teknike në përputhje me parametrat e kërkesave minimale të performancës së energjisë. E gjithë kjo për të hartuar në mënyrën dhe në kohën e duhur projektin që i përgjigjet standardeve të kërkesave minimale, duke evituar kështu kosto të shtuara për ndryshime të vazhdueshme të projektit, deri në realizimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave.

3. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.7 e DST për kriterin e kërkuar për 1 agronom NJP ka gjykuar të arsyeshëm si kriter pasi mund të ndodhë që gjatë kryerjes së punimeve mund të dëmtohen pemë të mbjella (duke qenë se objekti i prokurimit kalon nëpër një shtrirje të konsiderueshme të qytetit, përfshirë rrugë kryesore, trotuare dhe rrugica ku aktualisht ka pemë të mbjella). Për këtë arsye është i nevojshëm një specialist agronom për të trajtuar veprimtarinë jetësore të pemëve të dëmtuara, në kushtet e caktuara të mjedisit.

4. Në lidhje me pikën 2.3.7 e DST për kriterin e vendosur për 3 inxhinierë topograf NJP ka menduar të arsyeshme vendosjen e këtij kriteri duke qenë se objekti i prokurimit është i llojit “ Rikonstruksion Ujësjiellësi”, topografët janë të nevojshëm për të bërë matje topografike të terrenit sepse ky objekt kërkon kuotime, nivelime, pjerrësi të detajuara dhe specifikuar. Numri i tyre është vendosur duke u marrë për bazë fakti që do të punohet njëkohësisht në zona (lagje) të ndryshme të qytetit, i cili shtrihet në një terren me disnivele të mëdha, duke filluar nga kuota 175 m mbi nivelin e detit deri në kuotën 285 m mbi nivelin e detit, në 3 tarraca lumore. Për shkak të këtyre disniveleve pjesët e objektit janë të padukshme dhe për këtë arsye duhet që 3 topografët të vendosen në 3 pika me nivele të ndryshme.

5. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.7 e DST për kriterin e kërkuar për 1 inxhinier elektronik NJP ka gjykuar të arsyeshme vendosjen e këtij kriteri pasi është i nevojshëm për

mbarëvajtjen e mjeteve elektronike që do të jenë pjesë për kryerjen e proceseve të punës të parashikuara në preventiv.

6.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.7 e DST për kriterin e fuqisë punëtore 195 punonjës për periudhën Korrik 2018 – Korrik 2019 NJP mendon se janë të domosdoshëm një numër i tillë personash të siguruar duke u bazuar në zërat e preventivit që janë parashikuar, si dhe kohëzgjatjen e tyre, në të cilën do të realizohet objekti, duke përfshirë edhe stafin tekniko - menaxherial, specialist të ndryshëm të cilët janë të diktuar, si dhe nga lloji i makinerive të kërkuara.

7.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.10 e DST për kriterin për 42 punonjës me dëshmi teknike më poshtë ju sqarojmë në mënyrë të argumentuar për çdo punonjës sipas rastit:

-Teknik Ndërtimi (2) - janë të domosdoshëm për ndjekjen e proceseve të punës në terren, si dhe mbajtjen e kohëshënuesit për gjatë gjithë kohës së kryerjes së punimeve kjo për arsye të volumeve dhe zërave të shumtë dhe shtrirjes në një kantier me sipërfaqe të madhe është e nevojshme marrje pjesë e dy teknikeve të ndërtimit për realizimin e projektit

-Specialist ndërtimi (9) - Janë të nevojshëm sepse do të kryejnë të gjitha proceset ndërtimore të punës të parashikuara në projekt – preventiv.

-Saldator (2) - Janë të nevojshëm për saldimin e tubave të cilat janë parashikuar si zëra në preventiv.

-Hidraulik (6) - Janë të nevojshëm për të kryer të gjitha proceset e punës të parashikuara në preventiv, si psh për pjesët hidraulike të depos.

-Elektro/mekanik (1) - Është i nevojshëm për kontrollin dhe mbarëvajtjen e punës së mjeteve që do të përdoren gjatë kryerjes së punimeve.

-Elektracist (4) - Janë të nevojshëm në rastet kur mund të ndodhë ndonjë avari gjatë procesit të punimeve, pasi aty ku kalon objekti i prokurimit shtrihet rrjeti elektrik i qytetit.

-Hekurkthyes (4) - Duhet për kthimin e hekurit në elementet beton arme që janë parashikuar në objekt.

-Karpentier (2) – Duhet për ngritjen e armaturave gjatë punimeve të betonit

-Bojaxhi (2) Duhet për kryerjen e proceseve të lyerjes të cilat janë parashikuar në preventive

-Hidroizolues (2) - Janë të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës për izolimin e tarracës, soletës të parashikuara në preventiv.

-Manovrator (8) – Janë të nevojshëm për drejtimin e makinerive të rënda që do të përdoren gjatë kryerjes së punimeve.

8.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.12 e DST për kriterin e kërkuar për licencë për Stacion Transferimi për mbetje jo të rrezikshme Kodi III.1.A dhe jo më larg se 30 km nga objekti i prokurimit, NJP ka gjykuar të arsyeshme vendosjen e këtij kriteri për arsyen e mëposhtme: Për largimin e mbetjeve teknologjike dhe të rrezikshme nga tubacionet plastike apo përdorimin e materialeve të tjera për bashkimin e tyre si dhe heqjen e tubacioneve të degraduara ekzistuese për të mos shkaktuar ndotje të mjedisit është përshtatur në kushte dhe distancën që ka objekti i prokurimit nga vend depozitimi. Këto lloj mbetjesh dërgohen në landfillin më të afërt të bashkisë Gramsh.

9.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.19 e DST për kriterin e kërkuar për mjetet dhe pajisjet teknike po ju sqarojmë si më poshtë të argumentuar çdo mjet i cili është vendosur si kriter nga NJP.

-Kamion vetëshkarkues – Këto makineri janë të nevojshme për transport, furnizim dhe largimin e mbetjeve që do të krijohen në objekt, transportin e materialeve inerte me peshë vëllimore të madhe, tërheqjen e rimorkiatorëve etj.

-Kamionçinë deri në 3.5 ton – Këto makineri duhen për lëvizjen e materialeve me volume të vogla brenda kantierit, referuar zërave të punimeve në projekt si tombino, armatura, çimento, punëtori, inerte, etj. për të cilat do të jenë të domosdoshme transporti i tyre brenda kantierit.

-Autovinxh - Këto makineri duhen për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve në objekt, referuar volumeve projekt preventiv si dhe kohëzgjatjes për kryerjen e punimeve në zërat elemente të parapërgatitura b/a.

-Ekskavator me zinxhirë - Këto makineri duhen për të realizuar proceset e gërmimit në volume të madha si dhe në terrene me dhera me fortësi të madhe.

-Fadromë me goma - Është e nevojshme si makineri sepse kantieri i ndërtimit për këtë objekt është konsiderueshëm i madh dhe për këtë arsye fadroma duhet me goma për lëvizjen sa më të shpejtë dhe me efektive të saj. Gjithashtu kjo makineri është e domosdoshme për sistemimet e zërit shtresë çakëlli, shtrese zhavorri, shtresë rëre, shtresa të dherave, mbushje dhe nivelime të ndryshme në realizimin e projektit në volume të mëdha të këtyre zërave referuar kohështrirjes së realizimit të projektit.

-Minifadromë (bobcat) - Këto makineri duhen për gërmime të vogla si hapje kanalesh anësore, sistemim pusetash etj., si dhe nivelimin, sistemimit, mbushje me rërë tubacioni ujësjellësi etj.

-Rrula - Këto makineri duhen për realizimin e proceseve që kërkojnë peshë më të rëndë, si çakulli, zhavorri etj., për ngjeshjen e shtresave.

-Vinxh ekskavator për punime në thellësi - Ky mjet është i nevojshëm për të kryer punimet në vende me depresion siç janë përrenjtë (konkretisht janë 3 përrenj) që përshkojnë qytetin nga L - P.

-Asfaltoshtruese - Këto makineri janë të nevojshëm për shtrimin e asfaltit në pjesët ku është bërë hapja e kanaleve dhe do të duhet kthimi i rrugës në gjendjen e mëparshme.

-Grejder - Kjo makineri duhet për gërmimin e dheut dhe transportimin e tij në distancë nga 100 - 500 m.

-Autovinxh me krah horizontal jo më pak se 30 m (shoqëruar me skedë teknike dhe foto) - Këto makineri janë të nevojshme për transportimin e pjesëve speciale në vendet e përcaktuar në projekt dhe ku nuk mund të kalohet me mjete të tjera transporti.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Sa i përket konstatimit se OE "M." shpk nuk disponon kategorinë e licencës NP-7D, sqarojmë se:

Bashkimi i operatorëve Ekonomikë krijohet me qëllim bashkimi e kapaciteteve të tyre ekonomikë, teknike, profesionale financiare me qëllim pjesëmarrjen e tyre një procedurë sipas akt marrëveshjes së nënshkruar paraprakisht.

Me anë të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur mes dy anëtarëve të BOE për këtë procedurë prokurimi është bërë edhe ndarja e punimeve ku OE "M." shpk ka marrë përsipër 30% të punimeve.

Referuar zërave të punimeve të marra përsipër nga "M." shpk, nga zëri me nr. rendor 1 deri në zërin më nr.14 janë zëra punimesh për të cilat kërkohet kategoria NP 1, po kështu në preventiv "M." shpk ka marrë përsipër rrugë shërbimi për në depo 178,139 lekë, punime ndërtimi në depo 3,442,815 lekë, rikonstrukcion 2 dhomat e manovrimit 259,396 lekë, rikonstrukcion 69,960 lekë, mjedisi 418 828 lekë, rikonstrukcion godine 147,892 lekë.

Po të mblidhen shumat e të gjithë zërave të punimeve të cilat kërkojnë një kategori tjetër licence dhe jo NP 7, vlera e punimeve që kërkojnë kategorinë NP 7 të punimeve arrin shifrën nën 50 milionë lekë, për të cilën kërkohet kategoria NP-7 B.

Rëndësia e përcaktimit të zërave konkretë që do të kryejë secili nga anëtarët e bashkimit qëndron pikërisht në përmbushjen e kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që është marrë përsipër të realizohet nga secili prej tyre. Kështu që OE "M." shpk ka kategorinë përkatëse të licencës në bazë të përbindjes së punimeve të marra përsipër sipas zërave konkretë të tyre. Për këtë i jemi referuar edhe praktikave të vendimeve të KPP-së lidhur me përcaktimet si më sipër.

2.Edhe kriteri për 2 bojaxhi konsiderohet i përmbushur pasi punonjësit të cilët janë deklaruar si bojaxhinj kanë profesion të përafërt me këtë profesion, siç janë muratorët, suvaturesit. Gjithashtu përveç I. D. që ka dokumentacionin e rregullt, edhe A. Sh. kontratën dhe dëshminë e sigurimit teknik e ka për bojaxhi. Kështu që KVO e ka konsideruar të përmbushur kriterin për 2 bojaxhi.(bashkëngjitur dokumentet).

3.Sa i përket plotësimit të kriterit për 2 autovinxh me krahë horizontal jo më pak se 30m BOE ka dorëzuar dokumentacion për 2 mjetet me qira autovinxha nga T. M. ku përcaktohet krahu i tyre 53 m në kontratën e qirasë së lidhur mes palëve (bashkëngjitur kontrata).

4.Sa i përket numrit të punëtorëve OE "M." shpk, referuar listë pagesave të dorëzuara e plotëson numrin prej 58 punonjësish për periudhën e përcaktuar në DST.

5.Konstatimet e tjera konsiderohen devijime të vogla që nuk e cenojnë në thelb ofertën.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Në lidhje me mos përmbushjen e kriterit **2.3.7/10 të DST** për 1 inxhinier gjeolog, pasi inxhinieri i deklaruar nga OE "M." shpk, J. A., rezultoi i punësuar në shkurt të vitit 2019, dhe nuk figuron në listë pagesa për periudhën Korrik 2018 – Janar 2019, ndërkohë në DST, kërkohet që fuqia punëtore e deklaruar të jetë për periudhën Korrik 2018 – Korrik 2019 dhe kriterit **2.3.22 të DST** për certifikatën ISO RS8000 (përgjegjësia sociale mbi ndërtimin dhe mirëmbajtja e rrugëve, ndërtesave dhe ujësjellës kanalizimeve). Certifikata e OE "A." shpk, rezultoi se është jashtë afateve të vlefshmërisë së saj nga data 16.08.2019, ndërkohë data e zhvillimit të tenderit është 09.09.2019, pretendimet e KVO se mangësitë konsiderohen devijime të vogla që nuk e cenojnë në thelb ofertën, sqarojmë se:

Në referim të LPP dhe akteve të dala në zbatim, është në kompetencën tuaj trajtimi dhe vlerësimi i mangësive dhe pasaktësive të dokumentacionit të paraqitur nga çdo OE/BOE pjesëmarrës, qëndrim i cili duhet të materializohet nga ana juaj nëpërmjet trajtimit rast pas rasti në raportin përmbledh apo çdo akt tjetër të nxjerrë/prodhuar nga KVO, dhe që i paraqitet për njohje e miratim Titullarit të AK.

Procedurat e periudhës 01.01.2020 – 31.12.2020

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01/01/2020 – 31/12/2020, nga Bashkia Gramsh referuar të dhënave të regjistrimit të prokurimeve ka kryer gjithsej **26** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 316,912 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 301,362 mijë lekë, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën 15,279 mijë lekë ose 5 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënave janë në pasqyrë si vijon:

Procedura 01/01/2020 - 31/12/2020	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
GJITHESEJ	26	316,912,193	301,632,801
-Të hapura	5	245,693,322	234,282,997

Procedura 01/01/2020 - 31/12/2020	Nr.	VI.Fond Limit	VI.Kontrate
- Kërkesë me propozim	19	66,623,037	62,820,109
- Negocim pa shpallje	2	4,595,834	4,529,695
Sipas objekteve	26	316,912,193	301,632,801
-Objekte në fushën e investimeve	7	145,720,209	138,240,124
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	19	171,191,984	163,392,677

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **95** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **24** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **7** procedura ose 27 % e procedurave të zhvilluara, veprime të cilat tregojnë se kriteret e aplikuara nga AK Bashkia Gramsh janë të rënduara të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve në procedura.

- Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut, grupi i auditimit nga **26** procedura prokurimi të zhvilluara me vlerë kontrate 301,632 mijë lekë, vlerësoj për auditimin e **12** procedurave me vlerë kontrate 295,672 mijë lekë ose 98% e vlerës së kontratave të lidhura.

-Në të gjitha procedurat e audituara, konstatohet se nga KVO janë mbajtur procesverbalet për hapat e zhvillimit të procedurës, veprime në përputhje me nenin 64 pika 5 dhe nenit 68 të VKM nr. 914, datë 27.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Nga auditimi i **11** procedurave me vlerë kontratë 279,022 mijë lekë, u konstatua se janë në shkelje të akteve ligjore/ nënligjorë të LPP, gjithsej **10** procedura me vlerë kontratë **259,677 mijë lekë ose 93 %** e vlerës së kontratave të audituara, ku në **7** raste kriteret e aplikuara nga AK nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedura dhe në **4** raste OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST, pasi ka mangësi në plotësimin e tyre, OE i shpallur fitues ka mangësi në plotësimin e DST, në vlerën **26,823 mijë lekë** pa TVSH, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, **për të cilën ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJHDT dhe KVO sipas procedurave, si më poshtë vijon:**

7. Tenderi me objekt: “Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj”, me këto të dhëna:

g. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 22 Prot., datë 10.02.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 22 Prot., datë 10.02.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /Ing.ndertimi- anëtar A. Rr. / Ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 23 Prot., datë 10.02.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar Q. P.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedure e hapur,”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 9,996,545 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE -"G.Z."sh.p.k& "V."sh.p.k 9,515,948 lekë, me lidhje kontrate datë 09.07.2020 me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 480,597 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 22.04.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-PO; APP-s’ka; KPP-s’ka Modifikim dok.	12. Përgjigje Ankesës nga AK Modifikim dokumentesh 1. “Sh.” shpk nr.983/2 prot date	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: Po Vendim KPP nr.202/2020,

1. "Sh." shpk nr.983 prot date 05.03.2020	06.03.2020, mospranim	mospranim ankese
2. "Z." nr.907 prot date 02.03.2020 Vlerësim "Sh." shpk nr.1481 prot date 06.05.2020	2. "Z." nr.907/2 prot date 03.03.2020, pranim pjesërisht Vlerësim "Sh." shpk nr.1481/2 prot datë 13.05.2020,pranim pjesërisht	

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3/i** e DST e cila kërkon kategorinë e licencës NS-19A (Sisteme kundra zhurmës), është kërkesë e paargumentuara pasi nuk ka zëra punimesh në preventiv për të kërkuar këtë kategori të licencës.

2.Kërkesa e pikës **2.3.5** e cila kërkon "Ekspert për ndikimin në mjedis", është kërkesë e paargumentuar. Ekspertiza për ndikimin në mjedis bëhen gjatë planifikimit të projektit.

3.Kërkesat pikës **2.3.9** e cila kërkon certifikata ISO 9001:2015, ISO 39001:2012, PASS 99:2012 dhe QKL për impiante për prodhim ose furnizim të materialeve që do përdorin në ndërtim për kontratat e furnizimit/autorizime ku të përfshihen **inerte, betone;**

Kërkesa për ISO 9001:2015, ISO 18001:2007, ISO 14001-2015, shoqëruar me certifikatë konformiteti ASTM A 615 dhe DIN 488-2 ku të përfshihet materiali **hekur;**

Kërkesa për certifikata ISO 9001:2015, ISO 18001-2007, ISO 14001-2015 për materialet tuba rakorderi etj;

Kërkesa për certifikata ISO 9001-2015 për materialet pllaka trotuari betoni, bordura betoni, puseta betoni, tuba betoni etj.

-Kërkesat për certifikatat e cilësisë, për materialet e mësipërme, janë kërkesa të paargumentuara, të cilat nuk i shërbejnë AK. Vlera e përgjithshme e kësaj procedure është modeste dhe zërat janë minimalë për të kërkuar një numër kaq të lartë certifikatash.

Gjithashtu, këto kërkesa për certifikata cilësie nuk mund tu kërkohen subjekteve të cilat nuk janë pjesëmarrëse në këtë procedurë.

4.Kërkesat e pikës **2.3.11** të DST, për mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate, janë të paargumentuara, dhe jo në përputhje me preventivin e punimeve.

-Kërkesat për 2 kamionçina 1-2 Ton kapacitet mbajtës, 2 kamionçina me vinxh me kapacitet mbajtës **deri 1 Ton** nuk argumentohet teknikisht. AK nuk specifikon nevojën për këto mjete me kapacitet ndërmjet 1 deri 2 Ton, dhe aq më pak për 2 kamionçina, ku kërkohet në mënyrë eksplicite kapaciteti mbajtës deri në 1 Ton.

-Kërkesa për 2 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 deri 5 Ton, 2 kamionë me kapacitet mbajtës 12 deri 17 Ton, dhe 1 kamion me kapacitet mbajtës 8 deri 10 Ton, është tjetër kërkesë e paargumentuar teknikisht. Kërkesa për 3 kategori kamionësh duke vendosur kufij minimalë dhe maksimalë, është kërkesë kufizuese, jo e argumentuar, e cila përbën kufizim për OE, dhe nuk i shërben AK.

-Kërkesa për 1 kontejner, është kërkesë jo thelbësore, e cila nuk është kërkuar në procedurat tjera nga kjo AK.

Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE "G. Z." Shpk nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/g** për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 129/1 prot., datë

31.03.2020, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë, duke përfshirë muajin Shkurt. Në kushtet kur hapja e vlerësimit të kësaj procedure është data 22.04.2020, OE duhej të likuidonte faturat e maturuar të muajit Mars 2020 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.OE “V.” shpk, nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/g** të DST për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE nuk ka paraqitur vërtetim për likuidimin e faturave të energjisë elektrike.

3.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 2 specialist ndërtimi, pasi punonjësit e OE “V.” shpk A. M. dhe E. B., kanë dëshminë e sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë.

4.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST** për 2 specialist pllakashtrues, pasi njëri nga punonjësit L. K. ka dëshminë e sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë, si dhe për 2 hekurkthyes/montator, pasi punonjësi Servet Sulmina ka dëshminë e sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë.

5.BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.9 të DST** për certifikatat **ISO 18001-2007, ISO 14001-2015 shoqëruar me certifikatat e konformitetit sipas ASTM A 615 dhe DIN 488-2** për materialin hekur. OE V. ka paraqitur autorizim nga subjekti “R.” shpk për furnizim të materialeve Hekur. Ky subjekt ka lidhur kontratë furnizimi me subjektin K. sh.a, por certifikatat ISO të cituara më sipër, rezultojnë të gjitha jashtë afatit të vlefshmërisë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. G., z. A. Rr. dhe znj. E. I., si dhe anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. Q. P.**

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **9,515,948 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Prendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3/i e DST e cila kërkon kategorinë e licencës NS – 19A (Sisteme kundra zhurmës) ju sqarojmë se NJP ka gjykuar të arsyeshme vendosjen e këtyre kriterëve përkatësisht:

-NS-19A Duke qenë se objekti i prokurimit është rrugë brenda qendrave të banuara duhet marrë në konsideratë edhe mirëmbajta akustike e objektit për zhurmën me origjinë rrugore që do të shkaktohet për komunitetin e bashkisë Gramsh.

2.Në lidhje me e pikës 2.3.5 e cila kërkon një Ekspert për ndikimin në mjedis ku ju keni cituar se ekspertiza e ndikimit në mjedis bëhet gjatë planifikimit të objektit, ju bëjmë me dije se një ekspert mjedisi është edhe person (i cili është i certifikuar në fushën e mjedisit) që shqetësohet dhe / ose mbron për ruajtjen e mjedisit dhe jo domosdoshmërisht duhet të kryej raporte vlerësimi. AK bashkia Gramsh ka për qëllim ruajtjen e mjedisit dhe kufizimin e ndikimit nga ndotjet në mjedis. Vlerësimi i impaktit në mjedis ka shumë mënyra, metoda dhe modele e për këtë qëllim duhet të jetë eksperti në mënyrë që ti njohë e ti përdori ato në kushtet konkrete në të cilat ndodhen. Për sa më sipër NJP ka gjykuar të arsyeshëm këtë kriter për ta bërë procesin e mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve sa më eficient dhe sa më shumë të menaxhueshëm.

3.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.9 e cila kërkon certifikata ISO 9001 : 2015, ISO 39001 : 2012, PASS 99 : 2012 dhe QKL për impiante për prodhim ose furnizim të materialeve që do të përdorin në ndërtim, për kontratat e furnizimit/autorizime ku përfshihen inerte, betone; Kërkesa për ISO 9001:2015, ISO 18001 : 2007, ISO 14001 : 2015 shoqëruar me certifikatë

konformiteti ASTM A 615 dhe DIN 488 – 2 ku përfshihet materiali hekur; Kërkesa për certifikata ISO 9001 : 2015, ISO 18001 – 2007, ISO 14001 – 2015 për materialet tuba rakorderi etj; Kërkesa për certifikata ISO 9001 – 2015 për materialet pllaka trotuari betoni, bordure betoni, puseta betoni, tuba betoni etj, ju sjellim në vëmendje se sistemi i certifikimit është shumë i rëndësishëm jo vetëm nga pikëpamja e imazhit të një OE, por mbi të gjitha si një konfirmim i cilësisë dhe sigurisë më të lartë të produkteve që prodhohen. Një certifikatë konformiteti i një produkti është një dokument që konfirmon zyrtarisht cilësinë e tij. Për AK është parim themelor cilësia e produktit në përputhje me kushtet teknike dhe standardet e duhura. Mbi të gjitha, këto certifikata janë të lidhura me zërat e punimeve në preventiv. Përsa më sipër NJP ka gjykuar të arsyeshëm dhe të drejtë vendosjen e këtyre kriterëve.

4. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.11 të DST për mjetet e nevojshme NJP i ka vendosur ato në përputhje me preventivin e punimeve, natyrën dhe volumin e tyre, të cilat po i sqarojmë të argumentuara përkatësisht si më poshtë vijon:

-Kamionçinë vetëshkarkuese kapacitet mbajtës 1-2 Ton - Këto makineri duhen për lëvizjen e materialeve me volume të vogla brenda kantierit.

-Kamionçinë vetëshkarkuese kapacitet mbajtës deri 1T – Këto makineri duhen për shkarkimin e materialeve brenda kantierit. Bëhet fjalë për makineritë pirun ngritëse.

-Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (12 – 17T) – Këto makineri duhen për transportin e materialeve të ndryshme me shumicë, me peshë vëllimore të madhe që do të duhen në objekt, por të marra nga distanca të largëta ndërçytetase. Është vendosur kapaciteti deri 17 ton për të përballuar transportimin e materialeve në kohë optimale brenda afatit të punimeve. Gjithashtu, këto makineri janë të nevojshme për tërheqjen e rimorkiatorëve që do transportojnë mjetet e gërmimit në objekt.

-Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (8 – 10 ton) - Këto makineri janë të nevojshme për transport, furnizim dhe largimin e mbetjeve që do të krijohen në objekt. Është vendosur kapaciteti 8 – 10 ton për të përballuar transportimin e materialeve në kohë optimale brenda afatit të punimeve.

-Kontejner/zyra të lëvizshme - Janë të nevojshme për tu vendosur në kantierin e ndërtimit ku do të realizohet objekti i prokurimit dhe do të shërbejë si zyra për stafin drejtues, i cili me mbarimin e punimeve do të largohet përsëri. Duke qenë objekti i prokurimit është brenda zonës së banimit ku ka intensitet të lartë qarkullimi të mjeteve dhe njerëzve dhe për të shmangur ndërtimin me themele apo mur tulle që kërkojnë më pas prishjen e tyre NJP ka menduar për zgjidhjen me një kontejner të lëvizshëm.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Përsa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje pikën 1 dhe 2 të për mos likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike nga të dy OE, sqarohet se në zbatim të nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur

është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Sa më sipër, OE kanë afat deri në fund të muajit për likuidimin e faturës së muajit për likuidimin e faturave të energjisë elektrike.

2. Në lidhje me kriterin e pikës 2.3.4 të DST për 2 specialist ndërtimi OE “V.” ka paraqitur dokumentacion për 3 specialist ndërtimi A. M., E. B. dhe F. D., për 2 të parët ka përfunduar afati i dëshmisë së sigurimit teknik në muajin prill 2020, pak ditë para zhvillimit të procedurës ndërsa për të fundit skadon afati më 23.07.2020 (pas datës së zhvillimit të procedurës). Gjithashtu ky OE ka dorëzuar dokumentacion edhe për specialistin e ndërtimit b/a M. B. ku afati i s’kadencës së dëshmisë së sigurimit teknik është data 16.07.2020. Duke qene se afati i s’kadencës së 2 dëshmimeve ka qenë pranë datës së zhvillimit të procedurës dhe duke gjykuar që OE mund të ketë aplikuar për shtyrje afati dhe për shkak të kohës së shkurtër deri në datën e tenderit nuk mund të ketë arritur ti nënshkruajë shtyrjen e afatit, si dhe duke qenë se specialist b/a hyn në kategorinë e specialistëve të ndërtimit, KVO ka gjykuar se BOE ka përmbushur kriterin për 2 specialistë ndërtimi duke e konsideruar devijim të vogël.

I njëjti qëndrim është mbajtur edhe lidhur me plotësimin e kriterit për 2 pllakashtrues/montator.

3. Lidhur me certifikatat ISO 18001 -2007, ISO 14001:2015 për materialin hekur për furnizimin nga “K.” sh.a, certifikatat ISO janë rinovuar dhe ndodhen në fund të folderit dhe janë në gjuhë të huaj. Sqarojmë se certifikata ISO 18001 -2007 nuk kërkohet më nga shoqëritë e akreditimit dhe është zëvendësuar me certifikatën ISO 450001:2018, (bashkëngjitur 2 certifikatat).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

8. Tenderi me objekt: “Blerje dru zjarri për nevojat e çerdheve, kopshteve, shkollave dhe konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2020-2021 si dhe zyrat e njësisve administrative”, me këto të dhëna:

h. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje dru zjarri për nevojat e çerdheve, kopshteve, shkollave dhe konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2020-2021 si dhe zyrat e njësisve administrative		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 296 Prot., datë 01.10.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 296 Prot., datë 01.10.2020 E. G./Specialist IT- anëtar K. B. /ekonomiste- anëtar B. C. / ing.pyjore - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 297 Prot., datë 01.10.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar A. J.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,819,000lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - “I.” sh.p.k 5,781,700 lekë, me lidhje kontrate datë 20.11.2020 me afat 30 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 37,300 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 11.11.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 0 OE,

		c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka;KPP-s'ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s'ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

A.Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.2** të DST e cila kërkon vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore për vitet 2019 – 2020. Sipas ekstraktit të QKB, adresa e këtij OE është në Elbasan, ndërkohë nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2019 pranë kësaj bashkie.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/a të DST** për 1 kamion me kapacitet mbajtës mbi 3.5 Ton dhe 2 kamionçina me kapacitet mbajtës deri 3 Ton.

OE ka paraqitur 1 kontratë qiraje me shtetasin V. B. për marrje mjetesh me qira, konkretisht autoveturë me targa AA047FR dhe kamion me targa EL4726B. Nga dokumentacioni në SPE, konstatohet se mjeti me targa AA047FR është autoveturë, dhe nuk përmbush kriterin për kamionçinë, ndërsa për mjetin me targa EL4726B nuk ka asnjë dokumentacion.

Gjithashtu, ky OE ka ngarkuar në SPE dokumentacion për mjetin me targa EL2017B me kapacitet mbajtës 10 Ton, por ky mjet nuk është në pronësi të OE “I.” shpk, por është në emër të subjektit I. B. Këtij mjeti i mungon gjithashtu certifikata e transportit sipas kërkesës së DST.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/c të DST** për një punësim mesatar prej 7 punonjës për 6 muajt e fundit. Nga kontrolli i listëpagesave të paraqitura në OE, rezulton se për periudhën e kërkuar ka mesatarisht 5 punonjës të siguruar, që janë më pak se sa numri i kërkuar në DST.

B.Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të subjektit Gj. B. p.f, i kualifikuar në këtë procedurë, ka rezultuar se nuk përmbush të gjitha kriteret dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/a të DST** për 1 kamion me kapacitet mbajtës mbi 3.5 Ton. Të gjitha mjetet e paraqitura janë poshtë kapacitetit të kërkuar.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.2/e të DST** e cila kërkon për OE të mos ketë kryer vepër penale apo kundërvajtje administrative në fondin pyjor e kullësor kombëtar, lëshuar nga inspektorati i pyjeve. Nuk ka asnjë dokument të paraqitur nga ky inspektorat, që të përcaktojë nëse ky OE ka kryer apo jo vetëm penale apo administrative në fondin pyjor e kullësor kombëtar.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. A. J.**

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **5,781,700 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me pikën 1, sqarohet se për përmbushjen e këtij kriteri OE i shpallur fitues ka dorëzuar në SPE vërtetimin nr.621 prot datë 29.10.2020, se ka shlyer detyrimet e taksave dhe tarifave vendore (bashkëngjitur vërtetimi).

2.Sa i përket konstatimeve të tjera, ashtu si dhe në ballafaqimin e bërë me ju gjatë periudhës së auditimit, mangësitë e konstatuara KVO i ka konsideruar devijime të vogla që nuk cenojnë thelbësisht ofertën, të detyruar edhe për përfundimin e kësaj procedure me shpallje fitues, për shkak të nevojës emergjente për furnizimin me mallin objekt i këtij prokurimi. Kjo procedurë ishte anuluar njëherë nga KVO për shkak të mospjesëmarrjes së asnjë ofertuesi, është rihedhur dhe data e zhvillimit të procedurës ishte data 11.11.2020, ndërkohë që furnizimi(ngrohja) me dru e çerdheve, kopshteve, e shkollave fillon në datë 15.11.2020 dhe përfundon më datë 15 mars, sipas kriterëve të përcaktuara nga ministria përkatëse e arsimit. Për mos dështim në kryerjen e këtij shërbimi (furnizimi) ndaj këtyre shtresave sensitive të shoqërisë, kemi bërë mbylljen e kësaj procedure prokurimi edhe pse me devijime të vogla dhe më pas është bërë shpallja e fituesit dhe lidhja e kontratës pavarësisht tejkalimit të afatit të fillimit të furnizimit të përcaktuar nga ministria përgjegjëse e arsimit, duke shpresuar dhe në mirëkuptimin tuaj për këtë devijim.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

9. Tenderi me objekt: : “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, me këto të dhëna:

i. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 252 Prot., datë 10.08.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 252 Prot., datë 10.08.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar A. Rr. /ing.ndertimi- anëtar K. H. / ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 253 Prot., datë 10.08.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar A. J.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,479,595 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - “2.” sh.p.k 5,469,358 lekë, me lidhje kontrate datë 18.09.2020 me afat 75 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 10,237 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 24.08.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka;KPP-s’ka JO	12. Përgjigje Ankesës nga AK JO	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve dhe vlerësimin e ofertave.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 2.3.4 e DST e cila kërkon ndër të tjera 1 inxhinier gjeomatik, 1 inxhinier kimist teknolog dhe 1 inxhinier materialesh, janë kërkesa të paargumentuara. Zërat e punimeve në preventiv janë të zakonshëm për këto punimet ndërtimore, dhe kërkesat për këto kategori inxhinierësh nuk justifikojnë llojin dhe volumin e punimeve, dhe aq me pak të jenë edhe në listëpagesat e shoqërisë për 12 muajt e fundit. Këto kërkesa përbëjnë kufizim për OE.

2.Kërkesa e pikës 2.3.5/a e DST e cila kërkon 1 drejtues teknik – inxhinier ndërtimit, i cili të jetë i certifikuar sipas modulit B3 të ndërtimit (Menaxhim i emergjencave, impiantet

elektrike, faktorët e rrezikut në ndërtim etj), si dhe të figurojë në listëpagesa për 12 muajt e fundit, është kërkesë e paargumentuar, e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me rregullat e LPP. Kërkesa të tilla nuk i shërbejnë AK, por përbëjnë kufizim për OE.

3. Kërkesa e pikës **2.3.5/a.1 e DST** e cila kërkon Drejtuesi teknik, Inxhinier Ndërtimi “Specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune me standardin OHSAS 18001-2007 dhe “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune” OHSAS 18001-2007, të figurojë në listpagesat me kohë të plotë 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, është kërkesë e paargumentuar dhe e ekzagjeruar. Kërkesa të tilla eksplicite, të cilat kërkojnë inxhinierë ndërtimi, dhe aq me pak drejtues teknik që të disponojnë disa certifikata ISO, pengojnë OE për të paraqitur ofertat e tyre, dhe nuk i shërbejnë AK.

4. Kërkesa e pikës **2.3.5/a.2 e DST** e cila kërkon drejtues teknik 1 inxhinier ndërtimi të jetë i certifikuar me certifikata trajnimi me titull; “Specialist për testimin e performances se produkteve të ndërtimit” e dhënë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj me modulet e mëposhtme:

Moduli 2 “Standardet për sigurinë e cilësisë së produkteve të ndërtimit”

Moduli 3 “Standardet për specifikimet teknike të produkteve të ndërtimit”

Moduli 4 “Standardet për metodat e testimit të produkteve të ndërtimit.”

Të figurojë në listpagesat me kohe të plotë 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit

-Kjo kërkesa është e paargumentuar, e ekzagjeruar dhe jo në përputhje me LPP. Kërkesa të tilla eksplicite, të cilat kërkojnë inxhinierë ndërtimi, dhe aq me pak drejtues teknik që të disponojnë disa certifikata trajnimi, pengojnë OE për të paraqitur ofertat e tyre, dhe nuk i shërbejnë AK.

5. Kërkesa e pikës **2.3.5/b, c e DST** e cila kërkon 1 inxhinier materialesh i certifikuar për markaturën CE, Direktiva 89/106/CCE (Cilësinë e materialeve standarde evropiane CE), si dhe një specialist (inxhinier strukturash) i certifikuar sipas modulit B3 të ndërtimit (menaxhim i emergjencave, impiante elektrike, i zhurmave, faktorët e rrezikut në ndërtim, etj), janë kërkesa haptazi në kundërshtim me LPP. Kërkesa të tilla për inxhinierë me gjitha këto specifikime certifikimesh jo në përputhje me preventivin dhe vlerën e tij, përbëjnë kufizim për OE, dhe nuk i shërbejnë AK.

6. Kërkesa e pikës **2.3.5/d dhe (e) të DST** e cila kërkon 1 teknik ndërtimi i certifikuar përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në punë, me certifikata OHSAS 18001-2007 “Përgjegjës për sigurinë në punë”, dhe kërkesa për 3 specialistë të certifikuar për punime në shkallë dhe montim – çmontim skela, janë kërkesa tjera të paargumentuara nga AK, të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me vlerën e punimeve. Kërkesa të tilla përbëjnë kufizim për OE.

7. Kërkesa e pikës **2.3 e DST** e cila kërkon drejtues teknik 1 inxhinier mekanik me certifikatë trajnimi ISO 9712/2012 direktiva 97/23CE, dhe 1 inxhinier elektrik me certifikatë trajnimi, kontratë pune për verifikimet inspektive elektrike në tension të ulët, direktiva evropiane 2006/95CE i 12.12.2006, janë kërkesa haptazi në kundërshtim me LPP. Kërkesa të tilla, të paargumentuara, jo në përputhje me punimet, nuk përbëjnë gjë tjetër veçse kufizim për OE për të marrë pjesë në procedura prokurimi.

8. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon nga OE leje mjedisore Kodi 1.2.A (mbrojtje nga zjarri), është kërkesë e pakuptueshme, e hartuar gabim, pasi s’ka licenca të tilla.

9. Kërkesa e pikës **2.3.9 e DST** e cila kërkon për zbatimin e kësaj kontrate 1 kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës **8-10 Ton**, Skrep JCB, Bobcat, kontejner stacionar, vinxh pioner, janë kërkesa të ekzagjeruara. Për mjetin kamion me kapacitet mbajtës 8-10 ton, AK

nuk argumenton kufirin minimal mes peshës minimale dhe maksimale të cilët janë shumë të afërt, dhe mund të përbëjnë kufizim për OE. Ndërsa për mjetet Bobcat, Skrep JCB është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 23 të LPP, pasi specifikimet teknike nuk duhet të kenë kërkesa apo referenca të ndonjë marke të veçantë. JCB dhe Bobcat janë marka, dhe kërkesa të tilla duhet shmangur nga AK.

Vlerësimi i kriterëve: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Në lidhje me vlerësimin e OE fitues, u konstatua se nuk plotësonte të gjitha kriteret e vendosura në DST, dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/g** për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimet nr. 718 prot., datë 22.07.2020, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë, duke përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2020, dhe vërtetimin nr. 821 prot., datë 20.08.2020, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë elektrike deri me datë 20.08.2020, **pa përfshirë faturën koherente të muajit Korrik 2020.** Në kushtet kur hapja e vlerësimit të kësaj procedure është data 24.08.2020, OE duhej të likuidonte faturat e maturuar të muajit Korrik 2020 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.OE, nuk përmbush kriterin e pikës **2.3** të DST për drejtues teknik 1 inxhinier elektrik, me certifikatë trajnimi, kontratë pune për verifikimet inspektive elektrike në tension të ulët, Direktiva Evropiane 2006/95/CE i 12.12.2006.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se certifikata e lëshuar për inxhinierin F. Z., rezulton se ka afat vlefshmërie deri me datë 02.12.2019, datë në të cilën duhet të ishte rilëshuar.

3.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.4 të DST**, për 1 inxhinier Gjeomatik, i cili të figurojë në listëpagesa për 12 muajt e fundit. OE ka deklaruar inxhinierin P. T., i cili nuk figuron në listë pagesat e shoqërisë, sipas kërkesës në DST.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. G., znj. K. H. dhe z. A. Rr.**

Ndikimi/Efekti: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **5,469,358 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Prendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier gjeomatik, sqarohet se objekti i prokurimit është në zonë që shkaktohet përmbajtje në sezonin e dimrit nga shirat dhe është i nevojshëm një studim paraprak për bazamentin e këtyre banesave, inxhinieri i materialeve kërkohet për analizimin e materialeve dhe të dhënave, kryerjen e testeve, zgjidhjen e problemeve si dhe sigurimin e kontrollit të cilësisë;

2.Në lidhje me kërkesën për drejtuesin teknik 1 inxhinier ndërtimi i cili duhet të jetë sipas modulit B3 të ndërtimit (menaxhim i emergjencave, impiantet elektrike, i zhurmave etj), sqarohet se është kërkuar pasi objekti i prokurimit përfshin një komunitet të varfër dhe mund të ketë shumë avari nga pamundësia financiar për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, hidraulike etj.

3.Në lidhje me kërkesën për 1 teknik ndërtimi i certifikuar përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në punë, sqarohet se objekti i prokurimit ka të bëjë me rikonstruksion banesash dhe është e nevojshme që tekniku i ndërtimit të jetë i specializuar për punime në lartësi.

4. Në lidhje me kërkesën për 1 inxhinier elektrik me certifikatë trajnimi dhe kontratë pune për verifikimet inspektive në tension të ulët, sqarohet se është kërkuar pasi aty ku do të zbatohet objekti i prokurimit, kalon rrjeti elektrik i qytetit, dhe mund të ndodh që gjatë gërmimeve, të ketë avari elektrike. Gjithashtu në projekt preventiv janë parashikuar zëra punimesh elektrike.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Lidhur me mos likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike, KVO ka sqaruar se është bazuar në vendimin e ERE nr. 109, datë 21.10.2021 (i cituar edhe në procedurat tjera).

2. Në lidhje me inxhinierin F. Z., KVO sqaron se e disponon certifikatën sipas kërkesës së NJP në DST, çka nënkupton se e zotëron kualifikimin e duhur, pavarësisht se certifikata rezulton jashtë afatit të vlefshmërisë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

10. Tenderi me objekt: “Rikonstrukcion i kopshtit nr.1, me këto të dhëna:

j. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i kopshtit nr.1		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 259 Prot., datë 19.08.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 259 Prot., datë 19.08.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar M. A. /ing.ndertimi- anëtar K. H. / ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 260 Prot., datë 19.08.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar A. J.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 8,750,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - "R." sh.p.k 8,706,305 lekë, me lidhje kontrate datë 01.10.2020 me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 43,695 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 14.09.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise + Keshilli Qarkut	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka; KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës 2.3.2 e cila kërkon kategorinë e licencës NS-19A (Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë), është kërkesë jo në përputhje me

preventivin e punimeve. Nuk parashikohen punimeve konkrete për të kërkuar këtë kategori punimesh.

2.Kërkesa e pikës **2.3.3** e cila kërkon 1 inxhinier elektronik (telekomunikacioni), 1 inxhinier mjedisi, 1 topograf dhe 1 arkitekt, janë kërkesa të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me punimet. NJP, nuk ka argumentuar nevojën për ekspertizën e këtyre inxhinierëve. Nuk ka zëra punimesh në preventiv.

3.Kërkesa e pikës **2.3.6** e cila kërkon 1 inxhinier elektrik të pajisur me dëshmi sigurimi teknik nga IQT grupi V, është kërkesë e tepërt, e paargumentuar dhe njëkohësisht e dubluar. Në kërkesën e pikës 2.3.3 të DST është kërkuar 1 inxhinier elektrik, ndërkohë që kërkesa për një tjetër inxhinier elektrik që të jetë i pajisur më dëshmi sigurimi teknik të grupit V, është e ekzagjeruar dhe nuk i shërben AK. Përbën kufizim për OE.

4.Kërkesa e pikës **2.3.10 e DST** e cila kërkon nga OE disponimin e 1 inxhinieri të pajisur me certifikatë për specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë, është kërkesë e tepërt dhe e dubluar. Në pikën **2.3.9** të DST, është kërkuar që OE të ketë njërin nga drejtuesit teknik i cili të disponojë certifikatë trajnimi për përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Sa më sipër, NJP në mënyrë të paargumentuar, e kërkon në dy raste disponimin e 1 inxhinieri me certifikatën e mësipërme. Kjo përbën kërkesë kufizuese për OE.

5.Kërkesa e pikës **2.3.10 e DST** e cila kërkon nga OE 1 punonjës me certifikatë “ekspert për ndihmën dhe parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, është kërkesë e tepërt dhe e dubluar. Në pikën 2.3.8, NJP ka kërkuar nga OE disponimin e mjekut, dhe kërkesa edhe për ekspert nuk përbën gjë tjetër veçse kufizim për OE.

6.Kërkesa e pikës **2.3.13 e DST** e cila kërkon nga OE të disponojë licencë profesionale nga QKL Kodi 1.2.A për mbrojtjen nga zjarri. Kjo kërkesë është e tepërt dhe kufizuese. NJP ka kërkuar në pikën 2.3.12 1 ekspert zjarrfikës, dhe kërkesa edhe për QKL s’përbën gjë tjetër veçse kufizim për OE. Proceset e mbrojtjes kundër zjarrit bëhen në fazën e projektimit.

7.Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon ndër të tjera edhe 2 punonjës elektrikistë, është kërkesë e ekzagjeruar në raport me zërat e preventiv. Punimet elektrike për këtë projekt janë në vlerën e 190,782 lekë, dhe për këtë NJP ka kërkuar njëkohësisht edhe 2 inxhinierë. Këto kërkesa janë kufizuese dhe nuk i shërbejnë AK.

7.1. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon 1 teknik gjeometër, 1 elektromekanik, 2 punonjës hidraulikë **niveli III**, 2 saldatorë, 2 punonjës punime dekorative gipsi, janë kërkesa të ekzagjeruara dhe jo në përputhje me zërat në preventivin e punimeve. Për 1 gjeometër, 1 elektromekanik dhe për 2 punonjësit e gipsit, nuk ka asnjë zë në preventiv për të kërkuar ekspertizën e tyre, ndërkohë për 2 hidraulikët, NJP në mënyrë të paargumentuar ka kërkuar që të kenë certifikim të nivelit III, duke përbërë kriter kufizues i cili nuk i shërben AK.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. G., znj. K. H. dhe z. M. A.**

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me 867/16 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për kategorinë e licencës NS-19A (Sisteme kundër zhurmës për infrastrukturën), sqarohet se objekti i prokurimit është në afërsi të qytetit, dhe i rrethuar me pallate të populluara dhe është e nevojshme sistemi kundër zhurmës.

2.Lidhur me kërkesën për 1 inxhinier telekomunikacioni, mjedisi, topograf dhe arkitekt, sqarohet se ing.telekomunikacioni kërkohet për mirëmbajtjen e kablllove të internetit, ing.mjedisit për ruajtjen e mjedisit dhe kufizim nga ndotjet në mjedis, topografi për nivelime dhe kuotime për procese të ndryshme punimesh dhe arkitekti pasi duhet të bëjë planifikimin hapësinor për pjesën e rrethimit të objektit.

3.Lidhur me kërkesën për 2 elektrikistë, sqarohet se në projektpreventiv janë parashikuar punime elektrike dhe janë të nevojshëm elektrikistët.

4.Në lidhje me kërkesat për 1 teknik gjeometër, 1 elektromekanik, 2 hidraulikë niveli III, 2 saldatorë, sqarohet se gjeometri kërkohet pasi ka kryen matje për procese të ndryshme punimesh, 2 hidraulikët kërkohet pasi ka procese punimesh sipas projektpreventivit, 2 saldatorët kërkohen pasi do bëjnë saldimin e pajisjeve për instalimin e kaldajës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

11. Tenderi me objekt: : “Blerje pjesë këmbimi”, me këto të dhëna:

k. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje pjesë këmbimi”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 128 Prot., datë 12.05.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 128 Prot., datë 12.05.2020	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 129 Prot., datë 12.05.2020
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim,”	E. G. /Specialist IT- anëtar K. Xh. /ekonomiste- anëtar E. I. / Ing.ndertimi - anëtar	A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar E. K.- anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 6,605,825 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) BOE-PF “A. D.” & “K” sh.a 6,505,388 lekë, me lidhje kontrate datë 11.09.2020 me afat 24 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 100,437 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 03.08.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s’ka;KPP-s’ka Modifikim dok. “A.” sh.a nr.1787 prot date 29.05.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK nr.1787/2 prot date 02.06.2020, pranim pjeserisht	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës 2.3.2 e cila kërkon ndër të tjera 2 inxhinierë mekanik të profilit mekanik, nuk është në përputhje me llojin e kontratës, e cila është kontratë furnizimi mallrash.

2.Kërkesa e pikës 2.3.5 e cila kërkon fotografi të ambienteve, të cilat duhet të jenë të rrethuar dhe pajisur me kamera sigurie si brenda servisit dhe në parkim, është në kundërshtim me llojin e kontratës, e cila është kontratë furnizimi. Nuk i shërben AK siguria e magazinës, dhe aq me pak e servisit. Nuk janë të argumentuara.

3.Kërkesa e pikës 2.4 e cila kërkon leje mjedisore Kodi III.1.A nuk është në përputhje me llojin e kontratës. AK nuk argumenton nevojën për të kërkuar këtë certifikatë.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. G., zj. K. Xh. dhe znj. E. I.

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon dy inxhinierë të profilin mekanikë ju sqarojmë se: Njësia e Prokurimit ka gjykuar të arsyeshme këtë kriter pasi inxhinierët mekanikë kanë njohuritë e duhura si nga ana teknologjike ashtu edhe mekanike për automjete të ndryshme, si dhe për pjesët e këmbimit që kërkohen në preventiv nga AK. NJP i ka kërkuar OE të disponojë inxhinierë mekanikë për vet faktin që ata të mos përdorin " riparuesit e mjeteve " për të parë dhe vlerësuar specifikimet e kërkuara nga AK, por të jenë specialistë të fushës të cilët kanë njohuri shkencore dhe të jenë të gatshëm të japin mendime për madhësinë, formën, cilësinë specifike të materialeve për të aktualizuar produktet që AK kërkon të blejë.

2. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.5 e cila kërkon fotografi të ambienteve, të cilat duhet të jenë të rrethuar dhe pajisur me kamera sigurie NJP bazuar në ligjin e prokurimit publik, autoritetet ose entet kontraktore i kërkojnë operatorit ekonomik palë në marrëveshjen kuadër ofertën e tij, sipas nevojës. Duke qenë se në preventivin e mallrave të kërkuara nga ana e AK Bashkia Gramsh gjenden një numër dhe sasi e konsiderueshme zërash për pjesë këmbimi, është kërkuar që operatori ekonomik i cili do të bëjë lëvrimin e mallrave sipas kërkesave të AK sipas nevojave, të ketë të siguruar magazinë ku do të qëndrojnë të magazinuarat mallrat. Për një procedurë sa më transparente në lidhje me mallrat kemi kërkuar që objekti të pajiset me kamera sigurie, në mënyrë që të jetë gjithçka në monitorim.

3. Në lidhje me kërkesën e pikës 2.4 e cila kërkon leje mjedisore Kodi III.1.A ju informojmë se NJP mbështetur në Ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, subjektet të cilat magazinojnë, trajtojnë, riparojnë ose rinovojnë mbetje të pajisjeve elektrike dhe elektronike, apo magazinojnë pjesë të motorëve të makinave, kanë detyrimin për pajisjen me leje mjedisore. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton teknikat më të mira të disponueshme (TMD)-të, për instalimet e kategorisë së tipit A, duke u mbështetur në: a) përdorimin e teknologjisë që shkarkon pak mbetje; b) përdorimin e substancave më pak të rrezikshme; c) rikuperimin dhe riciklimin e mëtejshëm të substancave të përdorura dhe të çliruara nga proceset e punës, aty ku është e mundur; ç) rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve, aty ku është e mundur, etj. Përsa më sipër, një subjekt me fushë aktiviteti tregtim pjesë këmbimi është i detyruar për pajisjen me leje mjedisore për shkak të posedimit të vajrave apo mallrave kimike si dhe mbetjeve që gjenerojnë. Për këtë arsye NJP e ka gjykuar të drejtë vendosjen e këtij kriteri.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1. Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

12. Tenderi me objekt: “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtje e varrezave publike dhe dekori i qytetit”, me këto të dhëna:

1. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtje e varrezave publike dhe dekori i qytetit”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 239 Prot., datë 30.07.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 239 Prot., datë 30.7.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar Q. P. /ekonomiste- anëtar A. Rr. / Ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 240 Prot., datë 30.07.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar A. J.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedure e hapur,”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 105,885,870 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - “K.”sh.p.k 99,899,373 lekë, me lidhje kontrate datë 15.10.2020 me afat 60 muaj.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5,986,497 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 14.09.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b)Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka;KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **3.3.2/b e DST**, e cila kërkon 1 inxhinier gjeofizik, është kërkesë jo në përputhje me llojin e shërbimit objekt prokurimi. Argumentimi i dhënë nga NJP se nevojitet ekspertiza e këtij inxhinieri për efekt të zhvendosjes së varreve dhe evidentimin e mbetjeve mortore, nuk është në përputhje me profilin e inxhinierit të kërkuar.

2.Kërkesa e pikës **2.3.5 e DST**, e cila kërkon licencë QKL Kodi III.7.A “Për shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota, si dhe licenca Kodi II.4 për prodhim dhe tregtim i farave dhe fidanëve, janë kërkesa jo në përputhje dhe jo të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, të cilat përbëjnë kufizim për OE.

3.Kërkesa e pikës **2.3.6 e DST**, e cila kërkon mjetet dhe pajisjet teknike për zbatimin e kësaj kontrate, dhe konkretisht për mjetet Makinë Teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës **3.5-4 Ton**, ekskavator me zinxhirë me goma **12-13 Ton**, ekskavator me zinxhirë gome **5-6 Ton**, 1 makinë hidrombjellje me kapacitet **900-1000 litër**, kamionçinë me kapacitet **6+1 pasagjerë dhe kapacitet 0.9 – 1 Ton**, 1 kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet **3-4 Ton**, kërkesa për 2 makina funerale, **autobus për transport punonjësish me kapacitet 14-17 pasagjerësh**, 1 makinë pick-up (me karroceri) me kapacitet **4+1 pasagjerë dhe 4-5 dyer**, si dhe **1 makinë ATP me kapacitet pasagjerësh 4+1**, janë kërkesa të paargumentuara. Së pari kërkesat për mjetet në të cilat kufiri mes kapacitetit minimal dhe maksimal varion nga 0.5 deri në 1 Ton, janë kërkesa që nuk i shërbejnë AK, dhe mund të përbëjnë kufizim për OE. NJP nuk ka mirë argumentuar teknikisht nevojën për këtë lloj kapaciteti, dhe se sa është e lidhur ngushtë me shërbimin e kërkuar. E njëjta situatë vlen edhe për makinën e hidrombjelljes ku kërkohet kapaciteti 0.9 – 1 Ton. Nuk argumentohet nevoja pikërisht për këtë kapacitet me diferencë vetëm 100 litër ndërmjet peshës minimale dhe maksimale. Së dyti, kërkesa për 1 autobus dhe aq me pak me kapacitet 14-17, është e paargumentuar nga AK, qoftë për kërkesën për këtë mjet, qoftë për kapacitetin 14 - deri 17 punonjës. Kjo kërkesë përbën kufizim për OE. Së treti, kërkesa për kamionçinë me 6+1 dhe me kapacitet 0.9-1 Ton, makinë pik up 4+1 me 4-5 dyer dhe 1 ATP

me kapacitet 4+1 pasagjerë, janë kërkesa të paargumentuara, jo në përputhje me shërbimin objekt prokurimi, të cilat përbëjnë kufizim për OE. AK nuk ka mire argumentuar nevojën për këto mjete.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kritereve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. G., z. Q. P. dhe z. A. Rr..

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kritereve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/16 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën për QKL Kodi III.7.A për shërbime të ekspertizës profesionale lidhur me pyje e kullota dhe licenca Kodi II.4 për prodhimin dhe tregtimin e farave dhe fidanëve, sqarohet se Bashkia Gramsh është një prej bashkive me sipërfaqe të konsiderueshme pyjore dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës studion larmishmërinë e specieve që gjenden në këtë territor. Gjithashtu, kërkesa të tilla kemi hasur edhe në bashki të tjera për procedura të njëjta, dhe ne i kemi vlerësuar si praktika të mira për tu ndjekur.

2.Në lidhje me kërkesat e pikës 2.3.6 për mjete dhe pajisje teknike, sqarohet se:

-Për makinën teknologjike me kapacitet mbajtës 3.5-4 Ton, kërkohet pasi në Bashkinë Gramsh gjenerohen sasi mbetjesh të cilat grumbullohen nga kjo makineri sipas intervaleve të caktuara;

-Për ekskavator me zinxhir gome 12-13 Ton, sqarohet se kërkohet për proceset e gërmimit në volume të mëdha si dhe në terrene me dhera dhe fortësi të madhe;

-Për ekskavatorë me zinxhirë gome 5-6 Ton, sqarohet se kjo makineri kërkohet për gërmime në terrene të vështira ku nuk mund të kalojë ekskavatori i madh;

-Për makineri hidromblesh me kapacitet 900-1000 litër, kërkohet për.....

-Për kamionçinë me kapacitet 6+1 dhe kapacitet 0.9-1 Ton, kërkohet për lëvizjen e materialeve me volume të vogla dhe transportim punëtorësh;

-Për kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet 3-4 Ton, sqarohet se kërkohet transport, furnizim dhe largim mbetjesh që krijohen në objekt, transportin e materialeve inerte me peshë vëllimore të madhe;

-Për mjetin autobus me kapacitet 14-17 pasagjerësh, është kërkuar duke marrë parasysh faktin se territori i cili do mbulohet nga OE ka një shtrirje përtej qytetit dhe distanca 10-15 km, për të cilin është i detyruar transporti i punonjësve;

-Për makinën Pick-Up me kapacitet 4+1 dhe 4-5 dyer, kërkohet për mbledhjen e mbetjeve të gjendura jashtë kontejnerëve;

-Për makinën ATP me kapacitet 4+1, kërkohet pasi është mjet i mbyllur i cili nuk lejon qarkullimin e aromave të pakëndshme tek pasagjerët.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 10 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

13. Tenderi me objekt: “Ndërtimi i varrezave të qytetit”, me këto të dhëna:

m. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i varrezave të qytetit”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 96 Prot., datë 17.03.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 96 Prot., datë 17.03.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /Ing.ndertimi- anëtar A. Rr. / Ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 97 Prot., datë 17.03.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar E. K.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kerkese per propozim,”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 8,328,712 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE -" "I" sh.p.k 6,056,240 lekë, me lidhje kontrate datë 26.08.2020 me afat 75 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,272,472 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 20.07.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 5 OE b)Skualifikuar 4 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s’ka;KPP-s’ka Vleresim “F.” shpk nr.2800 prot date 03.08.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK “F.” shpk nr.2800/2 prot date 04.08.2020, mospranim ankesë	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për vlerësimin e ofertave.

Situata: Vlerësimi i ofertave: Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës në përputhje me nenin 64, pika 5 dhe nenin 68 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se OE i shpallur fitues nuk përmbush kriteret për tu kualifikuar dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.1/g** për likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike. Ky OE ka paraqitur vërtetimin nr. 5300/1 prot., datë 29.06.2020, sipas të cilit ky OE ka likuiduar faturat e energjisë, duke përfshirë faturën koherente të muajit Maj 2020. Në kushtet kur hapja e vlerësimit të kësaj procedure është data 20.07.2020, OE duhej të likuidonte faturën e maturuar të muajit Qershor 2020 për të përmbushur kriterin e vendosur në DST.

2.OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.12 të DST**, për mjetet dhe pajisjet teknike dhe konkretisht për mjetet kamion AA655MC, kamionçinë me targa AA967JC, kamionçinë me targa AA928UH, pasi për këto mjete, licenca e transportit është për vete, dhe jo për të tretë dhe me qira. Gjithashtu, OE nuk përmbush kriterin për mjetin me targa TR7102R (Autobot uji), pasi për këtë mjet nuk ka paraqitur certifikatë transporti. Vlen të theksohet se njëra ndër arsyet e s’kualifikimit të OE “F.” shpk është mungesa e certifikatës së transportit për autobotin e ujit, ndërkohë nuk është vlerësuar si shkelje ndaj OE fitues.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve dhe për vlerësimin e ofertave, duke ngarkuar me **përgjegjësi: anëtarët e KVO z. A. Sh., z. A. Ç. dhe z. E. K.**

Ndikimi/Efekt: Prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{te}) në vlerën **6,056,240 lekë** pa TVSH.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e KVO është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1.Lidhur me likuidimin e faturave të maturuara të energjisë elektrike, sqarimet janë të njëjta si në procedurat e tjera, ku KVO i është referuar vendimit nr. 109 të ERE.

2.Lidhur me piken e dyte të cilën e keni vlerësuar si të pa përmbushur dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 **”Për prokurimin publik”**, i ndryshuar ju sqarojmë si më poshtë:

Nga AK Bashkia Gramsh, Njësia e Prokurimit ka kërkuar ndër të tjera në DST, Kriteret e veçanta, pika 12/b Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) **certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).**

Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006 **”Për prokurimin publik”**, i ndryshuar, në nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 përcakton se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

KVO ,gjatë vlerësimit të ofertave të paraqitura në SPE, bën vlerësimin duke u bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia e Prokurimit duke i vlerësuar sipas përmbajtjes ashtu siç janë shkruar, në përputhje ose jo me natyrën dhe volumet e objektit të prokurimit. Për sa kohë në DST ,njësia e prokurimit ka vendosur kriterin ‘Për mjetet e deklaruara me qira duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) **certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme)**, pa e specifikuar për vete apo për të tretë, KVO nuk mund ta konsiderojë si të pa përmbushur këtë kriter ,ndërkohë që OE ka paraqitur certifikatë për transport mallrash brenda vendit (për vete), për automjetet e cituara në akt-konstatimin e mbajtur nga ana Juaj.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

14. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të ujësjellësit Çekin”, me këto të dhëna:

n. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të ujësjellësit Çekin”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 117 Prot., datë 27.04.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 117 Prot., datë 27.04.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /Ing.ndertimi- anëtar A. Rr. / Ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 118 Prot., datë 27.04.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar A. Sh.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Procedure e hapur,”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 87,332,377 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - “Z.” sh.p.k 82,960,682 lekë, me lidhje kontrate datë 29.07.2020 me afat 60 ditë.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,371,695 lekë

8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 23.06.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 7 OE b) Skualifikuar 6 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s'ka;KPP-s'ka Modifikim dokumentesh 1. "A." sh.p.k ne SPE date 06.05.2020 2. "Sh." shpk nr.1504 prot datë 08.05.2020 Vlerësim 1. BOE "B." sh.p.k & "B." sh.p.k nr.2411 prot date 03.07.2020 2. "V." shpk nr.2403 prot date 03.07.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK Modifikim dokumentesh 1. "A." sh.p.k date 11.05.2020 mospranim ankese 2. "Sh." shpk nr.1504/2 prot datë 11.05.2020, mospranim ankese Vlerësim 1. BOE "B." sh.p.k & "B." sh.p.k nr.2411/2 datë 09.07.2020, mospranim ankese 2. "V." shpk nr.2403/2 datë 09.07.2020 , pranim pjeserisht	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP: s'ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në aplikimin e kriterëve

Situata: Hartimi i kriterëve: 1. Kërkesa e pikës **2.3.4 e DST** e cila kërkon kategoritë e licencës NS-6A dhe NS-19A, janë kërkesa jo në përputhje me preventivin e punimeve.

2. Kërkesa e pikës **2.3.6/1 e DST** e cila kërkon 1 urbanist, është kërkesë jo në përputhje me objektin e prokurimit, pasi nuk janë parashikuar veprimtari për të cilat të jetë e nevojshme ekspertiza e urbanistit.

3. Kërkesa e pikës **2.3.7 e DST**, e cila kërkon nga OE ofertues që të kenë të punësuar specialist për sigurinë në punë, mjekësia në punë dhe mbrojtje nga zjarri, ose kontratë shërbimi nga OE të licencuar në shërbimin *siguria në punë, mjekësia e punës dhe mbrojtja nga zjarri*, është kërkesë e ekzagjuar. AK duhet të mjaftohej me kërkesën për 1 mjek në rast se e vlerësonte të nevojshme, dhe jo të përcaktonte një listë konkrete shërbimesh të cilat nuk përbëjnë gjë tjetër veçse kërkesa kufizuese për OE.

4. Kërkesa e pikës **2.3.8 e DST**, e cila kërkon një numër të lartë mjeteve kamionë (13 kamionë me kapacitete të ndryshme + 7 kamionçina dhe 3 autovinxh), kërkesa për 7 ekskavatorë + 3 fadroma, kërkesa për 6 rrula, janë kërkesa të ekzagjuara, të paargumentuara teknikisht nga NJP, të cilat nuk i shërbejnë AK, por përbëjnë kufizim për OE.

5. Kërkesa e pikës **2.3.9/3 e DST** e cila kërkon për fabrikën e prodhimit të elementeve të betonit 5 lloje të ndryshme certifikatash ISO, është kërkesë e paargumentuar. Duke qenë se shërbimin për elementet e betonit mund të mundësohet nëpërmjet operatorëve të tjerë që nuk janë pjesë e kësaj procedure, atëherë nuk mundet tu kërkohej certifikata apo dokumentacion këtyre subjekteve. E njëjta situatë vlen edhe për pikën **2.3.9/5 dhe 2.3.9/6 të DST** ku AK kërkon certifikatat ISO për kontratat e furnizimit për materialet elektrike dhe hidraulike.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me *përgjegjësi: anëtarët e NJP z. E. G., z. A. Rr. dhe znj. E. I.*

Ndikimi/Efekti: Mos argumentim në aplikimin e kriterëve të vendosura.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.4 të DST e cila kërkon kategorinë e licencës NS - 6A dhe NS - 19A ju sqarojmë si më poshtë:

-NS-6A - Duke qenë se objekti i prokurimit është i llojit rrugë janë të domosdoshme sinjalistikat rrugore jo ndriçuese për të shmangur avaritë që mund të ndodhin gjatë punimeve.

-NS-19A - Duke qenë se objekti i prokurimit është rrugë brenda qendrave të banuara duhet marrë në konsideratë edhe mirëmbajtja akustike e objektit për zhurmën me origjinë rrugore që do të shkaktohet për komunitetin e bashkisë Gramsh.

2.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.6/1 e cila kërkon një urbanist ju sqarojmë se:

-Arkitekti me profil urbanist është i nevojshëm pasi objekti i prokurimit është i llojit rrugë dhe duke qenë se objekti që do të realizohet do të jetë nëpër qendra të banuar, si dhe në brendësi të saj është ndërtimi i ujësjellësit lind nevoja i një urbanisti i cili duhet të bëjë planifikimin hapësinor që është i domosdoshëm për lëvizjen me liri të qarkullimit të njerëzve dhe shërbimeve. Gjithashtu shtrirja urbane e qendrës së banuar kërkon një urbanist për gjykimin e saktë për rrjetet inxhinierike nëntokësorë, si dhe për harmonizimin e hapësirave shlodhëse publike.

3.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.7 të DST e cila kërkon nga OE ofertues të ketë të punësuar specialist për sigurinë në punë, mjekësia në punë dhe mbrojtje nga zjarri, ose kontratë shërbimi nga OE të licencuar në shërbimin siguria në punë, mjekësia në punë dhe mbrojtja nga zjarri, ju sqarojmë se ky nuk është një kriter i ekzagjeruar dhe është plotësisht në përputhje me VKM nr. 362, datë 15.07.2015 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pasi është kërkuar kontratë shërbimi nga shoqëri të licencuara të cilat ofrojnë shërbimin sigurinë në punë, mjekësia në punë si dhe mbrojtje nga zjarri.

4.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.8 e DST e cila kërkon një numër të lartë mjetesh Po ju sqarojmë në mënyrë të detajuar dhe të argumentuar kërkesën e këtyre mjeteve:

-Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (15-20 ton) - Këto makineri janë të nevojshme për transport, furnizim dhe largimin e mbetjeve që do të krijohen në objekt. Është vendosur kapaciteti 15 – 20 ton për të përballuar transportimin e materialeve në kohë optimale brenda afatit të punimeve.

-Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (mbi 20 ton) - Këto makineri duhen për transportin e materialeve inerte me peshë vëllimore të madhe që do të duhen në objekt. Është vendosur kapaciteti mbi 20 ton për të përballuar transportimin e materialeve në kohë optimale brenda afatit të punimeve. Gjithashtu , janë të nevojshme për tërheqjen e rimorkiatorëve që do transportojnë mjetet e gërmimit në objekt.

-Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (10-15 ton) - Këto makineri duhen për transportin e materialeve të shtresave të rrugës, si binder dhe asfalto beton, si dhe për transportin e dheut në gërmimet e realizimit të ujësjellësit.

-Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës (5-10 ton) – Transportin e materialeve në sasi më të vogla në terrene ku nuk kalojnë mjetet e rënda si dhe për transportin e tubove dhe rakorderive për realizimit të ujësjellësit.

-Kamionçinë vetëshkarkuese kapacitet mbajtës deri 3 ton – Këto makineri duhen për lëvizjen e materialeve me volume të vogla brenda kantierit, referuar zërave të punimeve në projekt si tombino, armatura, çimento, punëtori, inerte, etj të cilat do të jenë të domosdoshme transporti i tyre brenda kantierit.

-Autovinç - Këto makineri duhen për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve në objekt, referuar volumeve projekt preventivit si dhe kohëzgjatjes për kryerjen e punimeve në zërat elemente të parapërgatitura b/a(bordura, tombino etj) si dhe ngritjen e shtyllave të ndriçimit.

-Ekskavator me zinxhirë - Këto makineri duhen për të realizuar proceset e gërmimit në volume të madha si dhe në terrene me dhera me fortësi të madhe.

-Ekskavator me goma - Këto makineri janë e nevojshme për gërmim dherash të cilat janë parashikuar si zë në preventiv, në terrene me dhera me fortësi mesatare.

-Miniekskavator - Kjo makineri duhet për kryerjen e punimeve të imta në volume të vogla, duke duke ju referuar projekt preventivit në zërat për linjën e ujësjellësit brenda qendrës së banuar.

-Minifadromë (bobcat) - Kjo makineri duhet për kryerjen e gërmimeve të vogla si hapje kanalesh anësore, sistemim pusetash etj, si dhe nivelimin, sistemimit, mbushje me rërë tubacioni ujësjellësi etj.

-Fadromë me goma - Janë të nevojshme si makineri sepse kantieri i ndërtimit për këtë objekt është konsiderueshëm i madh dhe për këtë arsye fadroma duhet me goma për lëvizjen sa më të shpejtë dhe me efektive të saj. Gjithashtu këto makineri janë të domosdoshme për sistemimet e zërit shtresë çakëll, shtresë zhavorri, shtresë rërë, shtresa të dherave, mbushje dhe nivelime të ndryshme në realizimin e projektit në volume të mëdha të këtyre zërave referuar kohështirjes së realizimit të projektit janë të domosdoshme minimalisht 3 copë fadroma.

-Grejder - Këto makineri duhen për gërmimin e dheut dhe transportimin e tij në distancë nga 100 - 500 m, duke qene se objekti i prokurimit është rruge ka nevojë për nivelimin dhe pjerrësisë së saj.

-Rimorkiator për transportim mjetesh - Kjo makineri duhet për transportin e automjeteve gjate punimeve në kantier.

-Rrul ngjeshësh hekur – hekur (6-8 Ton) - Këto makineri janë të nevojshme për proceset e ngjeshjes së shtresave rrugore.

-Rrul ngjeshës gomë – hekur (10-12 ton) - Kjo makineri duhet për realizimin e proceseve që kërkojnë peshë më të rëndë, si çakulli, zhavorri etj, për ngjeshjen e shtresave me trashësi deri 20 cm (stabilizant, tampon etj).

-Rrul ngjeshës 20 Ton - Këto makineri duhen për realizimin e procesit të rrulimit dhe ngjeshjes së shtresave rrugore si dhe duke u referuar projekt preventivit dhe sipërfaqeve të mëdha, gjeologjisë së zonës, shtresave mbushëse mbi 40 cm sipas pozicionit topografike në projekt.

5.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.9 e DST e cila kërkon për fabrikën e prodhimit të elementëve të betonit 5 certifikata ISO, si dhe për kërkesën e pikës 2.3.9/5 dhe 2.3.9/6 të DST ku kërkojnë certifikata ISO për kontratat e furnizimit për materialet elektrike dhe hidraulike, ju sqarojmë se:

Certifikatat janë kërkuar për të krijuar besueshmëri tek operatorët ekonomikë të cilët disponojnë fabrikën e prodhimit të elementëve të betonit, pasi fabrika e prodhimit të elementëve të betonit mund të jetë edhe në pronësi të OE ofertues. Gjithashtu, mundet që ofertuesi të jetë edhe vetë prodhues qoftë për prodhimin e betonit apo qoftë edhe për materialet elektrike dhe hidraulike.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

15. Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Unaza e qytetit”, me këto të dhëna:

o. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unaza e qytetit”		
1. Urdhër Prokurimi: Nr. 133 Prot., datë 12.05.2020	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Nr. 133 Prot., datë 12.05.2020 E. G. /Specialist IT- anëtar E. I. /Ing.ndertimi- anëtar A. Rr. / Ing.ndertimi - anëtar	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Nr. 134 Prot., datë 12.05.2020 A. Sh. - kryetar A. Ç.- anëtar E. K.- anëtar
2. Lloji i Procedurës “Kërkese per propozim,”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 20,833,042 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) OE - “V.” sh.p.k 20,613,310 lekë, me lidhje kontrate datë 03.08.2020 me afat 60 dite.	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 219,732 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data e hapjes 02.07.2020	9. Burimi Financimit Buxheti i bashkise	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b)Skualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-Po; APP-s’ka;KPP-s’ka Modifikim dokumenta tenderi “A.” shpk nr.1701 prot date 22.05.2020 Vleresim “K.” sh.p.k nr 2617 prot datë 17.07.2020	12. Përgjigje Ankesës nga AK “A.” shpk nr.1701/2 prot date 28.05.2020 ,pranim pjeserisht Vleresim “K.” sh.p.k nr 2617/2 prot datë 17.07.2020 ,mospranim ankese	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP: s’ka

► **Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP në aplikimin e kriterëve .

Situata: Hartimi i kriterëve: 1.Kërkesa e pikës **2.3.2 e DST**, e cila kërkon staf prej 80 punonjësish për periudhën 6 muajt e fundit, është kërkesë e ekzagjeruar, e paargumentuar dhe jo në përputhje me vlerën dhe volumin e punimeve. Kjo kërkesë përbën kufizim për OE.

2.Kërkesa e pikës **2.3.3 e DST**, e cila kërkon ndër të tjera edhe 2 inxhinierë ndërtimi, njëri profil civil dhe tjetri profil transport, si dhe kërkesa për 1 inxhinier mjedisi, janë të paargumentuara. Së pari, kërkesa për 2 inxhinierë ndërtimit, në një procedurë me vlerë 20 milion lekë është e ekzagjeruar. AK duhej të mjaftohej me kërkesën për 1 inxhinier të tillë. Së dyti, kërkesa për 1 inxhinier mjedisi nuk është në përputhje me objektin e kategorisë dhe atë të objektit të prokurimit.

3.Kërsa e pikës **2.3.6 e DST**, e cila kërkon kategorinë e licencës NS-19A, është kërkesë jo në përputhje me natyrën e punës.

4.Kërkesat e pikës **2.3.7 të DST**, të cilat kërkojnë Ekskavator me zinxhir me peshë **25-30 Ton**, ekskavator me zinxhirë me peshë **45-50 Ton**, ekskavator me goma, 2 miniekskavator, **buldozer me peshë 30-40 Ton**, rrul mbi 12 Ton, rrul mbi 8 Ton, rrul mbi 18 Ton, rril 4-5 Ton, rrul deri 0.5 Ton, **ekskavator me zinxhirë mbi 60 Ton me krahë 18 m**, janë kërkesa të ekzagjeruara, të paargumentuara dhe jo në përputhje me vlerën dhe volumin e punimeve. AK nuk argumenton nevojën për 4 ekskavatorë dhe 2 miniekskavatorë, dhe aq më pak me kapacitetet e kërkuara të cilat janë relativisht të mëdha, ku 3 prej ekskavatorëve kërkohen me peshë nga 25 deri mbi 60 Ton, dhe me krahë mbi 18 metër. Kërkesa të tilla nuk i shërbejnë AK, dhe janë kufizuese për OE. Kërkesa për buldozer me peshë 30-40 Ton, nuk argumentohet nga AK, dhe aq më pak kapaciteti shumë i lartë i tonazhit. Gjithashtu, kërkesa për 5 rrula, me kapacitete të ndryshme që variojnë nga 05. Ton deri në mbi 18 Ton, është në vijim të kërkesave të ekzagjeruara dhe të paargumentuara nga AK. Kërkesa për një numër kaq të lartë mjetesh, përfshirë dhe rrulat, nuk përbën gjë tjetër veçse kërkesa kufizuese për OE, duke pamundësuar pjesëmarrjen nëpër tendera publike.

Kriteri: Aktet ligjore e nënligjore të LPP, të trajtuara tek situata e gjetjes.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë në aplikimin e kriterëve, duke ngarkuar me **përgjegjësi:** anëtarët e NJP z. E. G., z. A. Rr. dhe znj. E. I.

Ndikimi/Efekti: Paligjshmëri në hartimin e kriterëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: AK duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga anëtarët e NJP është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 867/17 prot., datë 20.12.2021 si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: 1.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon staf prej 80 punonjësish për periudhën 6 muajt e fundit nga ana NJP është kërkesë e argumentuar dhe në përputhje me vlerën dhe volumin e punimeve. Përsa më sipër po ju sqarojmë në mënyrë të detajuar për përcaktimin e vendosjes së numrit të punonjësve:

- Sipas grafikut të punimeve periudha e ndërtimit të objektit do të jetë 60 ditë punë:

a.Punime përgatitore për skarifikim dhe gjurmim dheu trupi rruge dhe transport 8280 m2 , afati i përcaktuar 60 për këtë kategori pune nevojiten **20 punëtorë.**

b.Punime për tubacion kanalizime e puseta për periudhën kohore 60 ditore për këtë kategori nevojiten **15 punëtorë.**

c.Punime të zërave bordure dhe trotuare për periudhën kohore 60 ditore për këtë kategori nevojiten **15 punëtorë.**

d.Punime për kuneta betoni anësore për periudhën kohore 60 ditore për këtë kategori nevojiten **10 punëtorë.**

e.Punime për punime shtresa rrugore asfalti për periudhën kohore 60 ditore për këtë kategori nevojiten **9 punëtorë.**

f.Punime të ndryshme sinjalistike etj për periudhën kohore 60 ditore për këtë kategori nevojiten **6 punëtorë.**

h.Roje objekti **1 punëtor.**

i.Roje objekti **1 punëtor.**

j.Stafi tekniko – menaxherial, duke përfshirë stafin drejtues (si administrator, ekonomist, jurist etj).

2.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.3 e DST e cila kërkon 2 inxhinierë ndërtimi, njëri profil civil dhe tjetri profil transport, si dhe kërkesa për një inxhinier mjedisi ju sqarojmë si më poshtë:

-Ing. Ndërtimi 1 (një) profil civil - (Duhet për zbatimin e projektit në terren, duke qenë se ka punime ndërtimore, me procese të ndryshme punimesh të fushës së ndërtimit.

-Ing. Ndërtimi profil infrastrukturë transporti1 (një) – (Kërkohet inxhinier me profil transport pasi objekti i prokurimit është i llojit rrugë dhe duhet të ndjekë proceset përkatëse të punës).

3.Në lidhje me kërkesën e pikës 2.3.6 e DST e cila kërkon kategorinë e licencës NP – 12 A dhe NS 19 A ju sqarojmë si më poshtë:

-NP-12A - Është e nevojshme sepse kërkohet mbrojtja e mjedisit në ambientet përreth nga ndotjet duke parë pozicionin gjeografik dhe mjedisor.

-NS-19A - Duke qenë se objekti i prokurimit është rrugë brenda qendrave të banuara duhet marrë në konsideratë edhe mirëmbajtja akustike e objektit për zhurmën me origjinë rrugore që do të shkaktohet për komunitetin e bashkisë Gramsh.

4.Në lidhje me kërkesën 2.3.7 të DST e cila kërkon impiantin e betonit dhe impiantin e asfalto betonit në një distancë jo më të madhe se 60 km ju bëjmë me dije se ky kriter nuk është aspak kufizues, por i detyrueshëm një përcaktim i tillë pasi kemi të bëjmë me materiale të cilat ngurtësohen dhe ndryshojnë gjendjen e tyre. Teknologjia e betonit ka për detyrë të përcaktojë mënyrën në të cilën do të kryhet kontrollimi i cilësisë së betonit në gjendje të

freskët dhe gjendje të ngurtësuar. Në disa raste duhet të paralajmërojë për rreziqet të cilat dalin nga kushtet e eksplotimit dhe agresiviteti i mjedisit rrethues. Koha e fillimit të prezës së betonit dhe ngurtësimit që fillon nga 45 min deri në 2 orë nga përgatitja e tij nuk kërkon distanca të largëta. Distanca 60 km është me e pranueshmja për mos të penguar procesin normal të hidratimit të çimentos, gjë e cila do të pengonte formësimin e betonit. Karakteristikat e kërkuara të jetëgjatësisë dhe rezistencës mekanike janë efektivisht të arrira, vetëm nëse transporti dhe vendosja në vepër zbatohen me korrektësi.

5. Në lidhje me kërkesat e pikës 2.3.7 të DST në lidhje me mjetet e kërkuara ju sqarojmë se janë të argumentuara dhe në përputhje me objektin e kontratës. Përsa më sipër po ju argumentojmë në mënyrë të detajuar vendosjen e kriterëve për çdo mjet të specifikuar:

-Ekskavator me zinxhir me peshë 25 – 30 ton – Këto makineri janë të nevojshme për prishjen e asfaltit, në ato raste kur asfalti është me penetrim;

-Ekskavator me zinxhir me peshë 45 – 50 ton - Këto makineri duhen për të realizuar proceset e gërmimit në volume të madha si dhe në terrene me dhera më fortësi të madhe. Tonazhi i këtyre makinerive është përcaktuar jo më i madh se 50 ton sepse objekti i prokurimit kalon nëpër disa ura të cilat nuk mund të mbajnë peshë të madhe. Duhet të plotësohen kushtet e kalimit në veprat e artit.

-Ekskavator me goma - Këto makineri janë të nevojshme për gërmim dherash të cilat janë parashikuar si zë në preventiv, në terrene me dhera me fortësi mesatare.

-Miniekskavator - Këto makineri duhet për kryerjen e punimeve të imta në volume të vogla, duke duke ju referuar projekt preventivit në zërat për linjën e ujësjellësit brenda qendrës së banuar.

-Buldozer me peshë 15 – 20 ton - Kjo makineri duhet për të shtyrë sasi të mëdha materialesh gjatë punimeve në objekt.

-Buldozer me peshë 30 – 40 ton – Kjo makineri duhet për të shtyrë sasi të mëdha materialesh gjatë punimeve në objekt, si dhe për të liruar, dendur materiale të ngjeshura.

-Rrul vibrues gome - gome me kapacitet mbi 12 ton - Kjo makineri duhet për realizimin e proceseve që kërkojnë peshë më të rëndë, si çakulli, zhavorri etj, për ngjeshjen e shtresave me trashësi deri 20 cm (stabilizant, tampon etj).

-Rrul vibrues hekur – hekur mbi 8 ton - Këto makineri janë të nevojshme për proceset e ngjeshjes së shtresave rrugore.

-Rrul vibrues mbi 18 Ton – Këto makineri janë të nevojshme për të ngjeshur shtresat e rrugës në mënyrë sa më të mirë.

-Rrul asfalti me peshë 4 – 5 ton – Këto makineri janë të nevojshme për ngjeshjen e shtresave të imta.

-Grejder Këto makineri duhen për gërmimin e dheut dhe transportimin e tij në distancë nga 100 - 500 m, duke qenë se objekti i prokurimit është rrugë ka nevojë për nivelimin dhe pjerrësisë së saj. Gjithashtu këto makineri do të shërbejnë për hapjen uniforme të shtresave të asfaltobetonit në rrugë me një kalim.

6. Në lidhje me kërkesat e pikës 2.3.9 të DST të cilat kërkojnë QKL Kodi III.2.A për vlerësimin në mjedis ju informojmë se ky kriter është në përputhje me objektin e kontratës. Ky kriter ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

Bazuar kjo në ligjet e mëposhtme:

-Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar;

-Ligji Nr. 10440, date 07.07.2011 "Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis";

-VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A,B,C për transferimin e lejeve nga një subjekt të tjetri, të

kushteve të lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB".

Në zbatim të akteve të mësipërm, si dhe në përputhje me zërat e preventivit, mendojmë se është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licencën e mësipërme mjedisore.

Përsa më sipër, këto të dhëna garantojnë kushtet teknike të zbatimit konform standardit shtetëror ndaj është parë e arsyeshme që ky kriter të vendoset.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, audituesit e KLSH sqarojnë se:

1.Observacionet e paraqitura nga subjekti i audituar, janë të njëjtat me ato të paraqitura mbi akt konstatimin nr. 11 dhe janë reflektuar në Projekt Raportin e Auditimit. Subjekti nuk ka paraqitur argumentim apo provë shtesë për të provuar pretendimet e tij. Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

3.3.4. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punëve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Në zbatim të pikës 3.4 të Programit të Auditimit nr. 867/1, datë 03.09.2021, ndryshuar me shkresën nr. 867/3, datë 06.10.2021, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit, si më poshtë:

Për vitin 2019: Janë realizuar 11 investime për punë publike në vlerën **347,169,445 lekë me TVSH.**

Për vitin 2020: Janë realizuar 7 investime për punë publike në vlerën **165,908,149 lekë me TVSH.**

Nga analiza e bërë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës më të lartë të kontratës, llojit të objekteve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të lartë në zbatimin e veprave ndërtimore, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelë (Viti 2019; viti 2020):

Viti 2019

Nr.	Objekti i prokurimit	Fondi limit	Op. Fitues	Vl. Kont. Me tvsh
1	"Rikonstruksion i rrugës automobilistike në fshatin Dufshan, NJA Sult"	1,666,666	BOE R. shpk & V. shpk	1,984,782
2	"Ndërtim muri pritës për kanalin vaditës Liqeni Dushkut dhe F.V tubo plastic për kanale vaditëse në fshatrat Vidhan, Kokël	2,168,375	E. shpk	2,584,728
3	"Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat-Cingar Sipër – Drizë"	28,043,538	BOE A. shpk & B. shpk	32,642,666
4	"Rikonstruksion i kanalit vaditës Poroçan"	1,209,460	E. shpk	1,439,886
5	"Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh"	187,160,013	BOE M. shpk & A. shpk	221,217,966
6	"Ndërtim ure pasarelë fshati Velak, NJA Pishaj"	6,666,085	BOE P. shpk & B. shpk	7,885,224
7	"Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative"	11,937,694	BOE R. shpk & M. shpk	13,655,808
8	"Sistemim asfaltim i lagjes "X", Kocaj"	41,666,667	M. shpk	47,999,596
9	"Ndërtim ambulance në fshatin Silar, NJA Sult"	833,333	"2 N" shpk	927,324
10	"Ndërtimi i tregut të qytetit"	8,333,333	BOE B. shpk & M. shpk	9,598,746
11	"Ndërtim ujësjellësa në NJA Skënderbegas dhe NJA Lenije"	6,249,173	B. shpk	7,232,719
	Totali	295,934,004		347,169,445

Viti 2020

Nr.	Objekti I prokurimit	Fondi limit	Op. Fitues	VI. Kont. Me tvsh
1	“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”	5,479,595	“Z.”sh.p.k	6,563,230
2	“Rikonstruksion i kopshtit nr.	8,750,000	“R.” sh.p.k	10,447,566
3	“Ndërtimi i kanalizimeve të lagjes “Llapushaj”, Gramsh”	4,999,938	BOE-“B.” sh.p.k & “P.”sh.p.k	5,901,937
4	“Ndërtim trotuari nga kasha katolike në fshatin Pishaj”	9,996,545	BOE -“G. Z.”sh.p.k & “V.”sh.p.k	11,419,138
5	“Ndërtimi I varrezave të qytetit”	8,328,712	I. shpk	7,267,488
6	“Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të ujësjellësit Çekin”	87,332,377	Z. shpk	99,552,818
7	“Rikonstruksion i rrugës Unaza e qytetit”	20,833,042	“V.” sh.p.k	24,735,972
Totali		145,720,209		165,908,149

Nga objektet e prokuruar, u konsideruan si objekte me risk dhe u vendos për t’u audituar nga grupi i auditimit investimet/shërbimet si vijon:

Nr	Objekti	Kontraktori	Vlera e kontratës (me TVSH)	Shënime
1	“Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, Bashkia Gramsh	“Z.” SHPK	99,552,818	Audituar
2	“Sistemim Asfaltim i lagjes X”, Bashkia Gramsh	“M.” SHPK	47,999,596	Audituar
3	“Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Gramsh”	M.” SHPK & “A.” SHPK	221,217,966	I paudituar plotësisht

I. “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, Bashkia Gramsh.

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 2768 prot datë 29.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga Titullari z. K. T. dhe Operatorit Ekonomik “Z.” SHPK, me administrator z. D. S., me licencë profesionale NZ 5900/1 datë 28.01.2019. Vlera e kontratës është 99,552,818 lekë me tvsh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 60 ditë (2 muaj) nga dita e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Pas kërkesës së bërë nga mbikëqyrësi i punimeve me nr. 2768/3, datë 14.09.2020 për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të motit të keq, është bërë amendamenti i kontratës me nr. 2768/4, datë 15.09.2020, sipas të cilit është shtyrë data e përfundimit të punimeve me 45 ditë.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2750, datë 28.07.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE “G.” SHPK & “H.” SHPK, me përfaqësues z. G. S., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2928/8 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 950,106 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 3998 prot., datë 19.10.2020, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “B.” SHPK, me përfaqësues z. A. A., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2205/4, datë 04.02.2020 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 142,516 lekë me tvsh.

Objekti është marrë në dorëzim në datën 05.08.2021 dhe është nënshkruar nga Kontraktori, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori, Grupi i punës me përbërje A. Ç., E. I. e F. B. dhe Titullari i AK.

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, në dosje nuk administrohet Leje ndërtimi/leje infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 39 “Leja e ndërtimit”, sipas të cilës “Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji” dhe ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. K. T..

- Vlera e preventivuar e objektit është më e madhe se 100 milion lekë dhe në zbatim të nenit 6, të Ligjit nr. 8402 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar”, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë;

c) objektet me akses publik.”, projekti i këtij objekti duhej t’i ishte nënshtruar oponencës teknike. Në dosje nuk administrohet oponenca teknike e projektit të zbatimit.

Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi titullari i Autoritetit Kontraktor z. K. T..

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “E.”, në Mars 2020 dhe është miratuar nga titullari i AK z. K. T..

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (aktдорëzimi i sheshit, procesverbal i fillimit të punimeve), rezulton se punimet kanë nisur me datë 12.08.2020, duhet të përfundonin në datën 11.10.2020 dhe kanë përfunduar me datë 24.11.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës.

-Me shkresën datë 12.10.2020 sipërmarrësi i punimeve OE “Z.” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “G.” SHPK & “H.” SHPK nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë njoftuar nevojën për ndryshime volumesh dhe përdorim të fondit rezervë dhe kanë formuluar “Procesverbalin për ndryshimin e volumit të punimeve dhe përdorimit të fondit rezervë”, i cili është miratuar nga AK me shkresën nr. 2768/5(a), datë 14.10.2020, me punime që shtohen prej 8,986,732 lekë me TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 8,362,466 lekë me TVSH. Është kërkuar përdorimi i fondit rezervë prej 625,429 lekë me TVSH dhe është miratuar nga AK.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, Bashkia Gramsh		
14.Lidhja e kontratës Nr. 2768 prot datë 29.07.2020	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 99,552,818 lekë OE fitues “Z.” shpk	16.Likuiduar deri dt 09.08.2021 99,546,242 lekë
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera me tvsh 99,546,242 lekë -Vlera pa tvsh 82,955,202 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 60 ditë, Zbatuar 115 ditë. Fillimi punimeve: 12.08.2020 Përfundimi punimeve : 24.11.2020	19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. 2768/4, datë 15.09.2020, 45 ditë

20. Mbikëqyrësi i punimeve "BOE "G." SHPK & "H." SHPK	Licenca Nr: MK 2928/8	Kontrata nr. 2750, datë 28.07.2020	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE "B." SHPK	Licenca Nr: MK 2205/4	Kontrata nr. 3998 prot., datë 19.10.2020	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22. Akt Kolaudimi Datë 12.07.2021	23. Akt i marrjes në dorëzim dt 05.08.2021		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,329,268 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin", Bashkia Gramsh, nga zbatuesi i punimeve OE "Z." SHPK, për zërat e punimeve A.I.3, A.III.12, A.IV.10 dhe B.5.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Mbushje me zhavorr lumi 15 cm në trupin e rrugës", "FV bordura betoni parafabrikat 20x35, çmimi", "FV përcjellës tokëzimi bakri, S=35 mm ² ", "Shtresë rëre poshtë dhe sipër tubit 10 cm", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2768 prot datë 29.07.2020. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2750, datë 28.07.2020. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 3998 prot., datë 19.10.2020.
Ndikimi/Efekt:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Gramsh.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,329,268 lekë pa tvsh nga OE "Z." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2768 prot datë 29.07.2020 me "Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin", <i>Bashkia Gramsh</i> , vlerë kjo e cila

përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,329,268 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. G. S. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. A. A. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

II. “Sistemim Asfaltim i lagjes X”, Bashkia Gramsh

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 4335 prot datë 10.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga Titullari znj. L. D. dhe Operatorit Ekonomik “M.” SHPK, me përfaqësues z. E. B., me licencë profesionale NZ 6803/6. Vlera e kontratës është 47,999,596 lekë me tvsh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 180 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1916, datë 18.03.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “A.” SHPK, me përfaqësues z. E. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2892/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 563,573 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6931 prot., datë 07.11.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE N. M. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0992/3, datë 04.02.2020 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 13,980 lekë me tvsh.

Objekti është marrë në dorëzim në datën 19.12.2019 dhe është nënshkruar nga Kontraktori, Mbikëqyrësi i punimeve, Kolaudatori, Grupi i punës me përbërje A. Ç., E. I. e A. Rr. dhe Titullari i Bashkisë z. K. T..

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, në dosje nuk administrohet Leje ndërtimi/leje infrastrukturore. Ky veprim është në kundërshtim me ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 39 “Leja e ndërtimit”, sipas të cilës “Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji” dhe ngarkon me përgjegjësi ish Kryetarin e Bashkisë znj. L. D..

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “L.”, në vitin 2019 dhe është miratuar nga titullari i AK znj. L. D..

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (aktdorëzimi i sheshit, procesverbal i fillimit të punimeve), rezulton se punimet kanë nisur me datë 12.07.2019, duhet të përfundonin në datën 11.01.2020 dhe kanë përfunduar me datë 09.12.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

-Me shkresën pa datë, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë z. K. T., sipërmarrësi i punimeve OE “M.” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “A.” SHPK, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, kanë njoftuar nevojën për ndryshime volumesh dhe kanë formuluar “Procesverbalin për ndryshimin e volumit të punimeve dhe përdorimit të fondit rezervë”, i cili është miratuar nga AK me shkresën pa datë, me punime që shtohen prej 3,527,010 lekë me TVSH dhe punime që pakësohen në vlerë 3,531,623 lekë me TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar,
2. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
3. Libreza e masave,
4. Ditarit të punimeve, etj.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim Asfaltim i lagjes X”, Bashkia Gramsh				
14.Lidhja e kontratës Nr. 4335 prot datë 10.07.2019	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 47,999,596 lekë OE fitues “M.” shpk		16.Likuiduar	
17- Situacioni Përfundimtar dt 16.02.2019 -Vlera me tvsh 47,994,983 lekë -Vlera pa tvsh 39,995,819 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 180 ditë, Zbatuar 149 ditë. Fillimi punimeve: 12.07.2019 Përfundimi punimeve : 09.122019		19. Zgjatja e kontratës Nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “A.” SHPK	Licenca Nr: MK 2892/3	Kontrata nr. 1916, datë 18.03.2019	Likuiduar lekë	Pa likuiduar
21. Kolaudatori i punimeve OE N. M. PF	Licenca Nr: MK 0992/3	Kontrata nr. 6931 prot., datë 07.11.2019	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
22.Akt Kolaudimi Datë 11.12.2019	23.Akt i marrjes në dorëzim dt 19.12.2019		24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat)	

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **215,538 lekë pa tvsh.**

Titulli i Gjetjes 2:	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemim Asfaltim i lagjes X”, Bashkia Gramsh, nga zbatuesi i punimeve OE “M.” SHPK, për zërat e punimeve II.2, II.4 dhe IV.3.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se: -Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës “Gërmime dheu kasonetë (sek detyruar $b>1$ m)”, “Struktura monolite betoni C 25/30, për mure” dhe “FV bordura betoni p.p 15x25 cm”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
Kriteri:	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4335 prot datë 10.07.2019. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1916, datë 18.03.2019. - Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me

	nr. 6931 prot., datë 07.11.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Gramsh.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 215,538 lekë pa tvsh nga BOE “M.” SHPK., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4335 prot datë 10.07.2019 me “Sistemim Asfaltim i lagjes X”, <i>Bashkia Gramsh</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 215,538 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. E. M., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. N. M., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

III. “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Gramsh”, Bashkia Gramsh

Kontratat

Për objektin e mësipërm është lidhur kontrata për punë publike me nr. 6093 prot., datë 01.10.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh, të përfaqësuar nga Titullari z. K. T. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “M.” SHPK & “A.” SHPK, me përfaqësues respektivisht z. E. B. dhe z. A. K., me licencë profesionale NZ 6803/6. Vlera e kontratës është 221,217,966 lekë me tvsh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 365 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Pas kërkesës së bërë nga mbikëqyrësi i punimeve me nr. 98, datë 15.09.2020 për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të motit të keq dhe pandemisë, është bërë amendamenti i kontratës me nr. 6093/5, datë 19.10.2020, sipas të cilit është shtyrë data e përfundimit të punimeve me 90 ditë, deri në datën 31.12.2020.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6342, datë 10.10.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “A.” SHPK, me përfaqësues z. E. M., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 2892/3 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,187,401 lekë me tvsh.

Projektpreventivi

- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria “L.”, në Maj 2019 dhe është miratuar nga titullari i AK z. K. T..

Zbatimi i punimeve

Nga komunikimi me subjektin, dosja teknike e këtij objekti nuk është dorëzuar në Bashkinë Gramsh.

Nga verifikimi i pagesave sipas bankës, rezulton se deri në datën e mbajtjes së këtij Akt Konstatimi, për këtë objekt janë kryer pagesat e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi	Nr. e faturës	Data	Vlera pa TVSH	TVSH
1	Situacion nr. 1. Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm I ujësjellësit të qytetit Gramsh	41	04.11.2019	17,022,370	3,404,474
2	Situacion nr. 2. Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm I ujësjellësit të qytetit Gramsh	47	12.12.2019	19,847,291	3,969,458
3	Situacion nr. 3. Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm I ujësjellësit të qytetit Gramsh	04	15.04.2020	8,333,904	1,666,781
4	Situacion nr. 4. Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm I ujësjellësit të qytetit Gramsh	33	12.11.2020	41,882,976	8,376,595
5	Situacion nr. 5. Rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm I ujësjellësit të qytetit Gramsh	388	10.02.2021	16,450,356	3,290,071
TOTAL				103,536,897	20,707,379

Nga sa sipër, vlera e mbetur e kontratës (pa situacionuar) është 94,279,976 me TVSH.

Nuk administrohet asnjë korrespondencë ndërmjet investitorit Bashkia Gramsh dhe kontraktorit të punimeve, që të vërtetojë shkaqet e vonesave, apo zbatimin e objektit sipas përcaktimeve të kontratës. Objekti figuron i papërfunduar duke mos arritur qëllimin për të cilin ka filluar ndërtimi, furnizimin me ujë të popullatës së qytetit të Gramshit.

Përsa sipër, në zbatim të nenit 41 të kontratës “Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve”, sipas të cilës “...Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa do të jetë 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht 25% të vlerës së kontratës. Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht 25% të vlerës së kontratës.”, Bashkia Gramsh duhet të kishte filluar mbajtjen e penaliteteve në zbatim të këtij neni të kontratës.

Titulli i Gjetjes :	Mos realizimi i punimeve të ndërtimit brenda afatit dhe mosaplikim të penaliteteve për vonesa në përfundimin e punimeve.
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Gramsh”, Bashkia Gramsh, u konstatua se: -Punimet duhet të përfundonin në datën 31.12.2020 dhe deri në ditën e fundit të auditimit në terren nuk ka dosje teknike që të vërtetojë përfundimin e punimeve. Nga ana tjetër nuk janë aplikuar penalitetet për vonesa në përfundimin e punimeve..
Kriteri:	- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3. - Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6093 prot., datë 01.10.2019

	- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6342, datë 10.10.2019.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mangësive të mësipërme, nuk është plotësuar në kohë qëllimi për të cilin është planifikuar ndërtimi I këtij objekti.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e sipërmarrësit, mbikëqyrësit të punimeve dhe personave përgjegjës në Bashkinë Gramsh.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Nga Bashkia Gramsh, të analizohet mosrealizimi në kohë i objektit “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Gramsh”, të nxirren përgjegjësitë dhe të zbatohen penaltitetet sipas kontratës së punëve civile për këtë objekt, për çdo ditë vonesë në dorëzimin e punimeve.

3.4.1 Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe borxhi tatimor.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për periudhën objekt auditimi, sipas strukturës organizative, për mbledhjen e të ardhurave ka funksionuar Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për vitin 2019 me dy Sektorë: Sektori i tatim – taksa dhe Sektori i Menaxhimit Financiar, me 12 nëpunës, nga të cilët 1 Drejtor Drejtorie, 2 Përgjegjës sektorësh dhe 9 specialistë. Në strukturën organizative të vitit 2020 është ndryshuar emërtimi i saj në Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar e përbërë nga 4 sektorë: Sektori i Menaxhimit Financiar, Sektori i Buxhetit, Sektori i Mbrojtjes Sociale dhe Sektori i Tatim – Taksa, i përbërë nga 19 punonjës nga të cilët 1 Drejtor Drejtorie, 4 Përgjegjës Sektori dhe 14 specialistë.

Paketat fiskale për periudhën objekt auditimi janë miratuar me VKB nr. 99, datë 18.12.2018 “Për miratimin e paketës fiskale”, dhe VKB nr. 96, datë 30.12.2019 “Për miratimin e paketës fiskale”.

Për auditimin e burimit të krijimit të ardhurave dhe përdorimit të tyre u auditua dokumentacioni i paraqitur nga sektori i taksave dhe tarifave vendore si:

- evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifave vendore;
- akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore;
- evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve;
- administrimi i aseteve;
- procedura e lëshimit të licencave dhe autorizimeve;
- dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

► **Titulli i gjetjes:** Mbi mos vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifave nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore.

Situata: Në lidhje me auditimin e kryer për burimin e krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor, u auditua dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar – Sektori i Tatim -

Taksa, për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020. Për vitin 2019, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 85,409 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 53,923 lekë ose 63%. Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e pasurisë mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore, dhe tarifatat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.

Për vitin 2020, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 87,137 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 66,489 lekë ose 76%. Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e pasurisë mbi ndërtesat, taksa e tokës bujqësore, tarifatat e pastrimit, gjelbërimit/ndriçimit.

Arsyet e mosrealizimit, sipas pretendimeve të specialistëve të taksave Bashkia Gramsh janë:

-Taksa e ndërtesës ka ndikuar, pasi përjashtohen familjet me kryefamiljarë invalidë, familjet që marrin ndihmë ekonomike dhe familjet pensioniste çift ose të vetmuara. Ky target familjesh është në numër shumë të lartë në Bashkinë Gramsh.

-Mungesa e kadastrës fiskale për taksën e pronës (ndërtesë) për shkak të mungesës së burimeve njerëzore.

-Si rezultat i fatkeqësive natyrore (Periudha Covid-19) ka patur mjaft problematika në realizimin e të ardhurave të parashikuara, pasi shumë nga subjektet (biznese) për shkak të dëmtimeve apo rënies ekonomike në përgjithësi në këtë komunitet si rezultat i mbylljes pasi zona e Gramshit është shpallur zonë e kuqe për muajt Mars-Qershor 2020.

-Vështirësi haset në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të konflikteve të pronësisë etj dhe mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e Bashkisë.

Vlera e borxhit në 31.12.2020 në mënyrë progresive është në vlerën 43,453,558 lekë.

57 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 4,422,021 lekë,

3937 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 18,203,801 lekë,

5,700 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 14,433,781 lekë,

Debitor qira objekti në vlerën 6,393,955 lekë.

Vlerën e borxhit vetëm për vitin 2019 është në total 7,910,304 lekë

325 biznese në vlerën 620,955 lekë

3113 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 1,959,865 lekë,

Të tjera familjare (ndërtesë, pastrim, gjelbërim) debitorë për taksat dhe tarifatat familjare në vlerën 5,329,484 lekë.

Vlerën e borxhit vetëm për vitin 2020 është në total 8,513,569 lekë

50 biznese në vlerën 993,918 lekë,

2739 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 2,619,499 lekë,

Të tjera familjare (ndërtesë, pastrim, gjelbërim) debitorë për taksat dhe tarifatat familjare në vlerën 4,900,152 lekë.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, nga bizneset, nga ana e drejtorisë së planifikimit të të ardhurave, është mjaftuar vetëm më dërgimin e njoftim detyrimeve për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë.

Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.

Impakti: Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku: Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Gramsh të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **43,453,558 lekë, dhe të ndjek veprimet e mëposhtme:**

Të vazhdoj më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Gjithashtu për të vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore në R.SH” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z.A. B. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë të të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar deri më 17.10.2019.

Z.A. Sh. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë të të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nga periudha 21.10.2019 e në vazhdim

Znj.K. B. me detyrë, përgjegjëse e tatim taksave nga periudha 17.12.2018 deri më 02.10.2019

Z.Sh. K. me detyrë, inspektor i tatim taksave deri më 30.06.2019.

Z.A. J. me detyrë, agjent tatimor dhe nga data 08.10.2019 përgjegjës sektori i tatim taksave.

Z.F. B. me detyrë, inspektor i tatim taksave terreni nga data 24.06.2019 e në vijim

Z.A. N. me detyrë, inspektor tatim taksave familjare nga data 12.12.2019 e në vijim.

3.4.2 Mbi regjistrimin e aseteve dhe të ardhurat nga dhënia me qira e objekteve në varësi të bashkisë.

► **Titulli i gjetjes:** Mbi regjistrimin e aseteve të kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Gramsh.

Situata: Bashkisë Gramsh, me VKM nr. 431, datë 11.07. 2007, VKM 421 datë 02.06.2010 dhe VKM nr.885 datë 03.11.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, Qarkut Elbasan”, është miratuar për Bashkinë Gramsh lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, me **375 prona.** Pas miratimit të transferimit të Pronave nga Qeveria Qendrore, Bashkia Gramsh ka kryer procesin e regjistrimit të pasurive të transferuara në Zyrën Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila është asistuar nga Projekti i USAID për Qeverisjen Vendore.

Nj/Administrative Kushove, me VKM nr. 44, datë 27.01.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, me **561 prona.**

Nj/Administrative Pishaj, me VKM nr. 273, datë 18.04.2012, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose

në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, **me 1273 prona.**

Nj/Administrative Skënderbegas, me VKM nr. 15, datë 12.01.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, **me 903 prona.**

Nj/Administrative Lenie, me VKM nr. 15, datë 12.01.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, **me 702 prona.**

Nj/Administrative Sult, me VKM nr. 507, datë 13.07.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, **me 490 prona.**

Nj/Administrative Kodovjat, me VKM nr. 828, datë 21.11.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, **me 693 prona.**

Nj/Administrative Poroçan, me VKM nr. 661, datë 04.08.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim”, është miratuar lista e pronave të pa luajtshme të ndodhura në territorin dhe juridiksionin e kësaj njësie vendore, **me 634 prona.**

Nj/Administrative Tunjë, me VKM nr. 578, datë 28.05.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të paluajtshme, shtetërore, në komunën Tunjë”, **me 702 prona**, për këtë njësi vendore nuk është miratuar lista përfundimtare.

Nj/Administrative Kukur, me VKM nr. 410, datë 22.04.2009, “Për miratimin e listës së inventarit të paluajtshme, shtetërore, në komunën Tunjë”, **me 509 prona**, për këtë njësi vendore nuk është miratuar lista përfundimtare.

Sa më sipër Bashkia Gramsh nuk ka bërë të mundur që pas bashkimit me ish-Komunat sot Nj/ Administrative të saj për pronat e transferuara të kryej procesin e regjistrimit në ZVRPP, ngritjen e komisionit për vlerësimin e pasurive me çmimin e tregut të si: truall, tokë bujqësore, ndërtesa, pyje, kullota etj., me qëllim vënien e këtyre pronave në efikasitet për dhënien e tyre me qira për realizimin e të ardhurave nga qiradhënia e tyre dhe për dy Nj/Administrative Tunjë dhe Kukur nuk ka përgatitur dokumentacionin ligjorë për miratimin e listës përfundimtare, të pronave për to.

-Bashkia Gramsh, rezulton se ka bërë kërkesa drejtuar ASHK për regjistrimin e tokave bujqësore në përdorim ose në pronësi të saj sipas VKM-ve specifike për secilën prej 9 Njësie Administrative (ish-komunat), por rezulton se ASHK nuk ka vijuar me regjistrimi e tyre pasi VKM-të me anë të së cilës pronat i janë transferuar Bashkisë në pronësi ose në përdorim, janë të përmbledhura në një numër të vetëm rendor, dhe jo me numra specifike që ato kanë. Gjithashtu nuk është bërë përcaktimi i pronës në kufij, sipërfaqe dhe në pozicion gjeografik të saktë, dhe për pasojë ASHK Gramsh nuk mund të bëjë certifikimin e pasurisë në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh. Veprimet e mësipërme, ASHK i mbështet në ligjin nr. 111/2018 “Për kadastrën”, neni 13, neni 17 pika 5 dhe neni 26. Për pronat të cilat disponojnë dokumentacionin e rregullt ligjorë, nuk është aplikuar për regjistrim në ASHK për mungesë fondesh nga Bashkia Gramsh.

-Bashkia Gramsh, në përputhje me nenin 37 pika 1 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore”, ka ngritur urdhrin e punës me nr. 52, datë 23.02.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për

përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore” me komision të përbërë nga Administratorët e Njësive Administrative (Kryetar Komisioni), Inspektorët e shërbimeve publike dhe arkivave, topografët të ndarë sipas zonave përkatëse, specialisti i bujqësisë dhe specialist i Zyrës Vendore të ASHK-së Gramsh.

-Sipas strukturës organizative, për vitin 2019, asetet mbuloheshin nga një specialiste e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Për vitin 2020, u krijua sektor për menaxhimin e aseteve me 3 punonjës, i ndryshuar në strukturën e vitit 2021 duke shkrirë sektorin e aseteve, duke vendosur specialiste në varësi të Drejtorisë Juridike

Kriteri: Ligji 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” neni 37 pika 1;

VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” pikat 9, 10, 11 dhe 22, dhe kreun III- *Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre* të UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Impakti: Mos evidentimin e saktë ligjorë të pronave që kjo njësi vendore ka, regjistrimi, kontabilizimi dhe mos realizim të ardhurash nga pronat e mundshme të shfrytëzueshme.

Shkaku: Neglizhencë e strukturave përgjegjëse dhe vonesë në ngritjen e urdhrin për përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike shtetërore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Komisioni përgjegjës për “përditësimin , inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore”, i ngritur në zbatim të urdhrin nr. 52, datë 23.02.2021, të marrë masa për përfundimin brenda afatit 18 muaj të përcaktuar në nenin 37, pika 1 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” të detyrave të përcaktuara sipas urdhrin, kjo për të bërë të mundur regjistrimin pranë ASHK të tokave bujqësore (ara).

Rekomandimi 2: Drejtoria Ekonomike, të planifikojë për buxhetin e vitit 2022 fonde të dedikuara për regjistrimin e pronave të transferuara, të cilat disponojnë gjithë dokumentacionin e duhur ligjor.

Rekomandimi 3: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të vlerësojë mundësinë e krijimit të një sektori për menaxhimin e aseteve, kjo në përputhje me pikat 9, 10,11,13,14 dhe 21, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe kreun III- *Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre* të UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

► **Titulli i gjetjes:** Mbi auditimin e kontratave për objektet e dhëna me qira.

Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se 68 subjekte për sipërfaqen prej 4882.6 m², përdorin këto objekte për qëllim biznesi dhe për banim. Bashkia Gramsh, për këto objekte për periudhën objekt auditimi ka lidhur 53 kontrata për sipërfaqen 3155 m² dhe 15 subjekte për sipërfaqen 1278 m², i përdorin këto objekte pa kontratë dhe Bashkia ka llogaritur të ardhura në buxhetin e saj. Përlllogaritja e tarifës së qirasë për m², është bërë në bazë të VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” tabela A “Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas Prefekturave për lekë/m².”

Nga verifikimi i arkëtimit të detyrimeve të qirasë për kontratat e lidhura rezultoi se, nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratës 22 subjekte, për sipërfaqen 2,147.6 m² në kundërshtim me nenin 5 “Pagesa dhe rregjimi i saj” të kontratave, në vlerën gjithsej **6,591,955 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh**, subjektet sipas pasqyrës aneks 4.5.1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12 germa g, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe me nenin 5 “Pagesa dhe rregjimi i saj” të kontratave.

Kriteri: Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12 germa (g); UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” ndryshuar, pika 42, dhe neni 5 “pagesa dhe rregjimi i saj” të kontratave.

Impakti: Mos ndjekje e procedurave ligjore në zbatimin e kontratave, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **6,591,955 lekë**, për buxhetin e Bashkisë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet dy sektorëve kryesor, respektivisht sektorit të Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit dhe sektorit Juridik, për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e të ardhurave si dhe rilidhjen e kontratave në përfundim të afateve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1.: Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor për vlerën **6,591,955 lekë**.

Rekomandimi 2.: Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me 15 subjekte me sipërfaqe 1352.6 m² të cilët kanë në përdorim objekte në pronësi të Bashkisë Gramsh.

3.4.3 Krijimi i të ardhurave të institucionit, nga arkëtimi i tarifave nga subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Gramsh për tarifën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020.

► **Titulli i gjetjes:** Mos arkëtim për tarifën nga subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Situata: Për periudhën objekt auditimi, lëshimi i autorizimeve/licencave për subjektet që tregtojnë karburante është mbuluar nga Drejtoria e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporteve, Strehimit dhe Emergjencave Civile. Gjatë kësaj periudhe, është drejtuar nga z. Q. P., me detyrë drejtor drejtorie deri në muajin Gusht 2021. Në vijim është emëruar drejtor znj. L. Z. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporteve, Strehimit dhe Emergjencave Civile, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Gramsh dhe në Njësitë Administrative, na u vunë në dispozicion 4 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, ku rezultoi: Subjekti “S” shpk me nipt J86902812Ë (2 adresa fshati Koçaj dhe Rr. Nacionale Gramsh-Elbasan) me afat 12.12.2019 –11.12.2020 (adresa Koçaj) dhe 24.10.2017 – 23.10.2022 (adresa Rr. Nacionale Gramsh – Elbasan), si dhe subjekti “K.” shpk me nipt J86902809C (2 adresa Rr. Gramsh-Kodovjat dhe Lagjja Holta) me afat 04.07.2017-03.07.2022 (adresa Gramsh – Kodovjat) dhe 09.09.2021-08.09.2022 (adresa L. Holta).

Sa më sipër, rezulton se Drejtoria e Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporteve, Strehimit dhe Emergjencave Civile nuk ka ndjekur *procedurën për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë* për 1 subjekt, konkretisht “Sinani” shpk me adresë fshati Koçaj, pasi rezulton prej 10 muajsh në ushtrim të aktivitetit pa qenë i pajisur me licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve.

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga: b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

2. Organet që kanë përgjegjësi për dhënien e licencave, sipas këtij kreu, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkues.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas aneksit 4.6.1 bashkëlidhur Projekt Raportit.

Nga moszbatimi VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, subjekti i trajtuar sipas aneksit nr. 4.6.1, ka sjell **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh, në vlerën 1,000,000 lekë.**

Kriteri: 1. Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.

2. VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9.

VKM nr. 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kapitulli II, pika 1; germa “b”, pika 9, pika 15.1 dhe 15.2

Impakti: Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku: Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e Bashkisë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e shumë 1,000,000 lekë për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z.Q. P. – ish Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve me Sipërmarrje, Transporte, Strehimit dhe Emergjencave Civile.

3.4.4 Krijimi i të ardhurave të institucionit nga arkëtimi i gjobave të vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territor për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020.

► **Titulli i gjetjes:** Mos vendosja dhe mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV.

Situata: Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMTV Bashkia Gramsh dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor, për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se ekziston dhe ushtron veprimtarinë e saj IMTV-ja, e cila ka 2 punonjës në strukturë.

Emërimet e kryeinspektorit dhe 1 inspektori i IMTV, janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, i ndryshuar, neni 11, arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit. Për periudhën objekt auditimit, Kryeinspektor të IMT Bashkia Gramsh kanë qenë znj. M. Ç. përgjatë vitit 2019 deri me 12.09.2019, z. A. Rr. deri me datë 15.06.2020, dhe në vijim znj. L. Z. Në lidhje me detyrat funksionale të strukturës së IMTV, nga kryeinspektori i IMTV u paraqitën të dhëna dokumentare mbi plane pune javore, mujore dhe vjetore mbi aktivitetin e kësaj strukture, për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të Bashkisë, për periudhën objekt auditimi.

Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMTV Bashkia Gramsh, për ushtrimin e kontrollit në terren mbi territorin e Bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor 01.01.2019-31.12.2020 rezultoi se janë mbajtur gjithsej 20 procesverbale konstatimi për ndërtime pa leje, në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 *“Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”*, i ndryshuar, për të cilat jo në të gjitha rastet kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore, sipas nenit 13 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007.

Në lidhje me auditimin e dokumenteve të paraqitur nga Inspektorët e IMTV për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2020, rezulton se janë përpiluar 20 proces verbale konstatimi për ndërtime të kundërligjshme nga persona të ndryshëm fizik dhe juridik, sipas aneksit nr. 4.7.1 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

-Nga ana e IMTV duhej vendosur gjoba për të gjitha rastet e ndërtimeve pa leje dhe për të cilat janë marrë edhe vendime për pezullimin e punimeve të ndërtimit. Nga IMTV gjobat e vendosura janë kontabilizuar në Drejtorinë e Financës. Për 2 raste nga ana e IMTV i janë drejtuar gjykatës për veprime të mëtejshme ligjore për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv.

-Për vitin 2019, nuk janë aplikuar gjobat për 3 persona, konkretisht kundërvajtësit A. H., N. M. dhe N. B.

-Për 2 kundërvajtësit H. P. dhe O. Ç., debitor në vlerën 100,000 lekë, janë hartuar kërkesë paditë drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv.

-Për vitin 2020, nuk është aplikuar gjobë për 1 person, konkretisht për kundërvajtësin B. D.

-Për shtetasin D. T., nuk janë aplikuar gjoba, pasi objekti ka qenë ekzistues dhe i s'kualifikuar nga ASHK – Elbasan, për të cilin ka dal vendimi i prishjes së objektit. Nuk kemi ndërtim ekzistues në proces

-Për shtetasin Z. G., i cili është gjobitur 50,000 lekë për shkeljen e kryer, rezulton se ka lidhur akt marrëveshje me nr. 129/1 prot., datë 15.01.2021 për likuidimin me këste të gjobës. Ky shtetas rezulton se ka likuiduar vetëm 1 këst të gjobës në vlerën 8,400 lekë, sipas mandatit të arkëtitimit nr. 213, datë 28.01.2021, dhe rezulton debitor për vlerën e mbetur prej 41,600 lekë.

-2 (Dy) gjobat e vendosura ndaj shtetasve I. M. dhe L. H. (mbikëqyrës punimesh), janë vendosur në zbatim të rekomandimit të KLSH, të cilat janë arkëtuar.

-Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Gramsh, për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 ka vendosur 15 procesverbale gjobe, në vlerën prej **910,000 lekë**, për të cilat janë arkëtuar 10 gjoba në vlerën 270,000 lekë, është në proces 1 gjobë sipas akt marrëveshjes në vlerën 50,000 lekë, dhe nuk janë arkëtuar 4 gjoba në vlerën 610,000 lekë, për të cilët 2 gjoba u është drejtuar gjykatës për kthimin e tyre në titull ekzekutiv. Inspektorati i Mbrojtjes Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkohet në Gjykatë, shndërrimi i 1 vendimi të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës **500,000 lekë**, si dhe të vijohet me procedurat ligjore për të kërkuar detyrimin e mbetur sipas akt marrëveshjes me shtetasin Z. G. për vlerën **41,600 lekë**, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh.

Kriteri: -Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar,

-Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar,

-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin e punimeve në ndërtim”, i ndryshuar,

-Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtje Administrative”, përkatësisht: neni 22- vendim për kundërvajtje administrative, që parashikon dënimin me gjobë, si titull ekzekutiv” nenin 24- “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtje administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30- “ Arkëtimi i shumave të detyrimit”

-VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

Impakti: Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku: Mos rakordimi midis Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Financës dhe Sektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit. Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e Bashkisë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e 2 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës **541,600 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Znj. M. Ç. - ish Kryeinspektor e IMT deri më 12.09.2019;

Z. A. Rr. – ish Kryeinspektor i IMT për periudhën 12.09.2019 deri më 15.06.2020.

3.4.5 Krijimi i të ardhurave të institucionit nga subjektet e shpallur fitues për punë publike në procedurat e prokurimit publik për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020.

► **Titulli i gjetjes:** Mbi mos vjeljen e detyrimeve për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit nga subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike.

Situata: Nga auditimi i subjekteve të ndërtimit të cilat kanë kryer punime dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike në territorin e Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative në vartësi për periudhën 01.01.2019-31.12.2020, për tarifën vendore, në bazë të paketës fiskale me vendim nr.99 datë 18.12.2018 dhe vendimit nr.96 datë

30.12.2019 “Për Miratimin e Paketës Fiskale”. Bazuar në evidencën e prokurimeve ku subjektet që janë kualifikuar si oferta e vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë janë të pasqyruara në aneksin nr. 4.8.1. Nga auditim i dokumentave, disa nga këto subjekte nuk kishin paguar tarifatat vendore si e pastrimit, gjelbërim e ndriçim etj., të pasqyruara në aneksin nr. 4.8.2.

Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Gramsh, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit etj., për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 01.01.2019-31.12.2020 sipas paketës fiskale duke rezultuar debitorë në vlerën **275,000 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Gramsh.**

Kriteri: 1. Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreu VII, nenit 35

2. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1

3. Vendimit të Këshillit të Bashkisë Kurbini nr. 99, datë 18.12.2018 dhe nr. 96, datë 30.12.2019 “Për miratimin e paketës fiskale”.

Impakti: Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

Shkaku: Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim 1: Bashkia Kurbini të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **275,000 lekë**, për subjektet debitorë “A.” në vlerën 123,000 lekë, “R.” Shpk, në vlerën 20,170 lekë, “B.” Shpk, në vlerën 21,000 lekë, “2.” Shpk, në vlerën 25,200 lekë, “I.” Shpk në vlerën 25,200 lekë, “Z.” Shpk në vlerën 20,170 lekë, “V.” në vlerën 20,170 lekë dhe “B.” shpk në vlerën 20,170 lekë në kundërshtimin të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43/1.

18.2 Rekomandimi: Bashkia Gramsh, të marrë masa për regjistrimin dhe hapjen e nipt-eve sekondare për të gjitha subjektet që kanë fituar në procedurat e prokurimit publik por nuk kanë seli në Bashkinë Gramsh, në përputhje me nenin 43 pika 1/1 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z.A. B. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë të të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar deri më 17.10.2019.

Z.A. Sh. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë të të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nga periudha 21.10.2019 e në vazhdim

Z.A. J. me detyrë, agjent tatimor dhe nga data 08.10.2019 përgjegjës sektori i tatim taksave.

Z.F. B. me detyrë, inspektor i tatim taksave terreni nga data 24.06.2019 e në vijim

Z.A. N. me detyrë, inspektor tatim taksave familjare nga data 12.12.2019 e në vijim.

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 buxheti është realizuar në masën 90 % ose nga 1,041,130 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 940,311 mijë lekë, me mosrealizim për vlerën 100,819 mijë lekë, ndërsa për vitin 2020 buxheti është realizuar në masën 93 % ose nga 1,154,093 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 1,076,656 mijë lekë, me mosrealizim për vlerën 77,437 mijë lekë.

Në zërin investime, buxheti për vitin 2019 është realizuar në masën 75% ose nga 298,970 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 223,508 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 13,395 mijë lekë ose 0.5% të vlerës së investimit, për vitin 2020 është realizuar në masën 84% ose nga 313,956 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 263,073 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 6,413 mijë lekë ose 0.2%.

Të ardhurat e veta, për vitin 2019 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë planifikuar për vlerën 85,409 mijë lekë në fakt ato janë realizuar për vlerën 53,976 mijë lekë, më pak për vlerën 31,433 mijë lekë, për vitin 2020 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë planifikuar për vlerën 87,346 mijë lekë në fakt ato janë realizuar për vlerën 66,485 mijë lekë, më pak për vlerën 20,861 mijë lekë. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Gramsh të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2020, të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llogarisë (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet në vlerën 39,187,378 lekë, ose 4% e vlerës së buxhetit të vitit 2020.

Me datë 30.06.2021, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara, të llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, llogarisë (401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to”, detyrime të tjera në llogarisë (467) “Kreditorë të ndryshëm”, paraqitet **në vlerën 20,412,472 lekë**, në totalin e tyre Vendime Gjykate janë për vlerën **8,000,000 lekë**, sipas pasqyrës aneks nr. 1/3 bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Sa më sipër nga Drejtoria e Financës nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e

detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 20-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime në vlerën **20,412,472 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave. Nuk duhet të fillojnë procedura të reja pa mundësuar lidhjen e kontratave të vjetra.

2.2 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar se në gjendjen e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën **43,453,558 lekë** si dhe gjendja e debitorëve për “dhënien me qira” e lidhura për objekt për banim dhe objekt biznesi në vlerën **6,488,455 lekë** e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi kjo vlerë nuk është kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja në formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tarifatat në llog.468 debitorë të ndryshëm, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: KLSH konstatoi se, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14,043,607 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,584,931 lekë. Diferenca e vitit ushtrimor 2020 me atë paraardhës prej 1,541,324 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15 % e zbritur nga vlera e mbetur gjendje në fund të vitit 2019 në vlerën 2,478,284 lekë si edhe shtesat e krijuara gjatë vitit 2020 në vlerën 936,960 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 14,043,607 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Kjo vlerë e cila i përket 112 projekt-studimeve nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 25-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivitetet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 dhe 2020 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësisia nuk dispononte një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e s'kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit “Për kryerjen e procesit të inventarizimit”. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit **nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve**, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh, komisionet e ngarkuara sipas urdhrave të Titullarit, të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në llogari të ndryshme për aktive të veçanta në tabelat e detajuara të aktiveve dhe llogaritjes së amortizimit sipas normave ligjore të amortizimit të përcaktuara, rezultoi se për llogaritjet nuk ishin bërë të sakta. Në vitin ushtrimor 2020 janë kontabilizuar për llogaritjet e amortizimit të aktiveve jo materiale dhe material për vlerën 151,975,083 lekë dhe është debituar llog. 2012 “konsumi i aktiveve jo materiale” dhe llog. 1013 “Konsumi i aktiveve materiale” në debi të llogarive: llog.2190 “Amortizim Studime projektive” në vlerën 2,478,284 lekë, llog.2192 “Amortizim Ndërtesa” për vlerën 29,531,669, llog.2193 “Amortizim Rruge, kanalizime” për vlerën 91,960,983 lekë, llog. 2194 “Amortizim Makineri e pajisje, instrumente e vegla” në vlerën 706,120, llog. 2195 “Amortizim Mjete transporti” në vlerën 15,657,773 dhe llog. 2198 “Amortizim Inventar ekonomik” në vlerën 11,640,254 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Gramsh, të marrë masa për kryerjen e sistemit kontabël, me qëllim pasqyrimin e drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 “Pasqyra e lëvizjes së fondeve”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2021

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transaksioneve nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër shpenzime mbi afatin 30 ditor të faturave për mallra dhe shërbime, në mosrespektim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 në të cilën përcaktohet se: “Nëpunësit zbatues të njëjste shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Gramsh, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve të faturave, duke respektuar afatin 30 ditor pas paraqitjes së faturës dhe dokumentacionit justifikues nga operatorët ekonomikë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 10 procedurave me vlera të larta, kriteret janë të paargumentuara në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 31-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Gramsh, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kriterë sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 2768 prot datë 29.07.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, me vlerë kontrate 82,960 mijë lekë, dhe kontratës nr. 1916, datë 18.03.2019, me objekt “Sistemin Asfaltim i lagjes X”, me vlerë kontrate 39,999 mijë lekë, u konstatua se nuk është dhënë leja e ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 39, “Leja e ndërtimit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3.4 faqe 78-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 2768 prot datë 29.07.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, me vlerë kontrate 82,960 mijë lekë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor nuk janë marrë masa për marrjen e oponencës teknike, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3.4 faqe 78-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh, të merren masa që për objektet me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, të kërkohet oponenca teknike nga institucionet e ngarkuara

me ligj, me qëllim që projektet të jenë sa më cilësorë dhe lehtësisht të zbatueshëm nga shoqëritë sipërmarrëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 6093 prot., datë 01.10.2019, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujës-jellësit të qytetit Gramsh”, me vlerë kontrate 184,348 mijë lekë, u konstatua se punimet nuk kanë mbaruar në afat, në kundërshtim me kontratën e punimeve civile, duke mos arritur në kohë qëllimin për të cilin është planifikuar të ndërtohet ky objekt. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3.4 faqe 84-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh, të analizohet mosrealizimi në kohë i këtij objekti, të nxirren përgjegjësitë dhe të zbatohen penaltitetet sipas kontratës së punëve civile për këtë objekt, për çdo ditë vonesë në dorëzimin e punimeve.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Gramsh nuk ka bërë të mundur që pas bashkimit me ish-Komunat sot Nj/ Administrative të saj për pronat e transferuara të kryej procesin e regjistrimit në ZVRPP, ngritjen e komisionit për vlerësimin e pasurive me çmimin e tregut të si: truall, tokë bujqësore, ndërtesa, pyje, kullota etj., me qëllim vënien e këtyre pronave në efikasitet për dhënien e tyre me qira për realizimin e të ardhurave nga qiradhënia e tyre dhe për dy Nj/Administrative Tunjë dhe Kukur nuk ka përgatitur dokumentacionin ligjorë për miratimin e listës përfundimtare, të pronave për to.

-Në lidhje me tokat bujqësore, rezulton se ASHK nuk ka vijuar me regjistrimin e tyre, pasi VKM-të me anë të së cilës pronat i janë transferuar Bashkisë në pronësi ose në përdorim, janë të përmbledhura në një numër të vetëm rendor, dhe jo me numra specifikë që ato kanë.

Bashkia Gramsh, në përputhje me nenin 37 pika 1 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetërore”, ka ngritur urdhrin e punës me nr. 52, datë 23.02.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore”.

-Sipas strukturës organizative, për vitin 2019, asetet mbuloheshin nga një specialiste e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Për vitin 2020, u krijua sektor për menaxhimin e aseteve me 3 punonjës, i ndryshuar në strukturën e vitit 2021 duke shkriur sektorin e aseteve, duke vendosur specialiste në varësi të Drejtorisë Juridike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.2 faqe 88-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Komisioni përgjegjës për “përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore”, i ngritur në zbatim të urdhrin nr. 52, datë 23.02.2021, të marrë masa për përfundimin brenda afatit 18 muaj të detyrave të përcaktuara sipas urdhrin, kjo për të bërë të mundur regjistrimin pranë ASHK të tokave bujqësore (ara).

13.2 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike, të planifikojë për buxhetin e vitit 2022 fonde të dedikuara për regjistrimin e pronave të transferuara, të cilat disponojnë gjithë dokumentacionin e duhur ligjor.

13.3 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të vlerësojë mundësinë e krijimit të një sektori për menaxhimin e aseteve, kjo në përputhje me pikat 9, 10,11,13,14 dhe 21, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe kreun III- *Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre* të UMF nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se 68 subjekte për sipërfaqen prej 4882.6 m², përdorin këto objekte për qëllim biznesi dhe për banim. Bashkia Gramsh, për këto objekte për periudhën objekt auditimi ka lidhur 53 kontrata për sipërfaqen 3155 m² dhe 15 subjekte për sipërfaqen 1278 m², i përdorin këto objekte pa kontratë dhe Bashkia ka llogaritur të ardhura në buxhetin e saj. Përlllogaritja e tarifës së qirasë për m², është bërë në bazë të VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” tabela A “Tarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas Prefekturave për lekë/m². (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3.4 faqe 90-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me 15 subjekte me sipërfaqe 1352.6 m² të cilët kanë në përdorim objekte në pronësi të Bashkisë Gramsh.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Gramsh), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim *shpërblimin e dëmit në vlerën 1,544,806 lekë*, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës (me TVSH) 99,552,818 lekë, fituar nga OE “Z.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe likuiduar në vlerën 1,329,268 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2768 prot datë 29.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE “Z.” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3.4 faqe 78-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,329,268 lekë pa TVSH** nga shoqëria “Z.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2768 prot., datë 29.07.2020, me objekt “Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin”, Bashkia Gramsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim Asfaltim i lagjes X”, Bashkia Gramsh, me vlerë të kontratës (me TVSH) 47,999,596 lekë, fituar nga OE “M.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe likuiduar në vlerën 215,538 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1916, datë 18.03.2019 të lidhur mes Autoritetit

Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE "M." SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3.4 faqe 81-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **215,538 lekë pa TVSH** nga shoqëria "M." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1916, datë 18.03.2019, me objekt "Sistemim Asfaltim i lagjes X", Bashkia Gramsh", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin e 22 procedurave me vlerë kontrate 641,698 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 9 procedura me vlerë kontrate 119,431 mijë lekë ose 18 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa economicitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{le}) **119,431 mijë lekë, respektivisht:**

1- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtimi i tregut të qytetit", me fond limit 8,333 mijë lekë, me fitues BOE "B." shpk & "M." shpk me vlerë të ofertës 7,998 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,998 mijë lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 34-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Sistemim asfaltim i lagjes "X", Kocaj", me fond limit 41,666 mijë lekë, me fitues OE "M." shpk me vlerë të ofertës 39,999 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **39,999 mijë lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 36-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative", me fond limit 11,937 mijë lekë, me fitues BOE "R." shpk & "M." shpk me ofertë 11,379 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **11,379 mijë lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 39-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtim ujësjellësa në NjA Skënderbegas dhe NjA Lenije", me fond limit 6,249 mijë lekë, me fitues OE "B." shpk me ofertë 6,027 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **6,249 mijë lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat – Cingar Sipër - Drizë", me fond limit 28,043 mijë lekë, me fitues BOE "A." shpk & "B." shpk me ofertë 27,202 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **27,202 lekë.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 45-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj”, me fond limit 9,996 mijë lekë, me fitues BOE “G. Z.” shpk & “V.” shpk me ofertë 9,515 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **9,515 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 54-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri për nevojat e çerdheve, kopshteve, shkollave dhe konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2020-2021 si dhe zyrat e njësive administrative”, me fond limit 5,819 mijë lekë, me fitues OE “I.” shpk me ofertë 5,781 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **5,781 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet të varfëra dhe të pafavorizuara”, me fond limit 5,479 mijë lekë, me fitues OE “2.” shpk me ofertë 5,469 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **5,469 mijë lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 60-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim i vallezave të qytetit”, me fond limit 8,328 mijë lekë, me fitues OE “I.” shpk me ofertë 6,056 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **6,056 lekë**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 69-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, dhe nenin 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3.

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{te}), **119,431 mijë lekë** pa TVSH.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C/1. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pa mjaftueshme e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Gramsh, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2020 kanë vlerën progresive **43,453,558 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat;

-57 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 4,422,021 lekë,

-3937 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 18,203,801 lekë,

-5700 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 14,433,781 lekë,

-Debitor qira objekti në vlerën 6,393,955 lekë..

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të

shpenzimeve të tjera që njëzia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2019-2020.

Nga Bashkia Gramsh nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.1 faqe 86-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë dhe Drejtorja e Planifikimit të të Ardhurave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **43,453,558 lekë**. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimor dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të **bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

e- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifave familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i arkëtimeve të detyrimeve të qirasë për kontratat e lidhura rezultoi se, nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratës 22 subjekte, për sipërfaqen 2147.6 m² në kundërshtim me nenin 5 “Pagesa dhe regjimi i saj” të kontratave, në vlerën gjithsej **6,591,955 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12 germa **g**, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe me nenin 5 “Pagesa dhe regjimi i saj” të kontratave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.2 faqe 90-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor për kontratat e lidhura të qirave për objekte në vlerën **6,591,955 lekë**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 të Bashkisë Gramsh, për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 ku **konstatohet se:**

Në Bashkinë Gramsh ushtron aktivitet 1 subjekt debitor në vlerën **1,000,000 lekë**, konkretisht subjekti "S." shpk me adresë fshati Koçaj, i cili nuk është pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.3 faqe 91-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 1,000,000 lekë nga subjekti “S.” shpk për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Gramsh, për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 ka vendosur 15 procesverbale gjobe, në vlerën prej 910,000 lekë nga të cilat janë arkëtuar 10 gjoba në vlerën 270,000 lekë, janë dërguar në gjykatë 2 kërkesë padi për 2 persona për kthimin e gjobës në titull ekzekutiv në vlerën 100,000 lekë, për 1 person është lidhur akt marrëveshje për likuidimin me këste për vlerën 50,000 lekë, i cili rezultoi i pazbatuar për diferencën 41,600 lekë dhe për 1 person nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e vlerës 500,000 lekë. Vlera **541,600 lekë** për 2 persona, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4 faqe 92-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e 2 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës **541,600 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Gramsh, nuk është vepruar, për të arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 01.01.2019-31.12.2020. Subjektet debitorë “A.” sh.p.k në vlerën 21,000 lekë, “R.” sh.p.k. në vlerën 20,170 lekë, “B.” shpk në vlerën 21,000 lekë, “2.” shpk në vlerën 25,200 lekë, “I.” shpk në vlerën 25,200 lekë, “Z.” shpk në vlerën 20,170 lekë, “V.” shpk në vlerën 20,170 lekë dhe “B.” shpk në vlerën 20,170 sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Gramsh nr.99 datë 18.12.2018 dhe vendimit nr.96 datë 30.12.2019 “Për Miratimin e Paketës Fiskale”, dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008

“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1. Këto subjekte janë debitorë në vlerën **275,000 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Gramsh.**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.5 faqe 94-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Gramsh të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **275,000 lekë**, për subjektet debitorë “A.” në vlerën 123,000 lekë, “R.” Shpk, në vlerën 20,170 lekë, “B.” Shpk, në vlerën 21,000 lekë, “2.” Shpk, në vlerën 25,200 lekë, “I.” Shpk në vlerën 25,200 lekë, “Z.” Shpk në vlerën 20,170 lekë, “V.” në vlerën 20,170 lekë dhe “B.” shpk në vlerën 20,170 lekë në kundërshtimin të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43/1.

5.2 Rekomandimi: Bashkia Gramsh, të marrë masa për regjistrimin dhe hapjen e nipt-eve sekondare për të gjitha subjektet që kanë fituar në procedurat e prokurimit publik por nuk kanë seli në Bashkinë Gramsh, në përputhje me nenin 43 pika 1/1 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”

Menjherë dhe në vijimësi

E. MASAT DISIPLINORE

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.

- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KLSH mbështetur në nenin 15, ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germa (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil ; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Gramsh** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT